

1) بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

FJALA E PARË

"Bismil-lah" është kreu i çdo mbarësie. Edhe ne me Të do të fillojmë. Dije, o nefsi im, kjo fjalë e madhërueshme, megjithëse është simbol i fesë Islame, përdoret dhe përmendet vazhdimisht nga çdo qenie tjetër. Në qoftë se do të kuptosh se sa forcë të madhe e të pasosur dhe se sa vlerë të pashtershme ka fjala "Bismil-lah", lexoje me kujdes këtë tregim, si shembull krahasues!

Çdo njeri që do të udhëtojë në shkretëtirat arabe, duhet të njohë emrin e kryetarit të një fisi dhe të hyjë nën mbrojtjen e tij, për të shpëtuar prej kusarëve të shkretëtirës dhe për të plotësuar të gjitha nevojat e tij. Pa këtë mbështetje, i vetëm përballë nevojave, vështirësive dhe armiqve të panumërt, do të zhduket. Në një udhëtim të tillë, nëpër shkretëtirë janë nisur dy veta. Njëri prej tyre është i bindur, kurse tjetri mendjemadh dhe kokëfortë. I binduri e pranon emrin e kryetarit të një fisi dhe kërkon mbështetjen e tij, kurse

mendjemadhi nuk e pranon këtë privilegj. Ai që pranon përkrahjen e këtij kryetari, udhëton pa frikë kudo. Po të rastis të përballet me ndonjë kusar i thotë: "Unë eci me lejën dhe urdhërin e filan kryetari". Kusari nga frika largohet pa e prekur fare. Po të hyjë në ndonjë çadër, me atë emër nderohet. Udhëtari tjetër, gjatë gjithë rrugës dridhet nga frika dhe shndërrohet në një lypës, poshtërohet dhe ofendohet.

Ja pra o nefsi im, ti je ai udhëtari mendjemadh dhe i pabindur, kurse kjo botë është shkretëtira. Dobësia dhe varfëria jote është e pafund. Armiq të nevojat e tua janë të panumërta. Meqë është kështu, merre emrin e Zotit të të gjitha botërave dhe të Sundimtarit të Pafund, po të duash të shpëtosh pa u dridhur nga asgjë dhe pa i lypur askujt. Kjo fjalë është aq e madhërueshme, saqë vuajtja dhe varfëria jote e pafund të lidhë me forcë të madhe me All-llahun e Gjithëmëshirshëm dhe të Plotëfuqishëm. Dobësia dhe varfëria jote të ndihmojnë për të fituar Mëshirën e Tij. Kush fillon me këtë fjalë, i ngjan atij të riut, që regjistrohet për të shërbyer në ushtri; punon në emër të shtetit dhe nuk i frikësohet askujt. "Në emër të ligjit, në emër të shtetit" thotë, kryen çdo punë dhe i bën ballë çdo vështirësie.

Në fillim thamë se: Të gjitha qëniet e krijuara thonë: "Bismil-lah". A është kështu?

Nëse do të shikoje se si një njeri i vetëm vjen dhe i dërgon me forcë të gjithë njerëzit e qytetit, në një krahinë dhe i detyron të punojnë angari, së shpejti mëson se ai njeri, nuk po vepron në emrin dhe forcën e tij. Ndoshta ai është një ushtar që zbaton ligjin në emër të shtetit dhe i cili forcën e urdhërin e veprimit i merr nga një Mbret.

Çdo gjë ekziston, vepron dhe lëviz në emër të Zotit të Madhëruar. P.sh.: Farat shumë të vogla dhe bërthamat krijojnë pemë të mëdha, që ngrejnë pesha të rënda, sa një mal. Domethënë: çdo pemë thotë "Bismil-lah", mbledh frutat nga thesari i të Gjithëmëshirshmit dhe na ushqen neve. Çdo bostan thotë "Bismil-lah" dhe në kuzhinën e Fuqisë së Pafundme piquen së bashku shumë lloj ushqimesh të shijshme, duke na u servirur neve në Emër të të Gjithëmëshirshmit. Çdo kafshë e butë, si: lopa, deveja, delja, dhe dhia thonë "Bismil-lah" dhe bëhen si një krua i Zotit të

Madhëruar, ku rrjedh si burim, qumështi. Ato neve na japin lëngun më të mirë të gjallërimit, në Emër të Furnizuesit të botërave. Çdo bimë apo pemë, rrënjët dhe damarët e të cilave shtrihen si fije mëndafshi nën tokë thotë: "Bismil-lah" dhe kështu shpojnë tokën dhe shkëmbin e fortë, duke depërtuar në mesin e tyre. Çdo gjë vihet në shërbim të Zotit të Madhëruar dhe i nënshtrohet Ligjeve të Tij.

Ja pra, si degët e pemës që hapen në ajër, të drejtuara nga qielli dhe lidhin frutet, po kështu edhe rrënjët e disa bimëve të brishta, me një lehtësi të madhe e shpojnë gurin dhe dheun e fortë dhe nën tokë lidhin frutat, për t'u mbrojtur nga nxehtësia e madhe e Diellit dhe për muaj të tërë mbeten të gjelbërta dhe të lagështa. Me këtë argument Zoti i Madhëruar i demaskon natyralistët, ata që thonë se kjo është vepër e natyrës. Duke ua futur gishtin në syrin e tyre të verbër, u thotë: Shikoni, ju që i besoni forcës së energjisë së nxehtësisë, edhe ajo lëviz sipas ligjeve të Krijuesit të Gjithësisë, sikurse ato rrënjët e buta si mëndafshi, që i përngjajnë shkopit të Musait (a.s.).

فَقُلْنَا اضْرِبْ بِعَصَاكَ الْحَجَرَ

2) Ne (Musait) i thamë: "Bjeri gurit me shkopin tënd".

Duke dëgjuar urdhërin e Zotit të madhëruar, shpojnë dhe çajnë gurin me lehtësi. Po kështu, gjethet e holla si letrat e duhanit janë mbrojtëse ndaj diellit ashtu si në rastin e Ibrahimit a.s.. Ata lexojnë ajetin në të cilin All-llahu xh.sh. thotë:

فَقُلْنَا اضْرِبْ بِعَصَاكَ الْحَجَرَ

3) O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!

Meqenëse çdo gjë me ekzistencën e saj thotë "Bismil-lah", bën që mirësitë e Zotit xh.sh. të na i sjellin në emër të Tij, pra ne duhet të themi "Bismil-lah". Duhet të japim dhe të marrim në Emër të Zotit, ashtu siç nuk duhet të marrim asgjë nga njerëz të pandërgjegjshëm, që nuk japin në emër të Zotit.

Shtrohet kjo pyetje: Kur njerëzve që na shërbejnë me të Mirat e Zotit si p.sh. kamarierëve, ne u japim një bakshish të vogël, po Pronari i vërtetë i pasurisë, All-llahu, çfarë shpërblimi kërkon për të mirat dhe pasurinë që na ka dhënë?

Përgjigje: Po, All-llahu, për të gjitha Mirësitë dhe vlerat materiale që na ka dhënë, kërkon tre gjëra prej nesh: e para është dhikri (ta përmendësh Zotin xh.sh.); e dyta është shukri (ta falenderosh Zotin xh.sh.); e treta është fikri (ta kujtosh Zotin xh.sh.). Në fillim të thuash "Bismil-lah", është dhikër. Në fund të thuash "Elhamdulillah", është shukr. Në mes të këtyre të dyjave është fikri ta kujtosh dhe ta pranosh këtë të mirë, këtë dhuratë të Mëshirshme, të krijuar me mjeshtri të përkryer nga All-llahu i Gjithëmëshirshëm.

Aq sa është antinjerëzore të përulesh dhe të puthësh këmbën e një njeriu të thjeshtë, që të sjell një dhuratë të çmuar nga një mbret, duke harruar dhe duke mos e njohur Pronarin e vërtetë të dhuratës, një mijë herë më antinjerëzore është të duash dhe të lavdërosh shitësin, pa përmendur pronarin e vërtetë të pasurisë.

O nefsi im! Në qoftë se nuk do të jesh kaq i çmendur, jep në Emër të Zotit, merr në Emër të Zotit, puno në Emër të Zotit dhe çdo lëvizje kryejë në Emër të Zotit xh.sh.. Paqja dhe bekimi qofshin mbi ju! Amin!

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

1)

POZITA E DYTË E TË TREMBËDHJETËS FJALË

(Është një bisedë me disa të rinj që akoma nuk kanë humbur mendjen përballë sulmeve të intrigave).

Nga disa të rinj shtrohet pyetja: “si mund të shpëtojmë jetën e ahiretit nga këto mashtrime të lojrave tërheqëse që intrigat e ndryshme përpiqen të na tërheqin për të devijuar vazhdimisht veset tona epshore?”

Unë, në emër të personalitetit të Risle-i Nurit iu përgjegja në këtë mënyrë të rinjve që kërkonin medet nga Risale-i Nuri:

Përpara çdo personi është varri, që askush nuk mund ta mohojë dhe që patjetër do të shkojë në të. Dhe përveç tri rrugëve nuk shkohet në të.

Rruga e parë: për besimtarin varri është një derë e një bote më të shndritshme se kjo botë.

Rruga e dytë: Dera e varrit për ata që kanë rënë në devijim, që nuk veprojnë sipas besimit të tyre është një burgosje në vetmi.

Rruga e tretë: Dera e varrit për ata që nuk besojnë në ringjalljen është një ekzekutim i përjetshëm. Sepse ata nuk kanë besuar se do të ringjallen... Domethënë: Si për veten e tyre (të mosbesimtarëve), gjithashtu mohuesët ndiejn dhëmje edhe për të gjithë afërmit e tyre, sepse në besimin e tyre vdekja për secilin është një ekzekutim i përjetshëm.

Sipas drejtimit të besimit të tyre do të bëhet edhe dënimi i tyre: këto dy alternativa janë aq të qarta sa që nuk duan fare argument. Meqë vdekja është e fshehtë, ajo mund të vijë në çdo çast t'ua presë kokën njerëzve, duke mos ndarë fare të riun nga plaku.

Përballë kësaj çështjeje të madhe të ekzekutimit, që njeriu e ka vazhdimisht parasysh; pra përballë kësaj varjeje të pafundme, a nuk duhet që njeriu i paaftë nga kjo çështje të kërkojë një derë shpëtimi, që derën e varrit për veten e tij ta kthejë në dritë dhe ta gëzojë atë në lumturinë e përjetshme?!

Këtë të vërtetë të saktë, që do të realizohet vetëm me këto tri rrugë, e kanë lajmëruar njëqindënjëzet e katër mijë Profetë. Duke pasur në dorë mrekullitë për të vërtetuar se ato janë argumente të sakta, duke mbajtur rrugën e tyre këtë lajm e kanë dhënë edhe miliona evlija (njerëzit e shenjtë). Këtë lajm kanë dhënë edhe shumë persona (numri i të cilëve nuk kufizohet) që kanë pasuar rrugën e vertetë dhe njëri prej të cilëve është Risale-i Nuri, që duke argumentuar ua përgjigjet pyetjeje kohës sonë. Këto të gjitha me një saktësi të pamohueshme argumentojnë, duke shpresuar me një shpresë të shkallës së lartë të 99%, që besimi është i vetmi shkak që njerëzit mund t'i shpëtojnë nga ekzekutimi dhe nga dënime të tmerrshme dhe t'i çojë njerëzit në lumturinë përrallore dhe të përjetshme. Pra e kuptuat se të gjithë këto personolite të shkëlqyer së bashku, theksojnë se njeriun mund ta shpëtojë vetëm besimi dhe përkulja ndaj urdhërave të krijuesit.

Vallë, në qoftë se merret parasysh fjala e një personi që lajmëron rrezikun në një rrugë me mundësi 1%, dhe nga frika e saj na humb oreksi i ngrënijes sonë, atëherë mendoni vetë se sa duhet të interesohemi për fjalën që paralajmërojnë qindramijëra personalitete të kësaj fushe, që është drejtë pa kurrfarë gënjeshtre, që na argumentojnë me saktësinë e fortë të 100% -shit duke na thënë se dera e varrit për mosbesimtarin dhe për ata që kanë rënë në devijim është ekzekutim dhe burg në errësirën e përjetshme, dhe që, me po të njëjtën saktësi, argumentojnë edhe se rruga për të shpëtuar nga këto ndëshkime që i kemi parasysh është vetëm besimi dhe adhurimi ndaj All-llahut të Madhëruar; pra na lajmërojnë se derën e varrit besimi e kthen në një rrugë që shkohet në lumturinë përrallore të jetës së përjetshme.

Pra përballë kësaj çështjeje të madhe është e habitshme dhe e trishtueshme që qëndron ky njeri i pafat, veçanërisht muslimani, po që se nuk ka mundur të zotërojë besimin që ta adhurojë All-llahun xh.sh.. Tani po ju pyesni: sikur t’i japësh begatitë të botës një njeriut të vetëm, a ka mundësi ta kënaqësh atë në një kohë që ai është duke qëndruar para vdekjes së tmerrshme, e cila është vazhdimisht duke e tmerruar atë?

Meqë na e humbin shijen e jetës pleqëria, sëmundjet, fatkeqësitë e vdekja që na kanë rrethuar nga çdo anë, për ata që kanë rënë në devijim dhe jetojnë të çfrenuar, edhe pse marrin qindra mijëra kënaqësira, prapë në zemrën e tyre jeton një xhehnm që i djeg vazhdimisht. Por pëlhura e trashë që vjen nga pakujdesia nuk i lejon ta ndiejnë dhimbjen për një kohë të shkurtër.

Dhe meqë për besimtarët dhe për ata që urdhërat e All-llahut i çon në vend, vdekja është një lajm për një gëzim të madh që lajmëron se: Nga llotaria e caktimit të Zotit atij i kanë rënë miliarda florinj e xhevahire, që vdekja duke e gëzuar pa masë besimtarin e paralajmëron vazhdimisht atë duke i thonë: “Eja merre letrën e shpëtimit”. Pra, ky gëzim shpirtëror është një gëzim i tillë që po të ishte e mundur për zotin e tij të bëhet fara, bëhet një xhennet i veçantë. Tani pas këtyre tregimeve mund të më tregoni se si braktiset kjo mirësi e madhe e besimit për të shkuar pas veseve e liga që e shtyjnë njeriun, veçanërisht rininë, të bëjë punë të pahijshme; Ato shije që vijnë nga veset shfrenuara janë si mjaltë me helm që njeriun e zbresin në nivel njëqind herë më të ulët se kafsha, ku gjendja e tij është edhe më e keqe se gjendja e mosbesimtarëve të feve të tjera. Sepse ato edhe po të mohojnë Profetin e fundit mund të zënë besë Profeteve të tjerë, po të mohojnë Profetët, mund të zëjnë besë në Zotin e madhëruar, edhe po të mohojnë Zotin xh.sh. tek ta prapë mund të mbesë ndonjë virtyt për përsosshmërinë e njerëzimit. Por muslimani, që me anën e Hz. Muhammedit (a.s.m) ka mundur t’i besojë All-llahut xh.sh., profetëve alejhimusselam dhe tërë përsosmërive, kur të dalë nga zinxhiri i edukatës së Muhammedit (a.s.m.) nuk beson më as një Profetit duke mohuar edhe All-llahun e Madhëruar dhe tek ai nuk mbetet më kurfarë virtyti i dobishëm. Sepse ai ka dalë nga zinxhiri i një Profeti (a s m), që është më i madhi dhe është vula e Profetëve; ligji i të cilit është i botëkuptimit që mrekullitë dhe feja e Tij është përmbi të gjitha fetë tjera. Sepse që prej 14 shekujsh Hz. Muhammedi (a.s.m) e ka vërtetuar se është mësuesi dhe lavdia njerëzimit. Pra s’ka dyshim se kush shkapëputet nga ky personalitet, ai jeton duke mos parë më ndonjë grimcë dritë dhe zhytet në errësirën më të madhe.

Tani, o ju që adhuron shijet e botës së përkohshme dhe o ju të pafatët që thoni se si do të më bëhet halli në të ardhmen dhe përpiqeni ditë e natë vetëm për ardhmërinë fizike! Në qoftë se kërkon kënaqësitë, lumturitë, shijet e rehatitë e kësaj jete, për ju le të mjaftojnë shijet në rrethin që ka lejuar Krijuesi i Juaj. Përveç saj mos kërkon gjë se, sigurisht me tregimin e parë e keni kuptuar se në shijen e vetëm një të palejuare ka mijëra hidhërime. Sepse siç na tregojnë nëpër kinema po të ishte e mundur që njerëzve të shfrenuar t’u tregohet jeta e tyre e pas pesëdhjetë vjeteve, ata do të shihnin se sa do të qanin për qeshjen që bëjnë këtu, do të pendohen duke thënë: “Ah i mjeri, çfarë më gjeti!” Pra kush e do kënaqësinë e kësaj jete së bashku me atë tjetrën, le të jetojë në rrethin e besimit për vehten e tij duke pranuar prijës edukimin e Muhammedit (a.s.m)

NË NJË KOHE ISHA ULUR NË DRITAREN E BURGUT TË ESKISHEHRIT

Para meje ishte oborri i gjimnazit ku ishin duke kërcyer vajzat e rritura që studionin aty. Në xhennetin e dynjasë, ato i pashë si në formën e hyrive të xhehennemit. Përnjëherësh, si në kinema, mua m’u sqarua jeta e tyre pas pesëdhjetë viteve; qeshja e tyre të sotme pas pesëdhjetë vite e pashë se u shndërua në vajtime të hidhura. Pastaj dolën në shesh këto vërteta që do t’ua rendis. Domethënë, jeta e tyre pas pesëdhjetë viteve me një kinema shpirtrore m’u shfaq se: nga

gjashtëdhjetë vajza që ishin aty pesëdhjetë; në varr ishin bërë dhe, dhe po vuajnë torturën e zjarrit. Dhjetë prej tyre që ishin arritë në shtatëdhjetë vjetë dhe ishin shëmtuar, për arsye se nuk kanë mbrojtur namusin e tyre dhe përballeshin me mërinë e secilit. Edhe unë fillova të qajë. Në këtë rast m'u shfaq intriga e kohës së fundit që ka paralajmëruar Pejgamberi a.s.m: Intriga më e ashpër dhe më e tërheqëse e kohës së fundit do të bëhet nga fytyra e grave të pafytyra: nga shkakut I sulmit të tyre meshkujt nuk do të mundin t'i dalin zot vullnetit të tyre, e fluturim do të kërcejnë në zjarrin e seksit. Në këtë rast meshkujt për qejfin e një minuti të kësaj jete sakrifikojnë shumë vjetë të asaj jetës së përtejshme.

Një ditë unë duke shikuar sokakun pashë një shembullim të kësaj intrige. Pas tij të rinjtë m'u dhimbsën shumë dhe thashë: “këto të rinjtë e pafatë nuk do të mundin të shpëtojnë vehten nga ky magnetizëm tërheqës”. Unë duke kujtuar kështu momentalisht m'u drejtua përpara një person shpirtore që duke praktikuar pati dhënë flakën e asaj intrige. Unë duke iu drejtuar atij dhe mësuesve të tij mosbesues që e kanë mësuar atë kështu u thashë:

Or ti pafat! Që mundohesh të bësh qejf me hyritë e xhehennemit dhe me vullnet ke pranuar devijimin dhe ke dalur në rrugë për të plotësuar qejfin e veseve epshore përpiqesh të përhapësh ateizmin dhe ti je ai që duke dashur jetën, trembësh tmerrësisht nga vdekja dhe don fare ta mendosh atë. Ti i devijuari i pafat! Saktësisht dije se: Me mosbesimin tënd, bota jote madhështore, sa një orë para këtij çasti dhe një minutë pas kësaj, dhe gjithësia jote, e kaluara dhe ardhmëria e jote, i tërë fisi që të ka ikur dhe tërë qeniet e ardhshme së bashku me brezin tend, botra dhe popuj të kaluar dhe njerëzit dhe karvanet që do të vijnë, për ty kanë vdekur tërësisht. Tani me anën e mendjes e me njerëzinë tënde që interesohesh, tërë botrat e tua dhe universet në kokën tënde të devijuar, përmbi kokën tënde vazhdimisht të rrëzojnë mjerime dhe vdekje të hidhura. Po qe se ke vetëdije ato ta dëgjin shpirtin... Po qe se ke shpirt ta përvëlojnë... Në qoftë se ty nuk të ka shuar mendja, ato të gulçitin me derte. Po qe se vetëm një orë dehja dhe qefet e tua të pista mund të përballojnë brengat dhe hidhërimet të panumërta që ke, atëhere mos i braktis, aty qëndro... Përndryshe mblidhe mendjen!. .Dhe dëgjo Kur'anin Famëlartë! Vetëm kështu mund të shpëtosh shpirtërisht nga kjo gjendje e xheh-henemit. Që të kënaqesh në xhennetin e lumtur përpiqu e zotro besimin e fesë së vërtetë - të fesë islame... Dhe shijen e pakët të përkohshme të një minuti; shndëroje me shijet e shumta të vazhdueshme të besimit(*)

(*) Ja pra edhe kjo botë mund të të japë ty shpirtërisht.shijet e xhennetit. Nga qindra dritat e tija shikoje vetëm njërin. Përsëmbull: Ti je duke pare një afërmin tënde në minutin e fundit të rrezikut të vdekjes. Në këtë rast supozojmë se erdhi doktor Lukmani apo Hizri. Dhe momentalisht ta shpëtuan nga vdekja dashamirin tënd. A ma tregon se sa gëzohesh në këtë çast ... Njësoj ty besimi mund të garantojë një gëzim për shpëtimin nga zhdukja të gjithë dashamirët e tu me të cilët ke pasur lidhje. Sepse besimi i ngjallë miliona dashamirët e tu që janë në varrezat e kaluara që kanë qenë duke zhdukur, momentalisht gjallohen dhe bërtasin duke thënë “Ne nuk kemi vdekur dhe nuk do të vdesim”. A nuk është një kënaqësi e madhe kjo gjendje që e tërheq hidhërimin e ndarjes dhe takohesh me të afërmit që janë gjallë. Besimi për ty edhe në këtë jetë a nuk të ka garantuar një gjendje gëzimi që nuk tregohet: sepse besimi është i tillë që besimtarëve ua garanton xhennetin me tërë shijet e tij që ka... Dhe do t'ua garantojë”

Dhe mos thuaj se: “Unë do të kaloj jetën si kafsha duke mos menduar gjë” Sepse për kafshën nuk ekziston as e ardhmja, as e kaluara. I Gjithëdhijëshmi Mëshirëplotë; që ti shpëtoj nga dhimbjet e panumërta atyre (Kafshëve) nuk ia ka treguar fshehtë. Derisa edhe kur e marrin ta presin kafshën, ajo nuk ndien asnjëfarë dhimbjeje apo pikëllimi. Ajo, në momentin kur e pret me brisk

në fyt don të ndiejë dhimbje, prapë ikën dhe nuk ndjen dhimbje fare. Domethënë mëshira e madhe e All-llahut është që atyre nuk ia tregon fshehtë. Veçanërisht ndaj kafshëve pa faj ajo është më e përsosur. Domethë, ti kur shijohesh me gjërat e palejuara atëhere bie mijëra herë më poshtë se kafsha dhe nuk mund t'i arrish kafshët. Sepse mendja jote po i sheh ato gjëra që për kafshën janë të fshehta, dhe prej tyre po merr hidhërimet. Ti je tërësisht i vobektë nga qetësimet sepse ti i shikon hidhërimet.

Dhe ti që lavdërohesh me virtytet e mira siç janë humanizmi, respekti e vëllëzërimi, prej tyre mund të shijosh aq pak që, sa në fushën e madhe janë vetëm sa një gisht dhe nga koha e pafundme sa një orë. Nga mosbesimi ato të tuat janë të pathemelta, të përkohshme, artificiale, mashtruese dhe janë shumë të pakta, që duke u zvogluar ta rrëzojnë njerëzimin dhe sedrën tënde, bile ta zbresin në asgjë. Por vëllazërimi, nderi, dashamirësia, humanizmi i besimtarëve, që besimi atyre ia garanton bindjen në kaluarën edhe në ardhshmërinë, u rrit atyre njerëzinë dhe përsosmërinë. Ti në këtë jetë a e di se sa sukses ke... Suksesi yt i ngjan një arkatari çmendur që copat e qelqit i blen me çmimin e diamantit. Sepse ti kohës së pakët dhe jetës së shkurtër, je duke i dhënë çmimin e kohës së gjatë e gjerë e të përjetshme. Pra, ti me siguri në atë kohë të shkurtër nga ambicia që do të jetosh pak do t'i ngadhënjesh besimtarët. Sepse ti si dashurinë edhe hakmarjen e një minuti e përjeton me ndjeshmëri dhe ambicie të furishme dhe shpenzon energji aq sa të tjerët që shpenzojnë për një vit; për këtë përkohësisht mund të dalësh sipër fetarëve. Dhe për arsye se mendja, shpirti, zemra dhe shqisat e tua duke lënë detyrat e larta, dhe duke i ndihmuar bashkëpunojnë me dëshirat e veseve të tua të ndyra, në këtë jetë del fitues mbi besimtarët dhe në pamjen e jashtme dukesh i dashur, sepse mendja zemra dhe shpirti yt duke shëndruar janë poshtruar shumë. Ato, duke shndërruar vlerat cilisore në veset e ndyra të epshit janë zhdukur. Atëherë nga kjo pikëpamje është e qartë se përkohësisht do të ishe fitimtar ti që do fitosh xheh-henemin ndaj besimtarëve të shtypur që do fitojnë xhennetin.

KËTË TEKST TË SHKURTËR TË MËSUESIT DUHET TË SHTOJMË NË PRIJËSIN E RINISË.

Që të mos preken gratë, duhet të tërhiqen faqet 23-24 të "Prijësit" që titullohen "Çështje e rëndësishme ardhur nga Mersini". Sepse profesia e rëndësishme të Mesazheve të dritës mbanë mëshirë, me një sinqeritet dhe seriozitet të jashtzakoshëm, gratë interesohen më tepër se burrat dhe në shërbimin e Risale-i Nurit ato vrapojnë më tepër se burrat. Për këtë arsye duhet patur kujdes që të mos thyhet zelli i shërbimit të tyre, sepse tërhiqet vemendja që vajzat muslimane të Stambollit të mos imitojnë vajzat e Romëve dhe të Ermenëve, duke u bërë gysëm lakuriqe si ato. Ndërsa, disa hipokritë të masonëve dhe disa gazeta që kundërshtojnë Prijësin e Rinisë, në ditët e fundit këtij problemi i kishin dhënë edhe kuptime të gabueshme dhe shpifjet e tyre për shërbimin e grave u bënë një shkak dobësimi për shërbimin e grave në Risale-i Nurit. Tani në vendin e këtyre faqeve vendosin bisedat dhe "Udhëzuesin e grave".

Said Nursi

(Shënim) Si më parë që fraksionet e fshehta përpiqeshin që të largojnë rininë nga feja ato duke e futur nëpër rrugë të liga; përsëri këto fraksione të fshehta afetare përpiqen që të largojnë gratë nga rruga e drejtë. Që të mos përballen me shpifje të fraksioneve jipuni atyre që të lexojnë nga një prej Prijësit të rinisë me gjithë tekstin që është deklaruar më parë. Në vendin e këtyre dy faqeve që do të hiqen, gratë le të lexojnë pjesën e plakave dhe të vajzave që është në librin "Udhëzuesi i grave"

MOMENTALISHT ZEMRËS SIME IU VËREJTUR PËR NJË ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME!

Në kohën e fundit (ahırzaman) rolin e ashpër që do të luajë karvani i femrave e kanë theksuar edhe Hadithet e Pejgamberit (a.s.m.). Ja pra, si në historinë e kohërave të lashta që tregohet për një karvan ushtarësh formuar nga gratë e armatosura titulluar “Amazonat” që kanë luftuar jashtëzakonisht shumë; njësoj edhe në këtë kohë, ateistët të çfrenuar në luftën e tyre përballë islamit, lëvizjen më të madhe do ta bëjnë me programin e formuar që nën komandën e shejtanit t’u jepen veseve epshore. Pra, karvanin e ashpër të femrave gjysëm lakuriqe, të atyre femrave me kofshë gjysëm lakuriqe që me ato thika sulmojnë ashpër besimtarët duke mbyllur rrugën e kurorëzimit e zgjerojnë rrugën e seksit, e robërojnë epshin e shumicës me seks duke ia plagosur shpirtin dhe zemrën e tyre. Ndoshta DISA PREJ TYRE I MBYSIN. Përballë disa vitesh që ua tregojnë të huajve vendet lakuriq, ato kofshë do të bëhen druri i xhehennemit. Që aty së pari do të digjen ato kofshë dhe nga arsyeja që në këtë botë kanë humbur besën, për të rehatuar nuk do të mundin të gjejnë burrin që të martohen, se në krijimin e tyre atë e kanë nevojën më të madhe, ndonjëra edhe të gjejë jo tjetër, mbi kokën e tij ka gjetur një bela. Bile nga hadithet e Pejgamberitky kuptohet se, në kohën e fundit nëpër disa vende duke mos vlerësuar kurorëzimin femrat aq do të zhvlerësohen sa që një burrë i vetëm do t’i mbrojë dyzet gra.

Meqë e vërteta është kështu, dhe meqë e bukura e don bukurinë e saj, me një zell të jashtëzakonshëm përpiqet që të mos t’i dalë ajo nga dara e saj, jeton duke mos dashur që ti prishet bukuria. Dhe meqë bukuria është një mirësi, pra, kush falenderon mirësinë- bukurinë që ia ka Zotit xh.sh. asaj i shtohet bukuria, por po qe se nuk falenderon ajo shndërohet e shëmtohet.

Atëherë është e sigurtë se kush ka mend, nuk do ta shpërdorjë bukurinë që ta prishë atë duke u futur në mëkate, dhe të bëhet shkak që ta sodisin mashkujt që të hyjnë edhe ata në mëkate. Pra bukuria e saj duke qenë një mirësi, kur e shpërdoron atë, ajo bëhet një shkak torture.

Tani, me këto masa që parashtroam, mendoni vetë:- kush është e mençme a mund të zbulohet që ta hedhë vehten në zjarr?! Por po qe se don ta përjetësosh bukurinë e 5 apo 10 vjetëve, ato mbroje vetëm për burrin tënd, atëherë ajo quhet një falenderim për bukurinë që e ke.

Përndryshe, përveç torturës së Xhennemit, kur të plakesh do të përballesh edhe me mëri; duke mbetur pa shpresë, në periudhën e moshës së gjatë do të qash.

Por, po qe se do të jetosh në rrethin e edukimit të fesë islame dhe do të hijeshohesh me bukurinë e Kur’anit, atëherë ajo bukuria e përkohshme, shpirtërisht do të shndërrohet, në jetën përjetshme dhe në Xhennetin e lumtur bukuria e jotja e ndritshme do të tejkalojë edhe bukurinë e hyrive (vajzave) të Xhennetit dhe nuk ka për të ikur kurrë. Pra, ajo vazja e bukur, po qe se ka sa një grimcë mend nuk do ta humbë këtë rezultat të shkëlqyer që nuk soset asnjëherë.

بِسْمِهِ سُبْحَانَهُ وَأَنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ
الْسَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ أَبَدًا دَائِمًا

Të nderuar vëllëzërit e mi të sinqertë!

“Ky është një mësim dhe një vërejtje për të rinjtë që janë në rrezik. Me këtë mund të kuptojnë se sa i vlefshëm është për nxënësit e Nurit me moshë të re orientimi me synnetin e Pejgamberit (a.s.m.).që ata të mbajnë sjelljet e bukura të islamit. Këtu vërtetohet se rinia e vërtetë është forma e të rinjve fatbardhë. Në këtë rast në gjendjen të bukur të nxënësve të Nurit mund ta shihni cila është në të vërtetë rinia e popullit Turk.

الْبَاقِي هُوَ الْبَاقِي

Vellai i juaj
Said Nursi

PËR DISA TË RINJ ËSHTË NJË MËSIM E NJË VËREJTJE.

Një ditë m'u afruan disa të rinj të shkëlqyer për të më kërkuar një këshillë ndikuese për t'u mbrojtur nga jeta e shfrenuar e rinisë. Ua dhashë të njëjtën përgjigje që u pata dhënë atyre që kërkoheshin medet nga Risale-i Nuri:

Është e padyshimtë se rinia e juaj do të ikë. Po që se s'do të mbetni në rrethin hallall, atëherë rinia e juaj do të zhduket, por kjo rini si në këtë jetë, edhe në varr edhe në jetën tjetër do t'iu sjellë në kokat tuaja më tepër bela se sa shije. Por nëse mirësinë e rinisë suaj e mbron me falenderimin e edukatës së fesë islame, duke e përdorur atë pa asnjë shpërdorim ndaj ligjeve të fesë së vërtetë, atëherë duke përjetuar atë, rinia e juaj do t'iu bëhet shkak që të përjetoni lumturinë përrallore në Xhennet.

Por, po që se nuk zotëroni besimin në këtë botë, dhe po që se kundërshtimi i juaj ndaj fesë e pengon ndikimin e besimit, atëherë në dukje jeta e juaj gjoja merr nje shije të pakët, por mijëra herë më tepër ajo ju ndëshkon me shqetësime shpirtërore. Sepse mendja e meditim, përkundrejt kafshëve, e lidh njeriun edhe me të kaluarën edhe me të ardhmen; jo vetëm me këtë kohë por edhe njëkohësisht; mendja të pushton me shijet edhe me hidhërimet e atyre kohëve. Por për arsye se kafsha nuk mbanë meditim, përkundrejt njeriut, asaj, as hidhërimet e kohës së kaluar as frika e së ardhmes nuk ia prishin shijen e jetës. Por njeriu, në qoftë se ka rënë në devijim apo është i pakujdesshëm, atëherë hidhërimet e kohës së kaluar dhe frika e së ardhmes, duke ia bërë jetën helm, ia prishin shijen që ekzistonte, domethënë se njeriu këtu nuk mund të marrë shije as sa për gjendjen e shijes së kafshëve. Ndërsa ekzistenca e jeta e atyre që kanë rënë në devijim dhe janë të pakujdesshëm është vetëm dita e sotme; njëkohsisht të gjitha kohrat e botërat e kaluara në pikëpamjen e devijimit të tij kanë vdekur dhe janë zhdukur. Mendjen atij ia rrëzon vazhdimisht errësira e frika, kurse me mosbesimin e tij prej mohuesi edhe koha e ardhme nuk ekziston, sepse ndarjet e përjetshme që përballohen me zhdukje, i derdhin vazhdimisht errësirë në rrugën e meditim të jetës së tij.

Por, po që se besimi ia ngjall atij jetën, atëherë do të ndriçojnë me dritën e besimit e kaluara me gjithë ardhmen dhe do të bëhen nga njëta ekzistencë. Në dukje si koha e tashme edhe e ardhmja e tij ndriçohen, duke ia garantuar atij shijet e larta trupore. Këtë çështje mund ta shikoni edhe në “Mesazhet për pleqtë”, meqë aty është sqaruar mjaft mirë.

Ja, e patë se çfarë është jeta... Pra po që se doni të kënaqeni me shijet e jetës, jetën tuaj ngjalleni me besim dhe hijeshojeni atë duke ua nënshtuar urdhërave të All-llahut xh.sh. dhe mbrojeni atë duke u mbrojtur nga mëkatet.

Në secilën ditë, në secilin vend dhe në çdo kohë që kufomat dhe vdekjet na tregojnë fytyrën e tmerrshme të së vërtetës së vdekjes. Pra këtë do t'ua tregoj edhe ju, duke sqaruar siç u kam treguar edhe të rinjve të tjerë që më pyetën.

Si përshembull: Këtu para syve tuaj është ngulur një trikëmbësh për të varur njerëz; pranë saj një llotari, por ajo nuk i ngjan llotarive tona, sepse shet bileta me shpërblime të jashtëzakonshme. Në gjithsej dhjetë vetë që jemi këtu, pa tjetër dhe pa kurfarë alternative do të ftohemi aty, në një kohë që ajo nuk na është bërë e njohur fare duke na thënë se: “Eja merre biletën e ekzekutimit dhe hipë në trekëmbëshin.” Apo: “Eja merre biletën e shpërblimit që të ka dalë prej një miliardë florinjsh.” Tek dera ku ne jemi duke pritur këtë biletë, arritën dy njerëz: njëri ishte një femër e

bukur që ishte gjysëm lakuriq dhe mashtruese, duke patur në dorë ëmbëlsira me helm dhe perpiqet që të na mashtrojë që të na shtyjë t'i hamë ato dhe tjetri ishte një burrë serioz që asnjëherë nuk mashtrohet dhe nuk mashtron kënd. Duke hyrë pas asaj femre, burri na tha ne: Ja, ua solla një ilaç të efektshëm e një mësim. Në qoftë se e lexoni këtë dhe nuk e hani atë ëmbëlsirën që u a dha ajo, atëherë do të shpëtoni nga ekzekutimi dhe plus do ta merrni letërën e dhuratës së florinjve. Tani edhe vetë jeni duke parë se kush ha nga ato ëmbëlsira që dha ajo, po ikën nga tri këmbëshi për të ekzekutuar, bile deri po shkonin aty sa nga helmi e saj i tmerrshëm po u dhëmb stomaku. Në dukje edhe ata që po marrin biletën e shpërblimit aty po ikin bashkë me të tjerë duke hipur në trekëmbësh. Por miliona persona të drejtë na dëshmojnë se, ata nuk po ekzekutohen, ndoshta ata trekëmbëshin po përdorin si shkallë që të hipin për të marrë biletën e shpërblimit. Ja shihni nga dritaret e fjalëve të nëpunësit më të lartë dhe dëgjoni personat që kanë lidhje me këtë. Ata me zë të lartë po na lajmërojnë duke thënë se: besoni sikur po e shihni me sy, dhe mos dyshoni fare se, ata që përdorin ilaçin magjepsës e morën biletën e shpërblimit të dhuratës së madhe.

Tani si ky shembull që treguam, mëkatet e qejfet e të rinjve janë në rrethin e palejuar njësoj si mjalti me helm. Dhe me siguri qejfet çfrenuara janë shkak që të humbim biletën e thesareve të përjetshme, pra besimin. Se ato janë shkak që vdekja të bëhet dera e ekzekutimit për të përfunduar në pellgun e thellë të errësirave të tmerrshme. Pra a nuk duhet të trishtohemi nga “exheli”, vdekja, që mund të vijë pa u dalluar si xhelat të marrë shpirtin e plakut, por edhe të të riut njësoj mund t'ia këpusë kokën duke ia marrë shpirtin. Por, po qe se duke i rënë shqelm e braktisim jetën e shfrenuar, që është si një mjalt plot me helm dhe nga e cila na ka ndaluar Zoti i Madhëruar, po qe se në jetën tonë kur i përdorim ilaçet e magjepsëse të Kur'anit dhe kur zotërojmë një besim të fortë dhe kur zbatojmë urdhërat e Tij, ne do të marrim biletën e lumturisë së përjetshme që mëshira e All-llahut xh.sh ua ka premtuar njerezimit dhe se atë e vërtetojnë pa dyshim njeqindenjëzet ekatër mijë Profetë së bashku me evlijatë që janë të panumërt, të cilët në jetën e tyre kanë sqaruar “Qeramete” (mrekullitë) dhe vërtetuar veprat e besimit.

Fund: Rinia do të ikë... Në qoftë se ke kaluar jetën duke mos larguar nga mëkatet; atëherë si kjo jetë, edhe ajo e tjetra do të kalojë me fatkeqësira e bela. Kjo jetë është shkak që nga abuzime dhe sëmundje dhe nga vesvese të bini nëpër vende të liga që nuk pajtohen fare me jetën njerëzore; prapë jeta çfrenuar është shkak që nga shqetësimet që vijnë nga jeta çfrenuar të vraponi nëpër pijetore për t'u bërë pijanecë dhe përkohësisht ajo ju largon shqetësimet e mendjes suaj. Po qe se nuk më zini besë se këto ua sjellë rinia çfrenuar, shkoni e pyetni nga spitalet, burgjet dhe nga varrezat duke u thënë atyre se:

“Çfarë ju solli në këto vende, a nuk ju solli rinia e shfrenuar?!”

Pa dyshim është se nga gjuha e gjendjes së spitaleve do të dëgjoni gjësimet e mjerueshme të atyre që kanë shpërdoruar mirësinë që ua ka dhënë All-llahu xh.sh. Njësoj ankesat e të rinjve do t'i dëgjosh edhe nga burgjet që nga ndëshkëmet bërtasin:” Ah çfarë na bëri jeta jonë që e përjetuam duke i kundërshtuar hyjnisë sonë, kurse edhe ndëshkimet e torturat e varrit bëhen më tepër nga abuzimi i rinisë. Këtë e vërtetojnë edhe “Keshfelkuburut” (evlijatë që e shohin gjendjen e kufomave në varreza) së bashku me të gjithë njerëzit që lëvizin në rrugën e drejtë të fesë islame.

Për Këtë mund të pyesni edhe pleqtë e të sëmurët që përbëjnë shumicën e njerëzëve. S'ka dyshim që se do të merrni përgjigjen plot pikëllime të mjerueshme. Ata duke ankuar tregojnë se çfarë u ka sjellur periudha e rinisë, duke thënë:” Ah të mjerët! Rininë e kaluam në vende, të dëmshëm dhe boshe. Mosni, mos bëni edhe ju si ne!” Sepse për pesë apo dhjetë vjet të shijeve pa lejuara të rinisë, këtu, në këtë jetë, do të vuajmë shumë vjet pikëllime, në jetën e varrit torturë e

dëm, në jetën e ahretit belanë e xhehennemit të “Sakar”, bile edhe duke vuajtur këto ndëshkime

اراضى بالضرر لا ينظر له

me sekretin

që thotë: (Kush pranon dëmet

me kënaqësinë (vullnetin) e tij ai nuk meriton mëshirë)

Pra: All-llahu i madhëruar ju dhe ne së bashku na shpëtoftë nga forca tërheqëse e kohës së fundit të ahër zamanit! Amin!

ËSHTË NJË PËRGJIGJE PYETJEJE TË NXËNËSVE TË NURIT

Pyetëm mësuesin: “Për ç’arsye që prej dhjetë vjetësh, as nga ne as nga Emini që të shërben ty, duke mos i dhënë rëndësi fare nuk pyet për çështjen më të serioze të luftës së tmerrshme botërore (Lufta e Dytë). Vallë a gjykon ndonjë gjë më të rëndësishme se kjo çështje që nuk e vlerësoni fare atë?

Apo interesimi për to është i dëmshëm.” Mësuesi na u pergjigj kështu:

Ja pra çështja e luftës botërore pranë çështjes serioze që ekziston është një gjë shumë e pavlerë.

Sepse çështja e luftës botërore në të cilën dy shtete mundohen ta marrin sundimin e botës në dorë, pranë Gjykimit të Madh, që do të bëjnë debat për fetë qiellore me afetarët dhe me anë të debatit që do të kërkojnë drejtat e tyre borgjezët nga socialistët që do të ishte një padi aq e madhe sa që sasia e pjesës së njëriut të vetëm është më e madhe se sa rëndësia e luftës botërore.

Ja ajo padi është që: Në këtë kohë për secilin besimtar, bile për secilin njeri, është hapur një padi për një pronë sa kjo bota, me begati përrallore, hijeshuar skaj më skaj me kopshte e vila që nuk ta merr mendja dhe mosha e tyre në të nuk do t’i soset kurrë. Domethënë në kokën e secilit njeri ashtu është hapur një plagë që: në qoftë se ato kanë mend, po të kishin pronë e fuqi sa shteti Anglez së bashku me atë Gjerman, për të fituar atë padi do t’i sakrifikonin të gjitha. Pra në këtë rast me të vërtetë është i çmendur ai, që pa e fituar këtë, merret me të tjera gjëra. Ndërsa në këtë kohë ajo padi aq ka rënë në rrezik sa që një evlija kishte konstatuar se në varreza nga dyzet të vdekur vetëm një e kishte fituar padinë, pra kishte vdekur me besim, tridhjetë nëntë të tjerë e kishin humbur atë.

Tani si ka mundësi të braktisim atributin e një padije të rëndësishme që kryen detyrën e Avokatit duke shpëtuar padin e 80% të njerëzve.

Pra ai që s’është çmendur nuk do t’i braktisë shërbimin dhe përpjekjet që ai të përfitojë avokatin e fortë që atë e mbron prej zhdukjes së përjetshme, gjë që për të mban rëndësinë mbi të gjitha.

Pra, mijëra njerëz dëshmojnë se në këtë kohë patjetër ai mbrojtësi (avokati) parë i padisë është Risale-i Nuri që ka buruar prej mrekullisë shpirtërore të Kur’anit famëlartë.

Ja pra, në këtë botë secili njeri është i dërguar me detyrë të rëndësishme, këtu është një mysafir i përkohshëm dhe krijimi i tij na tregon se patjetër do të ikë në një jetë të përjetshme. Ndërsa është e padyshimitë se në këtë kohë janë tronditur shkaqet e jetës së përjetshme që e mbrojnë kalanë e besimit: Në këtë rast a nuk është e nevojshme të përpiqesh që ta fitosh padinë e pasurisë së përjetshme që është mijëra herë më e mirë se kjo botë; duke patur aty me vete edhe të gjithë dashamirët që ke pasur këtu. Por po që nuk mund ta shpëtosh bindjen dhe besimin e fortë, do ta humbësh atë begati përrallorë. Vallë i cili send mund ta plotësojë vendin e çështjes së besimit që të kënaqet me një jetë të përjetshme?..

Tani duke patur parasysh këto të vërteta, ne me vëllezërit tanë, edhe sikur të kishim mend njëqind herë më tepër se sa kemi, shpirtërisht mezi do të mjaftonin për shërbimin e kësaj detyre madhështore. Në këtë rast, ne na duket e kotë të angazhohemi me gjëra të tjera, vetëm se nuk duhet të kundërshtoni nxënësit e Nurit që kanë braktisur shërbimin për mbrojtjet që kanë bërë ndaj sulmeve të pa shkak që i bënin të çmendurit, bile edhe këto na kanë detyruar të tjerët që të

bëjmë pa dashje.

Dhe duhet ta dini këtë se, ne na dëmtojnë interesimet për çështjet e tjera përveç çështjes sonë të madhe siç janë grindjet e debatet e kota. Ne ato nuk duhet t'i mendojmë duke anuar nga ata me zemër.

Sepse, a është e drejtë të tërheqësh vemendjen rretheve të gjera duke harruar detyrën që ke dhe të anosh nga entuziazmi i vetë politikës. Dhe me të vertetë ky është një gabim që të pengon nga shërbime të amshuara që ke. Kur kujdesesh ndaj të politikës mund të ikësh në rrjedhën e saj. Duke i humbur mendimet reale e humb edhe shëndetin e zemrës edhe nuk mund të mbrosh sinqeritetin që ke ndaj shërbimit dhe mund të mbetesh ndër faje. Bile, duke u gjykuar në gjyq kur më sulmuan, u thashë:

“Si ka mundësi të vërtetat e Kur’anit e te besimit të kërkojnë mbrojtje nga dritat të tua të përkohshme, kurse dritat të Kur’anit mbajnë një forcë tërheqse si dielli madhështor. Kush i njeh mirë Ato, ai ato nuk abuzon për gjërat e përkohshme të kësaj bote, bile ato nuk i shpërdoron edhe t’ia japësh gjithësinë madhështore” Në këtë mënyrë ua mbylla gojën atyre.

Këtu u mbyll pergjigja e mësuesit tonë.

Ne nxënësit e tij ia vërtetojmë me të gjithë fuqinë tonë

Nxënësit e Risale-i Nurit

بِسْمِهِ سُبْحَانَهُ

PREJ DREJTËPESHIMEVE TE RISALR-I NURIT KY ËSHTË NJË SHËNIM I POZITËS SË DYTË TË FJALËS SË TREMBËDHJETË.

Të burgosurit shumë kanë nevojë për ngushëllimet që i paraqet Risale-i Nuri. Veçanërisht rinia që e kanë shpërdoruar rininë dhe nga shuplaka - goditja e saj moshën e tyre te freskët kalojnë nëpër burgje të vështira. Parimet e Risale-i Nurit janë në vlerën e bukës. Ja pra në moshën e rinisë, tek njeriu ndikojnë veset më tepër se mendja, porse veset janë shqisa qorre që s’mund ta shohin ardhshmërinë. Për një gram shije që e ka përpara, e sakrifikon shumë nga shija e ardhmërisë, për shijen e hakmarjes që për një minutë e mbytë njeriun, vuan ndëshkimet e tetëdhjetëmijë orët e burgjeve; për qefin e një orë që bënë dhunë ndonjë namusit, vuan torturën e mijera ditëve dhe humbë lumturinë duke patur frikën e armiqve. Kur bëni këtë krahasim, këtyre mund t’u shtosh akoma që veset, të rinjve të pafatë, ditët e ëmbëla ua shëndërrojnë në jetë të hidhur dhe ata bien në gjendje që të dhimbsen.

Një shtet i madh i anës verore, duke përdorur veset e të rinjve, na tronditi veçanërisht ashpër me stuhira të këtij shekulli. Sepse vajzat e gratë e bukura të njerëzve që jetonin me nder të lartë, ato ua dhuroi të rinjve që lëviznin duke mos parë ardhmërinë. Sidomos kur i lejoi të lahen nëpër banjo femra lakuriqe së bashku me meshkuj, duke shtyrë të bëjnë seks aty, i dogji ata.

Bile të gjithë bota u trishtuan për arsye se vagabondëve dhe të varfërëve ua shpërndau mallrat e padronëve.

Tani në këtë shekull për t’i përballuar këto dy sulme të rrezikshme, të rinjtë e muslimanëve dhe të popullit turk është shumë e rëndësishme të zotrojnë shpatat e mprehta të Risale-i Nurit ,veçanërisht fragmentet që quhen “Argumentet e Besimit” dhe “Priyesi i Rinisë”. Përndryshe, të rinjtë e pafatë, si ardhmërinë e kësaj jete edhe lumturinë e ahiretit do ta zhdukin duke e shndëruar në torturë. Pra, të rinjtë duke shpërdoruar rininë po binin nëpër spitale dhe duke u mbështetur veseve çfrenuar po ndëshkohen me burgje dhe në moshën e pleqërisë ato do t’i pasojnë hingllimet e qarjet e tmerrshme.

Por, po qe se të rinjtë, rininë e tyre e mbrojnë me edukimin e Kur’anit dhe më të vërtetat e Risale-i Nurit, atëhere bëhen nga një hero dhe njëri i përsosur dhe nga një musliman i lumtur dhe

nga një sulltan krijesave të tjera.

Ja pra një i ri që ka rënë burg, ai po qe se nga njezetekatër orë të kapitalit të moshës vet, e ndanë vetëm një orë për të falur pesë kohët e namazit; dhe pendohet për mëkatin që është bërë shkak për të rënë burg. Burgu është duke e penguar atë nga mëkate të shumta. Në këtë rast për ardhmërinë e jetës së tij dhe për afërmit e tij dhe për atdheun bëhet i dobishëm, me moshën e tij të pesëmbëdhjetë viteve të rinisë do të fitojë rininë e paskajshme dhe shumë e ndritshme. Për këto që i radhitëm këtu janë duke dhënë sihariq dhe na vertetojnë këto vërteta që thamë këtu, të gjitha fetë qiellore me gjithë Kur'anin.

Ja pra, kur i riu jeton pa abuzuar rininë dhe kur falenderon për atë mirësinë e bukur të rinisë delikate, atëhere shijet e tij shtohen dhe kënaqësia e tij përjetësohet. Përndryshe si për afërmit edhe për atdheun dhe për popullin e tij bëhet një bela e keqe. Por, po që se i burgosuri është i dënuar pa të drejtë atëhere çdo orë që ai kalon në burg, vlen sa një ditë adhurimi; burgu për të bëhet një vend adhurimi, si në kohët e lashta kur njerëzit e devotshëm kanë hyrë nëpër shpella për të fituar jetën e ahretit. Po qe se i burgosuri është i varfër, plak apo ndonjë i sëmurë që i ka pritur me zell këto të vërteta të besimit, në këtë rast për secilën orë që ai kalon në burg përfiton nga njëzet orë adhurimi. Kjo fitohet vetëm me një kusht: kur pendohet dhe kryen farzet urdhëruara, dhe burgu për të bëhet një vend pushimi dhe një shkollë edukimi. Pra burgu për të është shumë më mirë se sa përjashtë, sepse aty mund të marrë një edukatë të bukur që të përballojë sulmet e gjynaheve që e sulmojnë andej e këndej. Kur të vijë dita që të dalë nga burgu, jo si një katil e hakmarës, por i provuar, i penduar, i sjellshëm dhe për popullin e tij bëhet një njeri i dobishëm. Derisa, kur i kishin parë të tjerët disa njerëz që kanë dalë nga burgu me moral të jashtëzakonisht të lartë që kanë marrë në burg nga Risale-i Nuri kishin thene se: Për të edukuar njerëz që i burgosin nga pesëmbëdhjetë vjet, është shumë më mirë që t'i shtyrin që të lexojnë Risale-i Nuri pesëmbëdhjetë javë dhe bëjnë më tepër dobi".

Meqë vdekja nuk po vdes dhe exheli është fshehtë, që nuk dihet se kur do të vijë dhe meqë nuk po mbyllet dera e varrit; karvanet që po vijnë grupe-grupe po shkojnë atje dhe po humbin; meqë Kur'ani i famshëm ne na tregon se vdekja për besimtarin është një shkak çlirimi nga ekzekutimi i përjetshëm dhe për ata që kanë rënë devijim dhe jetojnë shfrenuar është një ekzekutim që njeriun e ndanë përgjithmonë nga dashamirët. Atëherë patjetër dhe pa kurrfarë dyshimi; me i fatbardhë është ai që periudhën e burgut e kalon duke duruar dhe falenderuar All-Ilahun madhëruar dhe ditët e fundit i kalon duke bërë dobi nga Risale- Nuri nga ku merr mësimin e duhur dhe e vazhdon jetën në shërbimin e Kur'anit dhe të besimit islam.

Or ti njeri që s'mund t'i braktisë shijet e përkohshme të kësaj bote! Mua, në këtë moshën time 75 vjeçare, mijëra provat e mia më kanë bindur se:

Shijet e vërteta dhe kënaqësia e lumturia pa hidhërim është vetëm tek besimi dhe rreth të vërtetave të besimit. Përndryshe, secila shije e kësaj bote mbanë shumë hidhërim; bota jote duke të shijuar ty sa një kokërr e vetme e rrushit të, të godit dhjetë shuplaka dhe ti humb shijet e jetës. Or ju të pafat që keni rënë nëpër burgje!... Meqë jeni pikëlluar dhe po qaheni nga kjo jetë, përpiquni që në jetën tjetër të mos vuani hidhërim duke bërë dobi nga burgu, embëlsojeni dhe shndërrojeni në gazmend jetën tjetër. Se duhet ta dini se nganjëherë nën kushtet vështira, kur përballë armiqve bëhet një orë rojë mund të vlejë sa një vit adhurimi. Njesoj edhe orërat tuaja të ibadetit që po bëhen nën këto kushte të vështira për ju mund të kthehen në mëshirë dhe vlejné sa shumë orë të adhurimit.

بِسْمِهِ سُبْحَانَهُ السَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ

Të nderuar vëllezër të singertë!.

Për ata që janë në burg dhe për personat që ua sjellin ushqimin shokëve që janë në burg, do t'ua tregoi një ngushëllim të fortë brenda tri pikave.

Pika e pare: Për secilën ditë që kaloni në periudhën e burgut mund të të garantojë sevapin e dhjetë ditëve të adhurimit. Dhe frutet e orës së jetës së përkoshme shpirtërisht mund të të kthehen në një jetë të përjetshme. Dhe pesë apo dhjetë vitet të dënimit tuaj mund të të bëhen shkak që të shpëtosh prej dënimit të përjetshme. Për besimtarët paraqita këto fitime të mëdha që janë shumë të vlefshme mund të fitohen vetëm me një kusht: kur i fal namazet farz dhe duke duruar, kur falenderon All-llahun xh.sh. dhe kur pendohesh për mëkatet që të kanë sjellë në burg. Por edhe vetë burgu është një shkak që të pengon nga shumë mëkate.

Pika e dytë: si humbja e shijes që është një pikëllim po ashtu edhe kur të ikin dhimbjet të vijnë shijet.

Ja, secili kur mendon ditët që i kanë kaluar me shije e gazmend e ndien pikëllime të hidhura, bërtet duke thënë “ah i mjeri!”. Njësoj kur mendon për ditët që e kanë pikëlluar atë; kalimi i tyre të shtynë të marrësh frymë lirisht dhe të thuash “oh shyqyr, iki duke braktisur sevapet”.

Domethënë pikëllimet e një orës që kanë kaluar në shpirtin tënd braktisin shijet shpirtërore, kurse orët që ke kaluar me shije, ato përkundrazi, pasi ikin të pikëllojnë. Meqë e vërteta është në këtë drejtim, dhe meqë orët e fatkeqësisë janë zhdukur megjithë pikëllimet e tyre dhe ditët e fatkeqësisë së ardhmërisë tani nuk na shqetësojnë ne: A nuk është i çmendur ai që sot vazhdimisht pi ujë e ha bukë nga mundësia që pas disa ditësh mund të mbesë i uritur dhe pa ujë?! Njësoj, a nuk është një çmenduri më e madhe se ajo që, duke humbur durimin kur mendon edhe pikëllimet e keqësive të ditëve ardhshme dhe të kaluara të cilat sot nuk ekzistojnë fare. Ti që duke u ankuar nga All-llahu thua:” of ç’më gjeti “,dhe nuk shikon gabimet e tua, gjë që është një gafë e madhe. Por, po qe se durimin që e ke nuk e shpenzon djathtas apo majtas, atëherë duke e përmbledhur vetëm në këtë orë e në këtë ditë, atëherë ty të mjafton durimi. Në këtë rast niveli i pikëllimit tënd nga dhjetë mund të zbresë në një të vetëm. Derisa (jo për ankesë) kur unë u burgosa së treti në Medresenë e Jusufit (a.s.) (mësuesi burgjet i konsideronte mësonjëtoare e Jusufit (a.s.)) brenda disa ditëve që fizikisht dhe shpirtërisht vuajta plot ndëshkime e pikëllime të ashpra; veçanërisht shpirtin e zemrën ma ndëshkuan shumë atëhere kur më pengonin të mirrem me shërbimet e Nurit, por falenderoj All-llahun që nga ndëshkimet që pata më shpëtuan ato mendime të vërtetave që ua rradhita më parë. Sepse unë duhet të falenderoj shumë se një të pafatin si unë, që jam duke pritur në derë e varrit, ma zgjatën moshën dhe orët që i kaloja me përkujdesje ndaj jetës tjetër, shyqyr fatkeqësitat ma zgjatën moshën duke i bërë nga dhjetë orë adhurimi.

Pika e tretë: Me pak punë ata fitojnë shumë kur i shërbejnë të burgosurve për nevojat që kanë duke u ndihmuar atyre, si duke ua sjellë ushqimin, ashtu edhe me fjalë të bukura kur u japin ngushëllime. Në këtë rast në fletoret e tyre regjistrohen sevape, njelloj si ata që janë për jashta dhe japin sadaka. Veçanërisht sevapi i shtohet shumë kur u shërbehet pleqve, të sëmurit, të varfërit apo një personit që është në kurbet.

Tani, si thashë edhe më parë shërbimi që të bëhet për kënaqësinë e All-llahut xh. sh., ka nevojë të përputhet me kushtet e saj, pra falurit e namazit farz dhe kushti i dytë është në shërbimin e tyre të vraposh me sinqeritet duke mos pritur fare mirënjohje prej tyre.

بِسْمِهِ سُبْحَانَهُ وَأَنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ
السَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ أَبَدًا دَائِمًا

4)

Vëllezër musliman të burgosur me mua!

Më thotë zemra ime që t'ua tregoi një të vërtetën që ajo t'ju shpëtojë nga tortura e kësaj bote me gjithë atë të tjetrës.

Si shembull; njëri e kishte mbytur vëllanë e njërit apo një afërmin e tij. Më pas këtij i del përpara një afërm i mbyturit; ky që për një moment fiton një shije hakmarjeje duke mbytur të parin duhet të vuajë miljona minuta angështime të zemrës dhe torturën e burgut. Njësoj edhe të afërmeve të atij që është vrarë jetojnë me shqetësime të hakmarjes, duke menduar se ku do të përballen me armikun i humbë tërësisht shija dhe lumturia e jetës së tyre duke vuajtur torturën e frikës dhe e hidhërime të kësaj gjendjeje. Kjo situatë ka vetëm një rrugëdalje. Ajo është pajtimi, siç ka urdhëruar Kur'ani duke regjistruar në të vërtetat e fesë së vërtetë të Islamit. Kjo rrugëdalje është dhe puna më e mirë sepse momenti i vdekjes është një moment që nuk ndryshohet. I vdekuri sigurisht nuk do të qëndronte më tepër se momenti që ika ardhur vdekja por katili është bërë shkak që të realizohet Gjykimi Hyjnor. Për këtë feja Islame na urdhëron me vëllanë musliman që të mos mbajmë hidhërim më tepër se tri ditë. Po qe se ajo ndodhi që u bë prej një armiqësie apo urrejtjeje, apo grindjeje me shtytjen e një hipokriti; është shumë e nevojshme që të realizohet paqa sa më shpejt. Përndryshe ajo fatkeqësi e vogël rritet dhe vazhdon. Po qe se pajtohen dhe katili duke u penduar fillon të lutet për mbytësin, në këtë rast të dy palët fitojnë shumë, dhe prapë mund të kalojnë si vëllai me vëllanë. Në vendin e një vëllau që ka vdekur mund të fitojnë disa vëllezër musliman duke falur gabimin e njëri-tjetrit, këtë do të mund të bënin vetëm ata që mbështeten në caktimin e All-llahut xh.sh.. Të braktisin hidhërimet është e rëndësishme veçanërisht për ata që janë bërë nxënës të Risale-i Nurit. Kjo është shumë e nevojshme si për qetësimin individual ashtu edhe për jetën shoqërore.

Ndikimin e këtyre parimeve Risale-i Nuri e sqaroi shumë mirë në burgun e Denizlisë dhe bëri që të gjithë të burgosurit duke qenë armiq të vëllazërohen me njëri tjetrin. Bile për të na liruar ne u bënë shkak këto parime, ndikimi i të cilave i shtyri edhe mosberimtarët dhe vagabondët që të thonë “Mashaall-llah!” Pas kësaj edhe të burgosurit u rehatuan. Unë në këtë gjendje, duke parë këto shembuj arrita përfundimin që: Nga shkak i një njeriu të vetëm po vuajnë angështime njëqind vetë, bile duke mos mundur të dalin përjashta bashkë të marrin frymë. Pra mund të mendoni vetë se a nuk është ky një dëm, kurse një trim bujar për një interesin e tij të vogël kurrë nuk lejon që t'i dëmtojë besimtarët e tjerë. Po në qoftë se gabon përmenjëherë duhet të pendohet dhe kaq.

بِسْمِهِ سُبْحَانَهُ وَأَنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ
السَّلَامُ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ أَبَدًا دَائِمًا

4)

Të nderuar vëllezërit e mi të rinj dhe të burgosurit e vjetër!

Unë jam i bindur se; është një qëllim i bukur hyjnor që ju ka sjellur të vini këtu. Domethënë: këtu keni ardhur që Risale-i Nuri t'ju garantojë të vërtetat e besimit dhe të shpëtoni nga shtrëngimet e

burgut dhe nga shumë dëme të kësaj jete, duke mos lënë të kalojë jeta në vende boshe, duke ju mbrojtur të mos ua çojë jeta tjetër siç e keni çuar këtë jetë, duke u dhënë një ngushëllim të mirë ju ka shpëtuar nga brengosje të kota. Meqë e vërteta është në këtë drejtim; edhe duhet të bëheni si nxënësit e Nurit të burgosur në burgun e Denizlisë. Edhe vetë po shihni se: po kontrollojnë të gjithë rrobat tuaja që vijnë nga jashtë, bile edhe bukën e supën, që të mos hyjë ndonjë brisk për të mos sulmuar njëri-tjetrin. A nuk po shihni se po vuajnë ndëshkime gardianët që ju shërbejnë me sinqeritet dhe nuk po mundeni të dilni të gjithë së bashku përjashta. Gjoja do të sulmoni njëri tjetrin si ndonjë egërsirë.

Tani ju shokët e rinj që në vetvetë jeni duke mbartur damarin e heroit!

Në këtë kohë më një trimëri të madhe shpirtore i thoni komisionit të gjyqit se: “Jo brisk, po edhe të na jepni pushkë, mauzerë dhe revole; bile edhe të na urdhëroni, prapë ne nuk do t’i ngacmojmë shokët tanë të pafat. Edhe sikur të kishim qindra armiqësitë mëparshme, do t’i hedhim ato, duke u përpjekur që ti mos hidhërojmë shokët tanë, do t’i falim hakun tonë duke bërë hallall, duke marrë këto urdhëra nga Kur’ani famëlartë dhe nga vëllazërimi i fesë Islame. Në këtë mënyrë e kemi marrë vendimin”. Vetëm në këtë mënyrë mund ta ktheni burgun në një mësonjëtoare fisnike.

SHTOJCË E POZITËS SË DYTË TË SË TREMBDHJETËS FJALË

ËSHTË NJË ÇËSHTJË E RËNDËSISHME QË MË KA VËREJTUR NË NATËN E KADRIT

Një të vërtetës së gjatë që më ka vërejtur zemrën time në natën e Kadrit do t’i biem shkurt. Tillë: Me tirani të pashoqe shkatërruan pa pikë mëshire njerëzimin në Luftën e Dytë Botërore duke bërë dëme të madha, ku për një armik të vetëm shkatërruan qindra njerëz të pafajshëm duke i lënë ata në pashpresshmërinë e tmerrshme. Bile edhe fituesit i futi në telashe që të mbrojnë sundimin dhe i torturoi edhe zemrat e tyre, duke u përpjekur që të rindërtojnë vendet e shkatëruara. Sikur t’i shtojmë këtyre shkatërtimeve edhe të gjithë shijet e botës, të gjitha janë të përkohshme dhe fantazitë e qytetërimit të rremë që mundohen të na bëjnë pijanecë, nuk po mundin të mashtrojnë ndërgjigjen e njeriut, sepse ato që radhuam, i kanë plagosur tmerrësisht virtytet cilisore të mbarë njerëzimit dhe nën shpatën e diamantë të Kur’anit është coptuar pakujdesia e devijimit të rremë që ka rë në pellgun e batakut të natyrës duke bërë që në këtë mënyrë, të dalë në sipërfaqen e gjerë fytyra e vërtetë e mizorisë së keqe të politikës. Këto, medoemos dhe padyshim, na tregojnë se njeriun nuk po mund ta ngopë kjo botë kalimtare që është një dashror i rremë. Shenjat e kësaj kanë filluar të duken në Veri dhe në Perëndim dhe në Amerikë .Që njerëzimi me tërë fuqinë do të kërkojë një jetë të përhjetshme që mbanë në krijimin e tij dhe prapë është padyshim se njerëzimi do ta kërkojë Kur’anin që një mijë e treqind e gjashtë dhjetë vjet, në secilin shekull ka mbi njëmijë e treqind milion nxënës të vërtetë që duke dëshmuar vërtetojnë padinë dhe gjykimin e Tij, dhe në secilin minutë miliona Hafizat duke respektuar Kur’anin që mbajnë në zemrën e tyre dhe me gjuhët e tyre njerëzimit ia mësojnë Atë. Dhe Kur’ani famlartë, duke dhënë sihariq për jetën të përhjetshme, u jep mësim në një formë që nuk i ngjanë asnjë libri. Dhe me qartësi shenja ky Kur’an famlartë, ndoshta me dhjetra mijëra ajetet e Tij na lajmëron jetën tjetër duke na shëruar plagët e njerëzimit; ndoshta në njëmijë vende na jep myzhde. Duke dhënë argumente të forta, duke mësuar na thotë se, mos humbni shpresën se në qoftë se njerëzimi nuk do ta humbë tërësisht mendjen dhe ne qoftë se në kokat e tyre nuk krisë materjalisht apo shpirtisht kjameti, sikurse priftërinjtë e Suedisë, Norvegjisë, Finlandës dhe Anglisë që po përpiqen që ta pranojnë Kur’anin, ashtu edhe shoqata të rëndësishme të Amerikës që përpiqen të gjejnë fenë e vërtetë. Këto do t’i pësojnë edhe kontinentet e gjerë të

botës dhe shtetet e mëdha të tyre që po kërkojnë Kur'anin famlartë dhe që po i kuptojnë të vërtetat e Tij dhe do të lidhen me shpirt me Të. Sepse në pikëpamjen e kësaj të vërtete Kur'ani nuk ka shok dhe kurrë s'mund të bëhet. Dhe asnjë send nuk mund të zëjë vendin e ij.

E dyta : Meqë shërbimi i Risale- Nurit në dorën e mrekullisë së madhe të Kur'anit është një thirrës dhe një shpatë diamante dhe armiq të Tij i ka detyruar zemrën dhe ndërgjegjen e tyre të dorëzohen, duke i bindur plotësisht ,u ka dhënë ilaçet e efektshme. Sepse Risale-i Nuri është mrekullia e Kur'anit dhe prej tij ka buruar dhe po kryen plotësisht detyrën e duhur të kësaj kohe. Dhe me librin “Përgjigje natyralistëve“ i ka mundur kundërshtarët e tij të flaktë, duke ia shkatërruar kalanë e tmershme të natyralistëve, duke ia bërë copë me copë natyrën e tyre. Njësoj edhe me çështjen e gjashtë dhe të tetë të librit “Shkopi Musait”dhe me çështjen e parë, të dytë dhe të tretë në sipërfaqen e gjerë dhe me një formë shumë të shkëlqyer ka thyer pakujdesinë e shkencëtarëve fizikë, duke u treguar atyre dritën e njësimi të Zotit të madhëruar.

Tani nevoja më e madhe për ne dhe për popullin tonë është që, zyrtarisht është dhënë lejë për mësimet fetare dhe për klasat veçanta. Meqë është kështu, në qoftë se është e mundur nxënësit e Nurit në çdo vend duhet të hapin nga një mësimtore për të lexuar veprat e Risale-i Nurit, Megjithëse edhe duke i lexuar në vetvete mund të bëjnë dobi, por nga që janë të vërtetat e besimit dhe secili veç e veç nuk mund të kuptojë mirë çdo çështje të saj. Sepse Risale- Nuri sqaron të vërtetat e besimit dhe duke bindur njeriut ia njohton Zotin dhe e sjell në praninë e Tij, ndërsa leximi i këtyre veprave quhet edhe adhurim.

Ndërsa në medresetë e vjetra për pesëmbëdhjetë vjet që merret një dije, nëpër medresetë e Nurit ai rezultati merret për pesë apo dhjetë javë dhe që prej njëzetë vjetësh kjo dije është duke argumentuar këto fjalë që thashë.

Pra, shteti jo vetëm që s'duhet të ngacmojë Risale-i Nurin që është shkëlqimi dhe thirrësi i Kur'anit, por është shumë e nevojëshme të ndihmojë në shpalljen e tij, sepse ai u sjell dobi popullit, atdheut, jetës politike të kësaj bote materiale si dhe të botës tjetër shpirtërore. Kjo vepra mund t'ua fshijë gabimet e vjetra duke penguar anarkinë dhe gjithë ato fatkeqësi që do të vinin në të ardhmen.

Said Nursi

Shpresa e shtatë: Në fillim të pleqërisë, kur të qeshurit e Saidit të vjetër u kthye në të qarët e Saidit të ri, adhuruesit e kësaj bote më konsideruan si Saidin e së kaluarës dhe më thirrën në Ankara. Shkova. Ishte aty nga fundi i vjeshtës. Hipa në kalanë e Ankarasë dhe vura re se ajo ishte më e moshuar se unë dhe ishte rrënuar. Ajo m'u paraqit si një gur i historisë së lashtë. M'u duk sikur aty lexova pleqërinë e stinëve të vitit, timen, të sajën, të racës njerëzore, të shtetit të osmanllinjëve të famshëm, vdekjen e kalifëve dhe plakjen e kësaj bote. Të gjitha sa konstatova, më futën në një shqetësim të hidhur dhe fillova të mendoj dhe të imagjinoj lumenjtë e kohës së kaluar, si dhe malet e së ardhmes. Brenda mureve të errësirës së pleqërisë, m'u shtua edhe ajo e gjendjes në Ankara, që më mbuloi krejt me errësirë (2) dhe mendoja se si të shpëtoja.

Duke pritur shpëtim nga e djathta ajo m'u duk si një varr i stërmadh ku preheshin, babai, fisi dhe e tërë raca ime. Në vend që të ngushëllohesha, u trishtova më tepër.

Për të gjetur ngushëllim, shikova në të majtë (të ardhmen). Ajo për mua dhe shokët e mi dhe të gjithë brezat që do të vijnë, m'u duk si një varr i madh i kredhur në errësirë. Nuk m'u duk aspak e dashur, por si një armik i trishtuar.

Kështu rrugëzgjidhjen, nuk e gjeta as në të djathtë dhe as në të majtë, por në të sotmen. Pabesia historike e ditës së sotme, m'u duk sikur ma bëri trupin gjysëm të vdekur, që vuan sikur po jep shpirt dhe m'u paraqit si një arkivol, ku do të vendosej kufoma ime.

Mbasi mbeta i pashpresë e ngrita kokën edhe nga kjo anë që të shoh majën e pemës së moshës time. Pashë se kjo pemë kishte vetëm një frut, kufomën time. Duke u sjellur për nga vetvetja, qëndroja në majën e saj dhe kjo pamje nuk më dha kurrfarë ngushëllimi. Për të parë rrënjën e moshës time, e ula kokën poshtë dhe pashë se dheu i kockave të mia ishte ngatërruar me atë të fillimit të jetës time. Po e shkelja me këmbë dhe nuk gjeja dot asnjë shpresë, përkundrazi m'u shtuan brengat. U detyrova ta kthej kokën prapa. Pashë se kjo botë e pathemeltë dhe e përkohshme po rrokulliset në lumenjtë e asgjëshmërisë dhe në errësirën e zhdukjes. Duke kërkuar ilaçin e brengave të mia, plagët m'u spërkatën me helm. Edhe pse më dha zgjidhje, u drejtova përpara dhe pashë se dera e varrit ishte hapur në drejtimin tim, si një gojë që donte të më përpinte. Pas saj në largësi dukeshin karvanet në një bulevard të gjerë, që vraponin për në përjetësi.

Për të përballuar shqetësimet e këtyre gjashtë anëve, pikëmbështetja dhe arma e mbrojtjes që kisha në duar, ishte vetëm një vullnet i pakët. Për armiq të shumtë dhe veset e dëmshme, kjo armë e njerëzimit që është ky vullnet i pakët, është i mangët, i dobët dhe jo krijues. Nuk ka asnjë mundësi tjetër përveç fitimit të punës së vet. As që mund të kthehet nga e kaluara për të larguar hidhërimet dhe as që mund të kalojë nga e ardhmja për të prerë frikën që vjen nga ajo anë. E pashë se nuk kisha asnjë farë aftësie të saktë ndikimi, që të më plotësojë qëllimet që kisha, apo të më shmangë nga hidhërimet që më shqetësojnë pandërprerë. Në kohën që përpëlitesha për të shpëtuar nga gjendja e tmerrshme e shqetësimeve ku kisha rënë dhe errësirave të pashpresa, në çast më erdhi në ndihmë besimi, që shndriti nga qielli i Kur'anit të Bekuar. Ky besim të gjashtë anët e trishtuara aq shumë m'i shndriti, sa që edhe sikur ato gjendje të trishtuara dhe të errëta të shumëfishoheshin njëqind herë, përsëri për t'u dalë ballë atyre, ajo Dritë do të mjaftonte. Ato momente të trishtuara, një nga një m'u shndërruan në ngushëllime dhe momente miqësore. Kështu besimi shumë qartë na e nxori në shesh dhe na e zhdukua perden e errësirës së të kaluarës, që dukej si një varr i madh dhe e ktheu në një kuvend miqsh të nderuar dhe në një tubim të dashamirëve.

Besimi më bindi shumë qartë se ardhmëria nuk është siç e tregon pamja e shkujdesur në formën e një varri të madh, por një vend i dashur ku do të shkojmë në gosti të ftuar nga ana e Mëshirplotit, në pallatin e lumturisë.

Besimi me dritën e Kur'anit padyshim, më bindi se e sotmja ime nuk është ashtu si më dukej nën shikimin e pakujdesshëm, në formën e arkivolit, por kjo e sotme është si një dyqan, për tregtinë e jetës së përjetshme dhe si një vend i gostitjeve të shkëlqyera nga i Gjithmëshirshmi.

Besimi më parashtrroi shumë qartë se nuk është siç m'u shfaq nga pakujdesia, që kufoma ime varej në majën e pemës së moshës time, ndoshta shpirti im është kandidat i jetës së pafundme, si dhe i nderuar me lumturinë e përjetshme, që duke ndërruar jetë do të më nxjerrë nga strofkulla e vjetër e trupit, për të më shëtitur nëpër yjet e ndritur.

Besimi më bindi shumë mirë se dheu i krijimit tim me kockat e mia, nuk do të shkelet me këmbë si një kockë e zhdukur, ndoshta ai është një perde që mos ta shohim derën e sallonit të parajsës.

Besimi me shumë saktësi më bindi se cila është fytyra e qartë e kësaj bote, e cila nuk është siç e tregon pakujdesia e mëparshme kur thotë se rrokulliset në errësirën e gjithmonshme të asgjësë. Besimi me sekretin e Kur'anit, ma tregoi se rruzulli i tokësor që në pamje duket sikur rrokulliset në errësirë, në të vërtetë ai shpreh kuptimin se e ka sosur detyrën. Rezultatit e tij e ka lënë në disa mesazhe të All-Ilahut xh.sh. dhe në faqet e ndritura të Librit të të Patëmetit.

Besimi me Dritën e Kur'anit më tregoi se varrin që kemi përpara dhe pas asaj që duket si bulevard i karvaneve që shkojnë në zhdukjen e përjetshme, në të vërtetë ai varr nuk është dera e një pusi, por ndoshta është dera e dritës. Bulevardi i karvaneve nuk të çon drejt asgjësë dhe

zhdukjes, por ndoshta tek ekzistenca, në botëra të ndriçuara dhe të lumturisë së përjetshme. Këto mësimë që më garantoj besimi, u bënë si një ilaç i efektshëm për fatkeqësitë e mia.

Besimi për fitimin e punës që e kisha vetëm si një vullnet të pakët, duke mos zotëruar asnjë mjet tjetër përveç një aftësie fare të vogël, për të pasur një garanci në dorë, më duhej që të mbështetesh tek një fuqi e pafundme, për të bërë dobi prej Mëshirës së Pashterrshme, kurse vullneti i aftësisë duke m'u bërë një argument dhe një armë në duart e mia. Edhe për të gjithë njerëzit, ky besim është një argument bazë, meqenëse vullneti ishte me aftësi të kufizuara, të dobët dhe me mungesa. Ashtu si ai ushtari që kur forcën e tij të paktë e harxhon në dobi të shtetit, puna e tij ka një vlerë njëqind herë më të madhe se sa kur punon për veten. Me sekretin e besimit aftësia dhe vullneti që është gjëja më e paktë, kur mbështetesh në Rrugën e All-llahut xh.sh. të Madhëruar, bëhet shkak për të fituar një parajsë të gjerë, që sipërfaqja e gjerësisë së saj është mbi pesëqind vjet.

Besimi frerët e vullnetit i merr nga veset e nefsit, duke i lartësuar atje ku nuk ndikon as e kaluara, as e ardhmja dhe e shmang nga veset epshore, duke e vendosur në duart e zemrës dhe të shpirtit. Koncepti i ndjenjave të zemrës dhe të shpirtit nuk përfshin vetëm të sotmen, por ndoshta, ato veprimtarinë e tyre mund ta shtrijnë në shumë vite, nga e kaluara dhe e ardhmja. Në këtë mënyrë vullneti i paktë shndërrohet në shumicë, gjer tek më i shumti dhe njeriu me forcën e besimit mund të kalojë edhe lumenjtë më të mëdhenj të së kaluarës. Po kështu, ai mund të shpëtojë nga errësira dhe hidhërimi. Pra nën Dritën e Besimit ai, njeriu mund të ngjitet në majat e maleve të larta dhe të shmangë frikën që ndjen.

Prijsi I Rinise - II

Tani o ju vëllezër dhe motra të moshuara që po vuani telashet e pleqërisë kështu si dhe unë! Meqenëse jeni besimtarë, duhet të falenderoni All-llahun xh.sh.. Sepse besimi tek feja Islame, përmban një arkë të madhe të mbushur plot me dritë, me hijeshi dhe bukuri përrallore të patreguara. Pleqëria jonë na afron më tepër pranë kësaj arke të pashterruar. Besimtarët kurrë nuk duhet të ankohen nga pleqëria, por me mijëra herë ta falenderojmë Zotin xh.sh., që na e ka dhënë atë.

.....
(Nga shkëlqimi i njëzete gjashtë)

.....
SHPRESA E TETË

Në një koh kur mu zbarsdhan flokët që ajo ishte edhe shenja e pleqërisë edhe gjuminerinisë ma pati dyfishuar ngatrimet e luftës botroredhe vështirësitë e robërisë dhe më në fundë që arrita në Stamboll Pata fituar famë që nga Halifja, Shejhul Islami dhe kryekomandanti, e deri tek nxënësit e medreseve. Kësaj fame kur t'i shtosh edhe turbullirat e rinisë, më pati hedhur në shtresën e trashë të gjumit të pakujdesisë, sa mendoja se nuk do vdes kurrë. Në këtë kohë ishte muaji i shenjtë i Ramazanit dhe shkova në xhaminë e Bajazitit, me dëshirën që të dëgjoja zërin e sinqertë të hafizave me ajetin

كل نفس ذا نقة الموت

5)

“Secili njeri do të shijojë vdekjen” dhe

me metodën e lartë hyjnore, Kur’ani famëlartë me zërin e singertë të hafizave më la ndikim të thellë në zemrën time, duke ma bërë copa-copa shtresën e trashë të pakujdesisë. Kur dola nga xhamia, me ndikimin e një gjumi të thellë (shpirtëror), që e kisha prej moti, e ndjeva veten sikur jam në një anije në një mjegull e stuhi dhe kështu kam humbur busullën që do të më tregonte rrugën. Dola para pasqyrës dhe pashë flokët e mi të bardhë, që sikur donin të thonin, “kujdes se rinia që shumë e doje dhe kishe besë, po të thotë lamtumirë dhe jeta jote që shumë e do, po të shuhet. Kurse bota ime që kam qenë i dashuruar pas saj, duke më thënë “mirupafshim” po më bënte të ditur se do t’u largoja nga kjo bujtinë. Edhe ajo është bërë gati për të shkuar pa më thënë

كل نفس ذا نقة الموت

lamtumirë. Përsëri me ayetin 5)

po më

terheq vëmendjen se, i gjithë lloji i njerëzve është si një shpirt i vetëm, ku për t’u ringjallur do të vdesin. Edhe rruzulli tokësor është si një shpirt. Për të hyrë në formën e përjetshme, ai do të vdesë. Dhe jeta e përkohshme është si një shpirt, ku për t’u ringjallë në formën e pavdekshme edhe ajo do të vdesë. Kuptimi i ajetit të mëparshëm, vazhdimisht më sugjeronte të shikojë zemrën time.

Në këtë gjendje hapa sytë dhe pashë se periudha e shijeve që ishte rinia, po më shkonte dhe po vinte pleqëria, mosha e fatkeqësive dhe po më ikte jeta e shndritshme, për t’u zëvendësuar me vdekjen, fytyra e të cilës është e tmerrshme.

Dhe bota, e dashura e shumë njerëzve shumë shpejt po perëndon. Në këtë gjendje të tmerrshme të mashtroshe veten dhe ta futësh në gjumin e rremë të pakujdesisë, nuk është zgjuarsia. Ktheva kokën tek jeta shoqërore që kisha një respekt të jashtazakonshëm dhe aty nuk munda të gjeja dobi, sepse i gjithë nderi dhe respekti, lavdia dhe ndihma e tyre është vetëm deri tek dera e varrit, e aty shuhet. Edhe fama që është qëllimi kryesor i shumë njerëzve, nën perden e saj fshihet maska e ftohtë mashtroese e hipokrizisë. Dhe u binda gjithësisht se gjithë ato gjëra që më kanë mashtruar deri tani në jetën time, nuk janë vetëm se një lajkatim që nuk të sjellë qetësi dhe në brendësi nuk mban fare dritë. Prandaj për t’u zgjuar vrapova përsëri për në xhami, që të marr karikimin e duhur, nga mësimi e larta kur’anore, nga goja e hafizave. Në këtë rast mësimi

و بشر الذين امنوا

qiellor më dha këshillë me ayetin 6)

(Përgzoi ata që besuan)

dhe me këtë rast mua më mjaftoi ndikimi i Kur’anit dhe nuk kisha nevojë për ndikim tjetër, kështu me dritën e Kur’anit dola në dritë. Unë në çdo shqetësim dhe vështirësi, mundohesha ta gjeja shërimin në brendësinë e dritës kur’anore. Për këtë e falenderoj shumë All-llahun (xh.sh.), që në brendësi të brengave të mia, arrita ta gjeja shërimin që kërkoja, në dritën hyjnore të Kur’anit. Tani edhe në brendësinë e errësirës, edhe mes gjërave të tmerrshme, e gjej qetësinë e duhur. Së pari i solla sytë tek fytyra e vdekjes që secilin e tremb; dhe me dritën e Kur’anit pashë se megjithëse pëlhura e vdekjes është e zezë e keqe, u binda se nuk është zhdukje, por është zanafilla e jetës së përjetshme, është çlirim nga peshat e rënda të kësaj bote, është një ndërrim banese dhe është një transformim tek miqtë e dashur që kanë ikur më parë. Në këtë mënyrë e pashë fytyrën e vdekjes plot me të vërteta të bukura. Kështu tek ajo duhet të shkojmë jo duke u trembur, por me zell të madh. Kështu e kuptova sekretin e njerëzve të devotshëm, që mundohen të mbajnë kontak me vdekjen. Pastaj e solla mendjen tek kohërat e rinisë, ndarja prej saj bëhet

me vajtim dhe duke menduar për ditët që i kam kaluar në pakujdesi, e pashë fytyrën e rinisë plot me robër që konsiderohen si idhuj të kësaj bote dhe m'u duk e shëmtuar, e dehur dhe sikur të mos ia kisha ditur rëndësinë për disa vjet, do të më kishte bërë pijanec, dhe në vend që të qeshja edhe sikur të kisha jetuar njëqind vjet në këtë botë përsëri mua do të më bënte të qaj. Siç njëri prej tyre që duke qarë kishte thënë

لَيْتَ الشَّبَابَ يَعُودُ يَوْمًا فَأُخْبِرَهُ بِمَا فَعَلَ الْمَشِيبَ

D m th: “Po të kishte mundësi një ditë të kthehet rinia, nga një nga një ia kisha rradhuar gjendjet e vështira që ma solli pleqëria mua.”

Ja pra, si ky personi pleqët që nuk ia dinë kuptimin e rinisë, duke menduar atë po hidhërohen dhe po qajnë.. Ajo është e drejtë ne qoftë se atë rinia e zotron ndonjë besimtarë që është e devotshëm që mendjen dhe zemrën eka në vend dhe jeton duke adhuruar All-llahun dhe rinia e shpenzon në vendet e dobishme të fitimeve ahiret, atëherë rinia për to është një pasuri e fortë për tregtinë e ahiret, dhe për të bërë punët e mira. Pra, rinia për ata që nuk e shpërdorjnë atë dhe jetojnë duke kryer detyrën e fesë është një mirisi e madhe nga All-llahu xh.sh.. Ne qoftë se të riut nuk ibashkohet sjellje, Morali e devotshmeria për to është rrezik, jeta e tij të çferuar ia shkatron jetën e përjetshme, ndoshta ia ndyros edhe këtë jetë. Njëkohësisht, përballë kënaqësinë e tij një – dy vjetë në kohën e rinisë, kur plaket shumë vjetë vuan dhëmbje e vështirësi.

Meqë shume njeriun rinia po dëmton, ne pleqët shumë duhet të falenderojmë Zotin madhëruar që shpëtuam nga rreziqet e dëmet e saj. Si çdo gjë, me siguri edhe shijet e rinisë do të ikin. Po qe se rininë ke sahpenuar në punët e mira dhe adhuroj; ato punët e të riut do ti zvendsoje frutete përjetshme dhe ajo do të bëhet shkak që të fitojë rininë me moshën e pafundme. Mrapa shikova dynjanë që shumica po adhurojnë atë. Me dritën e Kur'anit e pashë se njëri mbrenda tjetrit janë tri dynja:

Njëri: Ka të bëjë me Emrat e All-llahut Esmaul Hyna.

E dyta fytyrë e dynjasë, është ara e ahiret.

E treta: ka të bëjë me adhureset e dynjasë, është vendi ku dëfrohen ato.

Dhe në këtë dynja për secilin është nga një dynja të madhe, mund të thuajmë se në sasinë e njerëzëve njëri mbrenda tjetrit janë dynjtë. Por shtylla e dynjasë së çdo njeriu është jeta e tij. Kur i shkatrohet trupi i tij, bien dynjaja në kokën e tij dhe për to ka krisë qameti. Të pakuldesurit duke mos ditur gjendjen e dynjasë që aq shpejtë ua shkatrohet dynjaja e tyre, vazhdojnë jetën duke menduar si ajo e përgjithëshme, adhurojnë atë. “Unë kur mendova se personalisht edhe dynjaja ime do të prishet e shkatrohet si të tjerëve thashë: çfare dobi mund të ma sjelle ky dynjaja ime personale me këtë moshë të shkurtër.” Me dritën e Kur'anit e pashë se: Si për mua edhe për secilin është një vend tregtie të përkohshme; dhe për mysafirët është një bujtinë që çdo ditë mbushet e shprazet; dhe për të bërë marë dhënie udhëtarët në mesë të rrugës është vendosur një pazarë; dhe është si një fletore që Desenjatori i Pafillimt me gjithëdijen e Tij në të duke përsëritur shkruan e prishë; Dhe stina e pranverës për Të është si një letra e Tij të desenuar; dhe çdo vertë për to është si një vjershë i bukur që Mjeshtëri i Madhëruar, desenjet e Tij në të duke freskuar i pasqyron dhe është një kopështë për të dhënë fidane në jetën e ahiret dhe është

lulishte e mëshirës Hyjnor dhe është një tryezë ku krijohen panoramet për të ekspozuar në jetën e përvetshme. Dhe shumë i falenderova All-llahut Madhëruar nga që e kishte krijuar dynjanë në këtë formë. Dhe e kuptova se: Zoti i Madhëruar njeriut dëshirën që ia ka dhënë që t'i shikojë fytyrat e brendësirëve që pasqyrojnë Emrat Hyjnor, për këtë arsye ata që me pakujdesinë kanë shpërdoruar atë; dhe dynjanë e tyre që kanë shpenzuar nëpër vende boshe, dëmshme dhe pa vlerë, janë përballuar me kritikën e hadithit që thotë:

حب الدنيا رأس كل خطيئة

”Dashamirësia vetëm për këtë jetë është

më i madhi gabim”

Tani o ju pleqët e plakët! Unë me dritën e Kur'anit me vërejtjen e pleqërisë simdhe nga arsye se besimi ma hapi sytë e pashë këtë të vërtetë, dhe në shume vende të Risale-i Nurit kam argumentuar. Unë për vehten tim kam gjetur një ngushëllim dhe një shpresë dhe dritë të fortë. Dhe u gëzova për pleqërinë timën, dhe po thpëm oh shqyr që më iki rinia. Edhe bënë si unë e mos qani por falenderoni. Meqi jeni besimtarë dhe e vërteta është në këtë drejtim; le të qajnë ata që nuk kujdesohen dhe ata që kanë rë në devijim

Në veprat e Risale-i Nurit është sqaruar mjaft mirë, por ne këtu po bëjmë vetëm një shënim: Nga argumentet e shumta të besimit në një Zot xh.sh..

Disa nxënës të gjimnazit të qytetit të Kastamonus, m'u afruan dhe më thanë: "Njoftona Krijuesin tonë! Mësuesit nuk na thonë asnjë fjalë për Të. U thashë: "Të gjitha shkencat që jeni duke studiuar, me një gjuhë të tyre të veçantë, vazhdimisht na njoftojnë All-llahun xh.sh.. Duhet t'i studioni mirë shkencat sepse përmes tyre do t'i zbuloni të vërtetat". Ja disa shembuj:

Shembull 1. Po të vëzhgojmë një barnatore, në çdo shishe, me masa të preçizuara janë vendosur ilaçe të ndryshme. Kjo tregon për një kimist dhe për mjekun e shkathtë. Po kështu edhe në barnatoren e madhe të të gjitha llojeve të bimëve, në "shishe" e natyrës, mbi katërqind mijë lloje "ilacesh" dhe "melhemesh" të gjallesave, janë shpërndarë në të gjithë rruzullin. Ti e kupton se barnatorja e "botës" është shumë herë më e madhe se ajo e qytetit, kështu që kur të merreni me studimin e farmaceutologjisë do të mësoni për kimistin e barnatores më të madhe të kësaj bote, që është All-llahu xh.sh. i Madhërishtëm, i Cili i njoftohet edhe të verbërve.

Shembull 2. Shiko një fabrikë që prodhon me mijëra metra stof, prej një materiali të thjeshtë dhe do të sjellësh ndërmend fabrikantin apo makinistin e mrekullueshëm. Po kështu rruzulli që është pa anë e pa fund, në çdo qoshe ka me qindra dhe mijëra fabrika moderne. Kjo fabrikë hyjnore është e lëvizshme në çdo stinë. Përsosmëria e saj është shumë më e madhe se ajo që kanë shpikur njerëzit. Kur të mësoni shkencën e makinerive, do ta kuptoni më mirë dhe do ta njihni Mjeshttrin dhe Zotin e makinave të panumërta të të gjithë botës (ku çdo qenie është një makinë e mrekullueshme).

Shembull 3. Shiko një njeri që me një mënyrë të përkryer, të gjitha ushqimet i ka mbledhur dhe sistemuar në një depo apo hambar. Kjo do të sjellë ndër mend magazinierin e rregullt dhe pronarin e depos. Po kështu edhe kjo botë, për një vit, vazhdimisht për mijëra vjet, ka mbartur e mban mbi vete qindra mijëra karvane gjallesash, të cilat i ka ushqyer në udhëtimin e tyre të vazhdueshëm. Gjithësecila gjallesë ushqimin e ka të ndryshëm, sipas stinëve që ndërrohen. Pronari i gjithësisë pranverën e ka krijuar si një vagon gjigand të mbushur me lloj-lloj mirësish. Këto mirësi ua sjell të pafatëve në stinën e dimrit, kur iu është mbaruar ushqimi. Pra

kjo botë është një hambar hyjnor dhe një anije e All-llahut xh.sh.. Ajo është një transportuese hyjnore, që mban mbi vete me mijëra dyqane të mbushur me pajisjet e nevojshme, si kuti konservash dhe pako të ndryshme. Shiko sa e madhe është kjo fabrikë hyjnore, që po ta krahasosh me atë që ka ndërtuar njeriu, do ta kuptosh nga shkenca e farmaceutologjisë që po studioni dhe do të shihni se kjo që po ju them, është e saktë dhe këto shkenca, tregojnë për Fuqiplothin dhe Shpenzuesin e këtyre hambarëve. Kur ta njohësh, Ai të shtyn që ta duash.

Shembull 4. Po të kishte një komandant me një ushtri prej katërqind mijë trupash, që secilit t'ia garantonte ushqimin veç e veç, armën veç, teshat veç, stërvitjen veç dhe lirimin në periudha të ndryshme, pa harruar asnjë vogëlsi, tregon se ai është një strateg dhe komandant i zoti. Shiko në "garnizonin" e pranverës së kësaj bote, si janë rreshtuar dhe pajisur "ushtarët", nën urdhërin e Komandantit Hyjnor, ku sipas llojeve të bimëve apo kafshëve, të gjitha kanë veshje të larmishme dhe të ndryshme nga njëra tjetra, ushqim të ndryshëm, armë të veçanta, stërvitje të veçantë dhe kohën e lirim të veçantë. Në çdo pranverë, asnjë hollësi nuk harrohet dhe pa gabuar fare, çdo gjë krijohet me pak dallim nga e para, vetëm me urdhërin e një Komandanti të Madh. Po të studioni me vëmendje të madhe edhe dijet ushtarake, do të mësoni për Strategun e kësaj ushtrie gjigande, Zotin dhe Edukatorin e këtij rruzulli. Kur ta njihni më afër, do të filloni të shqiptoni këto fjalë: "O Zot, Ty të duam mbi çdo gjë tjetër! Këto fenomene të çuditshme vetëm Ti je i Zoti t'i krijosh. Ne duke të bërë "tespih", duke të përmendur vërtetojmë që je i Patëmeta dhe vetëm ty të falenderojmë. Shembull 5. Shiko një qytet të bukur, ku me mijëra llamba elektrike fosforuese dhe të lëvizshme, ndriçojnë me materialin e tyre, që nuk soset. Për krijuesin dhe fabrikuesin e tyre, që ka shpikur këtë dritë të pashterrshme, duartrokasin duke shprehur çudinë dhe mirënjohjen, për këta mjeshtra të elektricitetit. Po kështu në çatinë e kësaj bote, me miliona janë "llambat" e yjeve, që sipas zbulimeve të astronomëve, disa prej tyre janë njëmijë herë më të mëdhenj se bota jonë dhe lëvizin 70 herë më shpejt se gjylja e topit. Duke lëvizur, rregulli i tyre nuk priset, nuk përplasen dhe nuk shuhet. Materiali ndriçues i tyre nuk mbaron. Shkenca e astronomisë që jeni duke studiuar, për këtë do t'iu njohë më mirë me diellin, që qenka krijuar para një milion vjetësh dhe që qenka mbi një milion herë më i madh se kjo botë. Në këtë Bujtinë Hyjnore, ai shërben si një llambë, apo si një stufë, që nuk shuhet kurrë. Është vërejtur se për të siguruar materialin ndriçues të tij vetëm për një ditë, duhet që të gjitha malet e kësaj bote të jenë me qymyr dhe e gjithë bota të jetë plot me benzinë dhe gaz. Fuqia ngrohëse e tij llogaritet e barabartë me fuqinë kaloriferike të të gjithë drunjëve të njëmijë sipërfaqeve të kësaj bote. Pra, pa gaz, pa dru dhe qymyr, ndizet me një energji që nuk shuhet kurrë, në një lëvizje të vazhdueshme dhe pa u ndeshur asgjëkundi. Të gjitha tregojnë për një të Plotfuqishëm të Paarritshëm, një Zot xh.sh. Madhështor. Sa të mëdha dhe të fuqishme janë këto llamba, po t'i krahasojmë me ato të mjeshtrave tanë. Bëjeni këtë krahasim, kur të studioni shkencën e astronomisë dhe do të bindeni se ka një Sundimtar të Gjithësisë, që i sajton të gjithë këto fenomene gjigande.

Shembull 6. Lexo një libër, çdo rresht i të cilit, është i shkruar me laps të hollë, ku në çdo fjalë është pasqyruar një sure e Kur'anit. Atëhere pa dyshim e kupton se këtë mund ta shkruajë vetëm një Autor i Mrekullueshëm. Prandaj kjo vepër duke u vlerësuar nga të gjithë, me shpirt shqiptohen fjalët: Mashaall-llah.... Po kështu duke parë Gjithësinë e madhe, vetëm në një pjesë fare të vogël, siç është sipërfaqja e tokës dhe një formë e saj siç është pranvera, do të vëresh se ajo është krijuar si një libër gjigand me treqind mijë faqe të mbushura me bimë dhe kafshë të mijëra llojeve, të kombinuara kaq bukur me njëra tjetrën dhe pa ngjasuar aspak dhe që të gjitha të krijuara në një mënyrë të përsosur. Tek "fjalët" e një druri, si në një vjershë të bukur, brenda embrionit të një fare, ka futur përmbajtjen e të gjithë librit. A nuk të duket se aty ka punuar një laps i fshehtë dhe a nuk janë të gjitha këto mesazhe shumë domethënëse? Tek secila fjalë e tyre

shfaqet dituria e kulluar. Kuptoje pra se kjo broshurë e gjithësisë, ky Kur'an i materies, është më i madh se në shembullin që treguam më parë. Këtë më mirë do ta kuptoni kur të studioni letërsinë dhe artin e të shkruarit. Me objektivin e dylbive të tyre, do të dalloni Kolosin e Përsosur të këtij Arti dhe Shkrimtarin, gjeni të këtyre "Librave të mrekullueshëm". Ato me thënie "All-llahu Ekber" të njoftojnë Zotin xh.sh., kurse me fjalën "Subhanall-llah" e amshojnë Atë dhe me "Elhamdulil-lah" të shtyjnë ta duash Atë. Të gjitha këto shkenca që treguam më lart dhe qindra të tjera që nuk i përmendëm, po t'i analizosh dhe t'i vështrosh me pasqyrime të veçanta dhe t'i shohësh me objektivin e dylbive, para syve do të shfaqet Krijuesi Madhështor me të gjithë Emrat e Bukur të Tij. Këto të njoftojnë dhe të tregojnë funksionet e përsosura të Tij. Kur'ani Madhështor për të bërë të njohur dhe për të dokumentuar njësimin e All-llahut xh.sh., shumë herë ka theksuar në këto ajete, që do të rreshtojmë:

رب السماواتِ وَ الْأَرْضِ

7)
dhe

خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ

”Zoti i qiejve e i tokës (All-llahu është Ai që) krijoi qiejt e tokën”.

Pra këto ajete na njoftojnë All-llahun, u thashë të rinjëve të shkollës dhe ata më besuan, duke u bindur plotësisht. Duke i verifikuar këto të vërteta që u tregova, ata thanë: "E falenderojmë Zotin se morëm një mësim shumë të vlefshëm dhe të amshuar", pastaj shtuan: "Mëshira e All-llahut qoftë mbi ty!" Unë vazhdova përsëri: "Njeriu është krijuar si një makineri që mban mijëra hidhërime dhe gëzime brenda saj. Shpirtërisht dhe materialisht ajo është e dobët dhe e sulmojnë atë armiqtë e panumërt. Gjithmonë është i varfër dhe i ndjeshëm shpirtërisht, sepse e kanë goditur vazhdimisht dhimbjet e ndarjeve dhe të humbjeve. Në këtë gjendje paaftësie, kur njeriu mbështetet me adhurim tek një Sundues Madhështor, atëhere ai gjen një pikë mbrojtjeje përballë armiqve dhe nevojave të pashterrshme; ashtu siç krenohet me nderin dhe pozitën e zotërisë së vet. Kur njeriu me besim dhe adhurim mbështetet tek Mëshirëploti i Fuqishëm, duke u lidhur shpirtërisht me Të dhe duke përfytyruar çastin e vdekjes si një çlirim, atëhere këtë njeri nuk mund ta mendosh se sa mirënjohës dhe falenderues është". Këtë që u thashë të rinjëve të shkollës, ua përsërita edhe shokëve të mi të burgut: "Atë (Zotin xh.sh.), kush e njeh dhe i përulet edhe po të jetë në kasolle, ndihet fatbardhë. Kush e harron edhe në pallat po të jetojë, do t'i duket si një kasolle e rrënuar dhe do të ndihet fatzi. Një viktimë fatbardhë duke shkuar për ta varur, mizorëve u tha: “Unë nuk po vdes, mbase duke u çliruar nga ju, unë po shkoj në lumturinë e përjetshme. Juve ju shoh si të dënuar me burgje të përjetshëm dhe kjo më duket se është shpagimi im kundër jush; pra hakun po e marr." Duke vazhduar me gëzim tha: “Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut”, dhe me qetësi të zemrës dha shpirt.

8) سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا إِنَّكَ أَنْتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ

"Ti je i Patëmeta, ne nuk kemi dije tjetër përveç asaj që na mësove Ti. Vërtetë Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti”.

NJË PJESE E RËNDËSISHME
DHE
SHTOJCA E FJALËS SË DHJETË

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ فَسُبْحَانَ اللَّهِ حِينَ تُمْسُونَ
وَحِينَ تُمْبُحُونَ وَلَهُ الْحَمْدُ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَعَشِيًّا
وَحِينَ تُظْهِرُونَ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ وَيُخْرِجُ الْمَيِّتَ
مِنَ الْحَيِّ وَيُخَيِّى الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا وَكَذَلِكَ تُخْرَجُونَ
وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَكُمْ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ إِذَا أَنْتُمْ بَشَرٌ
تَنْتَشِرُونَ وَ مِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا
لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَ جَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَ رَحْمَةً إِنَّ
فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ وَ مِنْ آيَاتِهِ خَلَقَ
السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَ اخْتَلَفُ السِّنِّتُكُمْ وَ أَلْوَانُكُمْ
إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِلْعَالَمِينَ وَ مِنْ آيَاتِهِ مَنَامُكُمْ
بَالَيْلٍ وَ النَّهَارِ وَ ابْتِغَاؤُكُمْ مِنْ فَضْلِهِ إِنَّ فِي ذَلِكَ
لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَسْمَعُونَ وَ مِنْ آيَاتِهِ يُرِيكُمْ الْبَرْقَ
خَوْفًا وَ طَمَعًا وَ يُنْزِلُ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَيُخْجِى بِهِ
الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَعْقِلُونَ
وَ مِنْ آيَاتِهِ أَنْ تَقُومَ السَّمَاءُ وَ الْأَرْضُ بِأَمْرِهِ ثُمَّ
إِذَا دَعَاكُمْ دَعْوَةً مِنَ الْأَرْضِ إِذَا أَنْتُمْ تَخْرُجُونَ وَ
لَهُ مَنْ فِي السَّمَوَاتِ وَ الْأَرْضِ كُلُّ لَّهُ قَائِمُونَ وَ
هُوَ الَّذِى يَبْدُؤُ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ وَ هُوَ أَهْوَنُ عَلَيْهِ
وَلَهُ الْمَثَلُ الْأَعْلَى فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَ هُوَ الْعَزِيزُ
الْحَكِيمُ

9)

“ Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.

Atëherë All-llahun lartësoni kur të vijë mbrëmja dhe kur të agojë mëngjesi. Falenderimi i takon vetëm Atij edhe në mbrëmje edhe ditën prej gjithçka ka në qiej e në tokë. Ai krijon të gjallin prej të vdekurit dhe të vdekurin prej të gjallit. Ai e ngjall tokën pas vdekjes së saj, e po ashtu edhe ju do të nxirreni (të gjallë prej varrezave). Nga faktet (e fuqisë) së Tij është edhe ajo, se Ai ju krijoi prej dheu, e mandej ju (u zhvilluat në) njerëz që veproni të shpërndarë. Dhe nga faktet e madhërisë së Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj (gratë) ashtu që të gjeni

prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë. Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëzit. Nga argumentet e Tij është edhe gjumi juaj natën dhe ditën, edhe përpjekja juaj për të fituar nga të mirat e Tij. Në këtë ka argument për popullin që dëgjon. Nga argumentet e Tij është edhe ajo që ua dëfton vetëtimën edhe si frikë edhe si shpresë, dhe nga qielli lëshon shi e me të e ngjallë tokën pas vdekjes së saj. Në këtë ka argumente për një popull që di të mendojë. Nga argumentet e Tij është që me fuqinë e Tij bëri të qëndrojë (pa shtyllë) qiellin e tokën, mandej kur t’iu thirret me një të thirrme prej tokës, ju menjëherë dilni. E tij është ç’ka në qiej e në tokë dhe të gjithë vetëm Atij i përulen. Dhe Ai është që e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo (përsëritja) është edhe më e lartë për Të (sipas mendimit tuaj). Shëmbëlltyra me e lartë është vetëm e Tij, në qiej edhe në tokë dhe Ai është Mbizotëruesi, i Urti.”

Dokumentin dhe kulmin e Besimit për Ringjalljen, e tregon ky argument qiellor, që është si një busull e pagabueshme: Me ndihmën e pallogaritshme të Zotit xh.sh., Saidi i Moçëm, para shumë vitesh në parathënien e pjesës “Muhakemat”, ka komentuar nga komenti i këtyre dy ajeteve problemin e Ringjalljes dhe ka thënë:

نَحْنُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

1) “Ne (themi) me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit”; dhe ka ndaluar, nuk ka mundur të vazhdojë më. Falenderojmë All-llahun xh.sh. sa numri i shënimeve të Ringjalljes, se pas tridhjetë viteve, ma frymëzoi këtë argument. Prej dy ajeteve, të parin Zoti xh.sh. ma frymëzoi para nëntë vitesh. Po i paraqesim të plota si më poshtë:

فَانْظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَةِ اللَّهِ كَيْفَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا
إِنَّ لَكَ لَمَحْيَى الْمَوْتَىٰ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

11)

pra, gjurmët e mëshirës së

All-llahut se si e ngjallë tokën pas vdekjes së saj, e s’ka dyshim se Ai është që do t’i ngjallë të vdekurit, pse Ai për çdo send është i Plotfuqishëm”.

Këto ajete janë dy argumente të forta dhe të komentuara mirë. Ky mesazh i Zotit është komentuar në “Fjalën e dhjetë” dhe në “Fjalën e njëzetënëntë”, fjalë që m’i dhuroi All-llahu i Madhërishtëm. Me këtë argument i bëra të heshtin mosbesimtarët dhe mohuesit e Ringjalljes, duke i frenuar. Pas nëntë apo dhjetë vjetësh, këto kështjella të pashkatërrueshme u ngritën edhe më lart; pra komenti i ajetit të përmendur në këtë broshurë.

Tani duke dhënë shenjat e ajeteve të përmendura: “Drita e Nëntë” përmban “nëntë pozita” të larta dhe një parathënie.

Parathënie

Prej dobive të shumta që kemi nga besimi mbi Ringjalljen dhe nga përfundimet e gjallesave në jetën e tyre kolektive dhe individuale, një përfundim të gjerë po e parashtrojmë shkurtimisht. Se sa është i dobishëm dhe i nevojshëm ky besim, po e shpjegojmë sipas argumenteve të besimit të Ringjalljes. Po japim vetëm një argument të gjerë, shkurtimisht, për të parë se sa i qartë është besimi në Ringjalljen. Këtë po e sqarojmë në këto dy pika si më poshtë:

Pika e parë

Nga të gjithë shembujt mbi besimin e Ringjalljes, vetëm njëri lidhet me familjen dhe jetën brenda saj. Nga të gjitha pikëpamjet, vetëm këto katër shembuj tregojnë edhe më qartë se e vërteta mbi Ringjalljen është një nevojë shpirtërore e njerëzimit.

Nga raca njerëzore, gjysmën e përqindjes e zënë fëmijët me shtat të dobët dhe delikatë. Nga mundimet dhe gjendja e trishtuar e jetës, si dhe nga hidhërimet për vdekjen, ato e gjejnë shpresën e tyre vetëm tek xhenneti. Ky është i vetmi ngushëllim i tyre.

Argumenti i parë: Një fëmijë mund të mendojë kështu: “Vëllai im ka vdekur. Ai tani është shndërruar në ndonjë shpend atje në xhennet. Ndoshta atje jeton më mirë se në këtë botë”.

Gjithmonë në vetvete duke pasur një luftë shpirtërore se si do të jetë jeta pas vdekjes, ata i zë një stres i madh. Si pleqtë edhe fëmijët, e

shkatërrojnë shëndetin e tyre nga kjo brengë e përditshme. Zemra e tyre kullon hidhërimi me këtë brengë, do të vdesin apo do të çmenden!

Argumenti i dytë: Gati gjysma e popullsisë, janë të moshuarit. Ata çdo ditë e më tepër shkojnë drejt fundit të tyre. Ata mund të ngushëllohen vetëm duke i besuar jetës së mbrapme. Duke menduar për fundin e tyre dhe duke kujtuar me nostalgji për çfarë kanë pasur më të shtrenjtë në këtë botë, ata presin fundin e jetës, për ta mbyllur derën e saj.

Duke vuajtur për ndarjen e vdekjes, shpirti i tyre qan si fëmijë.

Ata vetëm duke i besuar jetës së përjetshme, mund të gjejnë ngushëllim. Po të mos ishte ky besim, nënat dhe baballarët tanë të ndershëm, do të pëlcnin nga marazi dhe zemra e tyre do të pikonte gjak prej hidhërimit. Kjo jetë do t’u dukej si një burg dhe torturuese.

Argumenti i tretë: Krenaria e njerëzimit është rinia. Kjo është mosha më kritike dhe më delikate.

Temperamenti i të rinjve, i ndezur dhe i mbarsur me dëshira, i bën ata të papërmbajtur. Mosha më delikate i çon drejt aventurave seksuale dhe logjika nuk iu bindet mendjeve të tyre. Kështu ata bëhen të papërmbajtur. Për të frenuar epshtet dhe aventurat e tyre, shërben frika e xhehennemit. Fjala e urtë thotë që sundimin të cilin e ka në dorë shumica (shumica e racës përbëhet nga të rinjtë që rendin pas veseve dhe janë të dehur nga euforia), e bën jetën e njerëzve të pafuqishëm, të rëndë dhe të mërzitshme, si në një ferr. Atëhere stadi i zhvillimit njerëzor shkon drejt shtazërisë.

Argumenti i katërt: Qendra e shoqërisë në jetën e përditshme, përbëhet nga familja (jeta familjare). Kjo është boshti i zemrekut të shoqërisë, e cila është kështjellë ku mbrohet morali i të gjithë njerëzve. Çdo familje është një mikrobotë dhe jeta familjare një xhennet i vogël. Lumturia e çdo familje është nderi dhe sakrifica e përbashkët. Njerëzit e shtëpisë, njëri me tjetrin, biri me babanë dhe motra me vëllain, duke besuar tek shoqëria e përjetshme dhe duke u bashkuar e respektuar fort njëri me tjetrin, këtë jetë të lumtur atyre ia bën të palëkundur vetëm besimi tek bota e përtejme.

Përshembull: Po qe se burri mendon se gruaja e tij dhe ai do të rijetojnë në botën e mbrapme, ata përsëri atje do të jenë burrë e grua. Natyrisht tani ajo është plakë dhe jo e fortë dhe e bukur, por atje do ta rrethojë një bukuri e përjetshme. Kjo arrihet me besim, sakrificë dhe mëshirë të madhe. Kush ka shpirtin e sakrificës ka edhe mëshirën. Me këtë ide në kokë, gruan plakë, e sheh si huri (grua xhenneti) dhe e mëshiron duke e shpërblyer. Po të mos gjykohej kështu, atëhere pas dy apo tre orë të bashkimit, me mendimin e një ndarje të shpejtë dhe të përjetshme, do të ndërtohej një familje e pathemeltë. Shoqëria dhe dashuria e këtij çifti, do të bëhej si tek kafshët, e thjeshtë dhe artificiale. Nderi i familjes do të dobësohej dhe kënaqësitë e çastit do të përdoreshin për të shpëtuar nga detyrimet e përkohshme. Pra nderin e një familje, mund ta drejtojnë nga ferri apo xhenneti, veset epshore apo mëshira islame. Me mëshirën islame, një familje garanton Jetën e Mbrapme megjithë këtë. Sikurse nevoja për ushqime edhe uria e stomakut tregon se ato

ekzistojnë (ushqimet), ashtu edhe ekzistenca e Ringjalljes është e nevojshme, sepse secili nga ne, ka dëshirën e mosvdekjes në shpirt. Po qe se njeriut i hiqet ky besim, atëhere tek ai zhduken të gjitha ato vlera fisnike, duke u shndërruar në një kërmë.

Pika e dytë

Do të parashtrojmë një argument, i cili është më i miri i të gjitha argumenteve të mëparshëm, mbi të vërtetën e Ringjalljes. Nga të gjitha themelet e besimit, ky është më i madhi argument. Tërësisht ekzistencën e Ringjalljes e bën bindëse profetësia e Muhammedit (a.s.). Ai erdhi me të gjitha shenjat e Profetësisë dhe realitetet bindëse të Tij, që na e vërtetojnë këtë të vërtetë. Idea e njeriut të ndershëm, të njësuar nga vetë Zoti, të çon drejt vërtetësisë së Ringjalljes.

Fjala: “Dhe profetëve të Zotit xh.sh.”; ka vërtetuar dhe i dëshmon të gjithë Profetët dhe thëniet e tyre.

Duke thënë:

“Besoni në Librat e zbritura nga Zoti xh. sh.”; në këtë fjalë dëshmohet ky fenomen dhe e vërteta e Ringjalljes.

Zbritja e Kur’anit famëlartë, ekziston si gjëja më thelbësore e besimit islam dhe pastaj sqarimet e profetëve me fjalët e tyre, vërtetojnë krejtësisht të vërtetën mbi Ringjalljen. Kjo e vërtetë sqarohet edhe nëpërmjet shumë ajeteve të tjera të Kur’anit famëlartë, ku lajmërohen njerëzit për Ringjalljen.

12)

“Kur Dielli të mbështillet (dhe errësohet), o ju njerëz ruanu dënimit nga Zoti juaj, sepse dridhja e katastrofës së kijametit është një llahtari e madhe. Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme, kur të çahet qielli, kur të pëlcasë qielli, përse ata i bëjnë pyetje njëri-tjetrit? A të erdhi ty lajmi për belanë që kaplon (kijametin)?

Përshembull:

Në krye të dyzet sureve (kapitujve), me një imtësi të veçantë, duket si një nga problemet më të mëdha Ringjallja. Në ajetet e tjera, kjo ide përforcohet edhe më shumë, duke u pajisur me një shtyllë të fortë.

A s’është Kur’ani ai që u ka dhënë dritë dhe shpjegim shumë hipotezave të shkencës apo diturive të tjera? A nuk të bindin të gjithë këta shembuj dhe këto dëshmi mbi të vërtetën e Ringjalljes? Në qoftë se ti pas të gjitha këtyre dëshmive të qarta si drita e diellit, nuk ke besim tek Ringjallja dhe e mohon këtë, ke mohuar jo vetëm diellin por edhe gjithësinë! A nuk është e vërtetë që ushtria për të mos zhgënjyer Mbretin, lëviz e tëra dhe sulet në luftë? Po mijëra premtime dhe lajmërimet që janë mesazhe të Atij Zotit të Madhërishëm, a ka mundësi të jenë të shpikura nga një imagjinatë e sëmurë? Kush më mirë se feja Islame i edukon veset e këqija; nefset, brengat e zemrës, mendjet e shqetësuara, këtu e trembëdhjetë shekuj më parë? Ai, Zoti i Madhërishëm, plot me zbukurime dhe në mënyrë të shkëlqyer, ku ndihet drejtësia, ndershmëria dhe mëshira e pafund, do të mjaftonte të merrnim në konsideratë vetëm shfaqjen e Profetit.

Vallë a nuk mjaftojnë argumentet e një mbreti shpirtëror, i cili që trembëdhjetë shekuj i ka edukuar shpirtërat, mendjet, zemrat dhe nefset e njerëzve të panumërt? Jo të gjithë këto, por vetëm një shenjë duhet të jetë e mjaftueshme për të pranuar besimin në Ringjallje. Përpos këtyre, me mijëra janë paralajmërimet e matura dhe argumentet bindëse për këtë të vërtetë.

Si ka mundësi që pas të gjitha këtyre tregimeve, të vërtetën mbi Ringjalljen të mos e pranosh? Këtë mëkat vetëm njeriu i mefshët e bën dhe rruga për të është e hapur drejtë xhehennemit. Që në kohë të stërlashta, librat dhe fletushkat qiellore, shkurtimisht e kanë vërtetuar Ringjalljen.

Akt-marrëveshjen me Kur'anin, lidhur me çështjen e Ringjalljes, e nënshkruajnë dhe e vulosin ajetet e Tij. Në mijëra ajete të Tij, kjo e vërtetë është përsëritur dhe shpjeguar prej kohësh, me të gjitha përpjekjet e ndryshme për të vërtetën dhe besimin tek Ringjallja.

Lidhur me këtë qëllim, në fundin e librit të lutjes:

besimi në jetën pas vdekjes dëshmohet, për themelin e besimit të ditës së mbrapme dhe themele të tjera të tij. E veçanta e tyre është zbritja e Librave me anën e Profetëve, e cila është shkruar në formë lutjeje. Po në këtë formë është edhe një detaj, që qartëson Ringjalljen. Ai largon çdo vegim nga truri i atij që kupton ndryshe.

Ja se si thuhet atje:

O Zot Mëshirëplotë! Me shpjegimet e të Dërguarit Paqedashës e Fisnik dhe me mësimet e Kuranit Famëlartë, e kuptova se Kur'ani si dhe të gjithë librat e shenjtë, përshkohen nga shkëlqimi i Emrave të Bukur dhe ngadhnjimitarë. Këtyre emrave që shkëlqejnë gjithësinë, ne u besojmë plotësisht. Ato e shndrisin këtë jetë së bashku me jetën e amshuar. Shkëlqimi në jetën tjetër, do të vashdojë në një formë më të bukur. Ne përfitojmë nga bamirësitë e Tua në këtë botë të përkohshme, pastaj inshall-llah edhe në atë tjetrën.

Po qe se në këtë jetë të përkohshme dobitë e Tua na shërbyen në jetën tonë, bamirësitë e botës së përjetshme do të jenë edhe më të mëdha. Prej tyre ne do të përfitojmë më tepër.

Me argumentet e mrekullive, profetët kanë thënë se në jetën e amshuar, Zoti do të na kënaqë. Këtë thënie si dhe shenjat e tjera, ata i vërtetojnë duke u bazuar në mrekullitë e dukshme, si dhe në dokumente të sakta, siç janë i Dërguari Fisnik dhe Kur'ani Famëlartë, librat dhe fletushkat e zbritura, si dhe zotëruesit e shpirtërave të ndritur, që janë profetët dhe njerëzit e shenjtë. Ata vërtetojnë forcërisht se për të mirët është Xhenneti dhe për të këqinjët, Xhehennemi. Po të njëjtën gjë e vërtetojnë edhe mendjet e ndritura dhe brilante, kur tregojnë dhe lajmërojnë se All-llahu xh.sh. u ka premtuar besimtarëve kënaqësinë e jetës së pafundme.

Mëshira, Fuqia, Ndihma, Dituria, Madhështia dhe Bukuria janë Emrat e Zotit xh.sh. lajmëtarë të Botës së Përtejme. Edhe ne i besojmë asaj dite. O Zot duke na falur gabimet, mëshirona në atë ditë.

Njerëzit e shenjtë (evlijatë), duke u mbështetur tek shenjat dhe hulumtimet e tyre, duke parë gjurmët e jetës së vërtetë të botës metafizike, shumë qartë dhe bindshëm vërtetojnë se: Për udhëtarët e rrugës së gabuar është një xhehennem dhe për ata të rrugës së Kur'anit një xhennet. Këtë e dëshmojmë dhe e besojmë!

O Ti i Plotëfuqishëm i Ndritur! O Ti Mëshirues i Gjithëmëshirshëm! O Ti që premtimet i përmbush, O Zot i Madhëstisë së Lartë, ne i besojmë të gjitha virtytet dhe premtimet e Tua! Kush nuk i beson ato dhe premtimet e Tua, përveç mosbesimtarëve dhe mendjelehtëve? Ata shqetësojnë Nderin dhe Hyjninë Tënde të Madhërishme, Edukimin dhe Mëshirën Tënde! Të gjithë dashamirët e Tu, tregojnë se Ti je Një i shtrenjtë për ta dhe të përulën plotësisht, ne besojmë se do t'i pranosh lutjet tona, për jetën e mëvonshme. Ti i dëgjon me dashamirësi dhe i pranon. Ne e pranojmë se shpifjet e të pabesëve nuk e përlyejnë dot Lartësinë Tënde. Ti je lart dhe larg veprave të fëlliqura, prandaj ne do të mbrojmë dhe do të nderojmë, duke qenë të bindur në Drejtësinë, Mëshirën, Bukurinë Hirëplote dhe Lartësinë Tënde. Është në nderin tonë të bindim cilindo që dyshon për Pastërtinë Tënde Brilante.

Ne besojmë se, të gjithë ata qindra mijëra (XV) të dërguarit e tjerë, janë misionarët e Tu. Profetët dhe njerëzit e përkushtuar, flasin për Hambarët dhe Mirësitë e Tua. Ata në shkallën e një saktësie absolute, kanë thënë se pas vdekjes kur të ringjallemi, All-llahu xh.sh. do t'i servirë mirësitë në mënyrë shembullore Këtë e paralajmërojnë njerëzit e posaçëm. Ne besojmë se kjo është e vërtetë

dhe e drejtë, duke pranuar që ata, njerëzit e shenjtë, na lajmërojnë të bazuar në pasqyrimin e Emrit Hakk, i Drejti dhe besimin tek e vërteta e Ringjalljes.

O Zot, për nder të atyre që na kanë dhënë mësim dhe na kanë ushtruar neve dhe nxënësit e Risale-i Nurit, sillna besimin e plotë dhe bukurinë e përfundimit të kësaj jete, gjithashtu Perjgamberin (a.s.) dhe mësuesin silli që të bëhen përmbi ne, duke mbetur ndimësat e Tu të zellshëm! Amin!

Kur'ani Famëlartë dhe të gjitha librat e shenjtë, duke deklaruar mrekullitë e profetëve, sidomos të Hz. Muhammedit (a.s.), veçanërisht përshkohen nga ideja unike e ekzistencës së Jetës së Përjetshme. Po kështu edhe shenjat dhe argumentet e tjera, vërtetojnë ekzistencën e Zotit si dhe Njësimin e Tij si i Përveçëm. Po kështu edhe vetë Hyjnia e Edukatorit e dëshmon ekzistencën e Jetës së Kënaqësisë së Përjetshme.

Në tregimin e mëposhtëm, do të tregojmë dhe vërtetojmë se prania e Emrave të Bukur, si dhe edukimi i Emrave Hyjnor: Rrahim, Inajet, Hikmet, Adalet etj, për jetën e sotme dhe të mbrapme, janë të nevojshëm sepse ato dëshmojnë vendin e shpërblimit apo të dënimit.

Përfundimisht, po qe se ekziston një Zot i Pafillim dhe i Pambarim, patjetër që Ai duhet të ketë edhe një Mbretëri në jetën e Përherhme. Në gjithësi dhe tek të gjitha qeniet, ekziston një Edukim Absolut, që duket qartë. Po qe se Edukimin e Tij do ta pranojmë që të mos poshtërohemi, Diturinë e Tij për të mos qenë të mefshët dhe Mëshirën për t'i shpëtuar krimit, patjetër që do të gjendet një vend për ne, në Përjetësinë e Lumtur.

Duke parë bamirësitë, dhuratat, bujarinë, ndihmën dhe mëshirën e qartë, mendjet e shëndosha dhe zemrat që rënkojnë akoma, e kuptojnë se pas perdes së tyre ndodhet një Zot i Gjithëmëshirshëm.

Me këtë besim e shpëton bamirësinë nga ironi-talljet, dhuratën nga mashtrimi, ndihmën nga armiqësia, mëshirën nga tortura, bujarinë nga tradhëtia dhe gjithashtu e shpëton shpirtin nga tortura që të shkosh në jetën e lumturisë.

Në stinën e pranverës, në faqen e ngushtë të tokës, mijëra libra të koklavitur janë shkruar me lapsin e një fuqie të madhe. Po me këtë fuqi ata ndahen dhe rreshtohen përbri njëri tjetrit. Ne e shohim këtë me sytë tanë, sa herë që ndërrohen stinët. All-llahu ka premtuar po me këtë lapës që ka vizatuar këto bukuri, të cilat janë vetëm një pjesë e vogël e asaj që do të shihni në botën tjetër. Ai do të pikturojë një vend më të bukur, me tërë shkëlqimet, më të gjerë e më të rregullt. Do të shkruajë një Libër të Pavdekshëm, Librin e Madh të Tubimit të Ringjalljes dhe shenjtërinë e atyre që do të lexoni. Aty në atë Tubim, regjistri i madh i veprimeve të njerëzve, do të lexohet dhe do të sqarohet.

Kjo botë është shtëpia, fillimi i jetës, fabrika dhe panorama e zotëruesve të shpirttrave. Në të jetojnë të gjitha qeniet e gjalla, të mijëra llojeve. Kjo nuk është e qëndrueshme dhe vazhdimisht shndërrohet. Megjithatë kjo botë është zemra e të gjithëve dhe këtu bëhet qëndrimi dhe përfundimi; bashkekzistenca e gjithësisë. Kjo është edhe arsyeja që kjo botë është shumë më e rëndësishme, nga të gjithë planetet madhështorë. Megjithatë në Mesazhet e Zotit, kjo është quajtur e barabartë me ta. Për këtë arsye, kjo tokë ka një rëndësi të veçantë, sepse në të jetojnë qeniet e gjalla të vetëdijshme, si provë konkrete dhe të gjitha sendet e krijuara nga Dora e Padukshme e Zotit. Kështu ne gjithmonë, lexojmë në Librin e Shenjtë: ajetin

رَبِّ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ

7)

“Zoti i qiejve e i tokës”.

Qiejt dhe Tokën All-llahu i quan të barabartë.

Në këtë gjendje siç është kjo botë sot, i përshtatet njeriut, që me lejen e Zotit të punojë dhe jetojë, të lindë dhe të vdesë, të qeshë dhe të qajë, sipas një rregulli të matur me kalibrin preçiz, në mënyrë “gjeometrike” nga Mjeshtëria e Zotit. Një program është përpiluar në mënyrë të veçantë, ku pasqyrohen veset e shoqërisë, dëshirat dhe çudirat e jetës njerëzore, sepse ky njeri është krijesa më e logjikshme nga të gjitha qeniet.

Pikërisht ky njeri sjell për nga vetja, çdo veprim të logjikshëm. Shpall dhe reklamon besimin dhe përfundimin. Ai është Kalifi i kësaj bote dhe shpall e propagandon lëvdatat bashkë me besimin ndaj Zotit, Krijuesit të tij. Këtë qëndrim të tij, ai e pasqyron edhe në shkencën dhe artet e tij, sepse nëpërmjet tyre, ai ka skalitur edhe Bukuritë e Mjeshtrit të vet, duke i shpallur ato. Për këtë arsye, dënimi për mëkatet është lënë për më vonë dhe për shërbimin e fundit ka një afat të përcaktuar.

Bijtë e Ademit, në këtë gjendje janë, ashtu siç thamë më lart. Ky është edhe shkak i dobësisë, varfërisë dhe hidhërimit të tyre. Kjo botë e begatë, me miniera dhe bujqësi të zhvilluar është krijuar e tillë për dobinë e tyre. Zoti e ka krijuar këtë për të jetuar njeriu jetën e kësaj bote, ndaj ajo i ngjan një hambari të mbushur plot e përplot, me të gjitha mirësitë. Kjo tregon kujdesin e Tij të Madh dhe Dashurinë e Pakufishme që ka për krijesën e Vet më të preferuar, njeriun. Duke e dashur kaq shumë njeriun, All-llahu i Gjithëmëshirshëm, i ka plotësuar të gjitha dëshirat e Tij. Ai për të ka krijuar botën e pavdekshme dhe vendin e përjetshëm. Këtë Ai e ka bërë me një Drejtësi të Kulluar dhe Dituri Universale. Sundimi i Gjithëpushtetshëm dhe Mbretëria e Tij, nuk i plotëson dëshirat e njerëzve vetëm në këtë jetë të përkohshme. Ai nuk torturon as nuk tradhëton, nuk hedh baltë mbi drejtësinë, që kështu të mohojë bukuritë, rregullat dhe mirësitë që ka. Njeriu me mosbesimin ndaj Krijuesit, e ka fyer Mirëbërësin e vet.

Domethënë: Nga kjo botë të gjitha tipet dhe karakteret e njerëzve, si katili, ziliqari, zemërligu, i poshtëri dhe i shtypuri pa marrë hakun nga njëri tjetri, po largohen dhe të duket sikur në përfundim të tyre, vdekja e gjithësecilit është e njëllotë dhe nga kjo botë i shtypuri nga mizori shkon pa

marrur të drejtën e vet. E kupton edhe vetë se Drejtësia e Zotit xh.sh. të Madhërisë, nuk e lejon këtë gjë. Në botën tjetër me siguri Ai do të hapë një Gjykim të Madh, ku secili do të marrë atë që meriton, ferrin apo parajsën.

Zoti i gjithësisë, nga të gjitha krijesat e Veta, ka parapëlqyer njeriun. Atij i ka kushtuar shumë rëndësi dhe i ka ofruar pozita të larta. Në këtë stad të tij, njeriu duke besuar në dashamirësinë dhe edukimin e Zotit, i përulet dhe e nderon Atë, prandaj dhe e meriton pëlqimin e Tij. Duke vepruar në këtë mënyrë, ai, njeriu ka zënë vendin që meriton.

Profetët dhe njerëzit e shenjtë, janë më të devotshmit e Zotit dhe Ai i ka shpërblyer ata, duke iu dhënë shenjtërinë (kurse kundërshtarët e tyre i ka dënuar gjithmonë).

Imami dhe Lavdia e të gjithëve, është Muhammedi Alejhissalatu uesselam, që është zgjedhur midis njerëzve të shenjtë, si më i preferuari. Më shumë se gjysmën e botës, për shekuj me radhë, Ai e ka ndriçuar me Dritën e fesë islame. Një të pestën e njerëzimit me “Nurin” e Tij e ka ndriçuar. Njëlloj sikur kjo botë të ishte krijuar për Muhammedin (a.s.), qëllimet e Zotit nga feja dhe Kur’ani i Tij, janë shpallur me shërbimet e tij të vlefshme. Ai e ka merituar plotësisht të shpërblehet me miliona vjet, apo mbase pafundësisht edhe pse ka jetuar vetëm gjashtëdhjetetë vjet. Jeta e Tij ka qenë e mbushur plot me vuajtje, luftëra dhe hidhërime. Me këto merita, a mund të gjejë tjerër njeri një argument, që të provojë se Ai, Muhammedi (a.s.) nuk e meriton Pavdekësinë? Të njëjtin shans të mos e kenë edhe shokët e dashamirët e tij? Ai rron shpirtërisht tek secili. Duke ndërruar jetë, nuk do të thotë se Ai mbaroi përfundimisht. Kjo nuk pranohet kurrën e kurrës! Të gjithë njerëzit kërkojnë nga Zoti, që dashamirët dhe të dashurit e tyre të

ringjallen. Kjo është vërtetuar edhe në “Rrezen e shtatë”, tek “Argumenti i Madh”, i përbërë nga tridhjetë argumente gjithsej.

Secili argument është sa një mal i lartë. Në këtë libër kam theksuar se gjithësia ka dalur nga një dorë dhe është pronë e saj. Ajo është një përsosuri Hyjnore. Në të gjitha argumentet, vërtetohet Njësimi i Zotit. Vetëm Zoti është Ai që mund të krijojë të gjitha gjallesat e kësaj bote. Secila nga këto gjallesa është një shërbyes, dëgjues dhe ushtar i bindur. Me realizimin e Ringjalljes kjo krijesë siguron jetën e pafundme, shpëton drejtësinë e vërtetë nga abuzimi i padrejtësisë, si dhe Diturinë e All-llahut xh.sh. nga rëndomësia dhe thjeshtësia. Çdo krijesë e ka për detyrë që Mëshirën e Tij të Gjerë, ta ndajë nga mizoria dhe nderin e pastër nga zhvlerësimi.

Nga të gjitha shenjat dhe pikat e besimit ndaj Zotit, shihet e njëjta gjë, se Kijameti do të vijë dhe Tubimi i Ringjalljes do të mbahet. Vendi i shpërblimit apo dënimit do të përcaktohet. Atje do të dalin sheshit përkushtimet e përmendura ndaj botës, rëndësia e njeriut dhe dinjiteti i tij.

Krijuesi dhe Edukatori i njerëzimit, me anë të njeriut dhe funksioneve të tij të përmendura, ka pasqyruar Dituri, Mëshirë dhe Mbretërim. Kur të dalin në pah këto vlera të njeriut, do të rritet edhe vlera dhe rëndësia e botës qëndrore e saj do të stabilizohet. Qëllimi i krijimit të shpëton nga diskriminimi i përhershëm. Zoti i Madh për të gëzuar dashamirët me pavdekësinë, ka dërguar më të Besuarin e të besuarve, Hz. Muhammedin (a.s.), që ta shohin këtë dhuratë. Veç kësaj nëpërmjet Tij, ata të vërtetojnë përsosmërinë pa të meta, të Mbretit të Pafillimtë. Të shpalosë para besimtarëve Fuqinë dhe Diturinë, që ata të dallojnë qartë dhe saktë, fuqinë nga dobësia, diturinë nga injoranca dhe drejtësinë nga padrejtësia, që t’i pastrojë dhe t’i përsosë më tej.

Shkurt: Pasi që ekziston All-llahu xh.sh., ekziston edhe vepra e Tij, jeta e amshuar (Ahireti). Më lart kemi shkruar se “Tre themelet” e Besimit Islam, me argumentet e qarta, vërtetojnë ekzistencën e Ringjalljes. Njëri nga themelet e vërteton këtë të vërtetë në një formë më të bazuar

“Dhe melekëve të Zotit dhe caktimit të Tij dhe dobia e dëmi që vjen prej All-llahut të Madhëruar”.

Ekzistenca e melekëve (engjëjve) dhe adhurimi i tyre, vërtetohet nga të gjitha tregimet, thëniet nëpër biseda të ndryshme të profetëve dhe evlijave të devotshëm. Shfaqja e tyre dhe ekzistenca e vendqëndrimit të shpirtërave, si dhe Alemi Gajb (bota e të fshehtave), vërtetojnë dhe argumentojnë jetën e Gjithëhershme, ditën e amshimit të bukur, vendin e lumturisë, Xhennetin dhe Xhehennemin. Melekët me lejen e Zotit, këto vende i kanë parë dhe hyjnë gjithmonë atje. Hz. Xhebraili, që është takuar me profetët, evlijatë, bashkë me shokët e tjerë tregojnë për ekzistencën e vendeve të fshehta. Ata tregojnë për melekët, që shëtisin nëpër këto vende. Edhe pse nuk i kemi parë këto vende, njëlloj si zbulimin e Amerikës që e dëgjojmë prej dikujt, ne besojmë për ekzistencën e saj, tek jeta e amshuar dhe e pavdekshme, tek Xhenneti dhe Xhehennemi. “Fjala e njëzetegjashtë” është Risale-i Kaderi (mesazhi i caktimit të Zotit). Ajo tregon themelin e besimit, përcaktimin e Zotit. Indirekt ajo tregon edhe Tubimin e Ringjalljes, si dhe shpërndarjen e fletëve për peshën dhe vlerat e veprimeve. Këto do të peshohen dhe maten në Peshoren e Madhe. Të gjitha këto shfaqen para syve tanë dhe tabela e peshave shfaqet për secilin. Gjithashtu edhe biografia e secilit është shkruar në kujtesë. Përpos këtyre edhe jeta e bimës në farëra dhe e drurëve në bërthamën e frutave, është shkruajtur si në një fletore të veçantë, duke dhënë një panoramë të qartë të mbrojtjes nga All-llahu i Madhërishëm. Në të vërtetë ky përcaktim i gjerë duhet të shënohet për llogaritjen e një programi konçiz për veprimtarinë e njeriut. Mbi të gjitha, kjo është një fletë garancie për vetë njeriun dhe jetën e tij, sepse aty pasqyrohet i gjithë qëndrimi dhe sjellja e tij, gjë që do të duhet më pas për jetën e përtejme si dokument bazë. Me këtë dokument ai do të dalë përpara Gjyqit të Madh, ku do të vendoset për shpërblimin e

vazhdueshmërisë së jetës apo dënimin e paskajshëm, që do ta hidhërojë së tepërmi. Ky regjistër duhet dhe është i domosdoshëm. Po të mos ekzistonte ai, si dhe mbrojtja e rreptë, çdo gjë do të ishte e pakuptimtë dhe jashtë çdo logjike. Po të mos bëhej Ringjallja ashtu siç është përshkruar me lapsin e caktimit, çdo gjë do të ishte e palogjikshme dhe një tirani e madhe.

PËRMBLEDHJE: “Pesë Themelet” e besimit, me tërë argumentet e tyre vërtetojnë tubimin e Ringjalljes, të vërtetën mbi Të dhe shpalljen e Tij, vërtetojnë jetën e Mbrapme si dhe dëshirën e zjarhtë për Të. Me këto argumente përforcohet edhe më tepër, sepse ato janë shtylla të forta e të parrëzueshme. Duhet të dimë se pjesa e tretë e Kuranit Famëllartë, përmban jetën e vërtetë, Ringjalljen. Secili argument është një gur në themelin e të vërtetës ku ajo është ndërtuar.

PIKA PËR TË

(Për All-llahun)

Duke menduar kuptimin e ajeteve 14)

S’ka Zot tjetër përveç All-llahut” dhe Aje 14)

“Thuaj që All-llahu është Ai momentalisht ana e dukshme e këtyre ajeteve më bëri të shoh një pikë të bukur. Me “dylbi” pashë se në rrugën e të devijuarve dhe të ateistëve, ka vështirësi dhe pamundësi të pambarim. Këtë pikë të gjerë dhe të gjatë, do t’ua sqaroj me një shenjë të shkurtër. Ja pra ashtu si një grusht dhé që është në vazo i japin jetë mijëra lloj luleve, në këtë rast këtë vepër, po qe se ia japim natyrës dhe fenomeneve të verbëra, atëhere në atomet e dheut dhe në sasinë e luleve, duhet të ishin makina dhe fabrika të vogla, që të dinë të krijojnë pajisjet dhe veçoritë e ndryshme të gjallesës së atyre luleve. Pra çdo atom duhet të jetë si një hyjni që të ketë aftësinë e pafundme dhe diturinë e pambaruar...

Njëllloj edhe në fjalën (Ai, pra All-llahu), janë grumbulluar atomet e ajrit që duke pranuar All-llahun e Madhëruar, kryejnë vepra interesante, ku nëpër të gjithë botën bartin zërat e telefonëve dhe telegrafëve. Ndoshta nga fuqia e fjalës (Ai, pra All-llahu), marrin aq fuqi, saqë në cepat e atomeve të ajrit përmbledhen aftësitë në sasinë e atomeve që ka nevojë t’i dijë gjuhët dhe nevojat e telefonëve dhe telegrafëve, nevojën e luleve, e bartjes së erës dhe disa të tjera. Për të kryer këtë detyrë është e nevojshme të zotërojnë një aftësi sa të gjithë telefonistët, telegrafistët dhe stacionet e radiove (dhe të televizioneve), sepse këto punë janë duke u krijuar dhe atribuar vetëm nga ana e atomeve të ajrit, të cilat mbajnë këtë aftësi.

Tani shikoje të pamundurat dhe mitet e rrugës së natyralistëve dhe materialistëve. Aty nuk është vetëm një e pamundur, ndoshta numri i të pamundurave të tyre është sa atomet e gjithësisë. Këto punë të paimagjinueshme, kur ia atribuojmë Mjeshtrit Madhështor, atëhere me urdhërin e Tij ajri i bëhet shërbëtor. Me lejen dhe fuqinë e All-llahut duke u mbështetur në Të, punët e mëdha bëhen aq shpejt, saqë puna e të gjitha atomeve bëhet lehtësisht. Me lehtësinë e vetëm të një atomi, sa të thuash (Ai), atëhere botërat e ajrit bëhen një faqe e një elementi superior për të shkruajtur fjalët e fuqisë së All-llahut (xh.sh.). Ato duke “shkruar” me majat e lapsave të atomeve, mbajnë nga një pikë mrekullie, pra krijohen në lehtësinë e lëvizjes së një atomi. Me mendimet e mia duke udhëtuar në fjalët e shenjta oajet.....32(La ilahe il-All-llah-S’ka Zot tjetër përveç All-llahut) dhe Ajet.....32(Kul hu vall-llah, “Thuaj që All-llahu është Një), për të vërtetuar Njësinë e All-llahut të Madhëruar, hodha sytë që të sodis botërat e ajrit dhe të lexoj elementet në mënyrë përmbledhëse në ajër, dhe në fjalën (Ai), saktësisht m’u sqarua kjo e vërtetë dhe Njësimi i All-llahut m’u vërtetua në ajrin e Tij, ku në të gjeta një argument të ndritur. Në

këtë mënyrë e kuptova se për çfarë Kur'ani i famshëm dhe ato që bëjnë dhikër (përmendje të Zotit) dhe për ta vërtetuar Njësimin e All-llahut (xh.sh.), shumë herë, e përsërisin fjalën e shenjt (Ai). Shkëlqimi i kësaj fjale për Njësimin e All-llahut (xh.sh.) ndrit në shumë shenja materiale dhe po ashtu edhe shpirtërore.

Ja disa shembuj: Një krijesë e vogël po të marrë mbi vete një peshë të rëndë, do të shtypet, një vesh zërat e ndryshëm nuk do të mund t'i dëgjojë, ashtu edhe gjuha s'mund të flasë përnjëherë shumë fjalë. Duke filluar nga ky ekuilibrim, fillova të udhëtoj në mend në shtresa dhe në elementet e ajrit, me çelësin dhe busullën (e Tij), në secilin cep dhe në brendësinë e secilit atom, pashë mijëra pika, germa apo fjalë të ndryshme, që përsëri nuk ngatërrohen, rregulli i tyre nuk priset, bile ato duke kryer detyra të ndryshme dhe të shumta përsëri krijojnë pa u ngatërruar fare dhe megjithëse atomi më i vogël mban pesha të rënda, përsëri nuk tregohet i dobët dhe nuk ngelet mbrapa, e kështu ua dërgon tek gjuhët interesante, tek veshët e vegjël të atomeve të ajrit, me një përsosmëri superiore, duke hyrë dhe dalur, pa fare ngatërrim. Ato copa dhe atome të ajrit, duke krijuar këto punë të mahnitshme, duke u sjellur dhe lëvizur andej-këndeje dhe duke dëshmuar ajet 14) (La ilahe ilall-llah-S'ka Zot tjetër përveç All-llahut) dhe me fuqinë e ajet: 14) (Kul hu vall-llahu ehad-Thuaj që All-llahu është Një), mund të ecin dhe lëvizin atomet e ajrit, duke formuar stuhitë, vetëtimat dhe rrufetë, brenda përplasjeve të valëve me një lëvizje të shpejtë e të ndryshme. Rregulli i tyre nuk priset dhe ato në drejtimet e tyre nuk gabojnë, njëra punë nuk i bëhet peng tjetrës.

Pra, ose do të themi se secili atom apo secila pjesë e ajrit, ka dituri gjeniale dhe mban një vullnet të mprehtë dhe një fuqi të pasosur që sundimi i tyre ishte në gradën absolute apo secili atom do të ishte i nënshtruar shokut pa fare kundërshtim. Për këtë, asnjë "shejtan" nuk mund të thotë se atomet e ajrit mund të bëhen vetvetiu, sepse ajo është një e pamundur aq sa numri i vetë atomeve. Nga kjo del se këto vepra të mrekullueshme padyshim janë të All-llahut të Madhëruar, dituria e të Cilit është e pafundme dhe Ai i shkruan këto me lapsin e caktimit të Tij. Fuqia e Tij përfshin horizontet e qiellit, e cila për to është një faqe e shndërrueshme si një dërrasë e zezë shkollore, ku në të shkruhet dhe fshihet.

Elementet e ajrit vetëm me detyrën e bartjes së zërave, tregojnë ekzistencën e All-llahut (xh.sh.) që është vetëm Ai që i bën këto çudira. Tregimi i mëparshëm tregon të pamundurat e panumërta të të devijuarëve. Një nga detyrat e rëndësishme të ajrit është gjithashtu edhe bartja e rrymës elektrike, forcat tërheqëse dhe drita. Ajri në momentin që përcjell zërat në të njëjtin çast përcjell edhe rrymën elektrike dhe forcat tërheqëse. Ai në të njëjtën kohë u sjell erën bimëve dhe kafshëve, duke kryer detyrën e pllenimit të bimëve. Pra atomet e ajrit në të gjitha nevojat e domosdoshme atribuojnë me një përsosmëri të jashtëzakonshme, duke kryer detyrat e tyre. Tani me këto detyra të treguara më parë, vërtetohet se kozmosi është një "Arsh" i urdhërit dhe vullnetit të All-llahut (xh.sh.). Tani me këto tregime kuptohet se nuk është e mundur që nëpër gjithësi të sundojë rastësia e çthurur, fuqia e verbër, natyra e shurdhër, shkaqet e ngatërruara të paqëllimita dhe elementet injorantë të dobët e të pashpirtë, ato janë vetëm një krijesë e jo Krijues. Në këtë mënyrë e kuptova se secili atom dhe cep i ajrit, me gjuhën e gjendjes së tij thotë ajet: 14)

dhe (La ilahe ilall-llah-S'ka Zot tjetër përveç All-llahut) dhe aje (Kul hu vall-llahu ehad-Thuaj që All-llahu është Një). Kurse tek (Huve-Ai), pashë çelësin e anës së dukshme të këtyre çudirave. Njëlloj edhe për botëra të padukshme (Ai) është një çelës. Nga ana e fshehtë nuk u lejova që të vazhdoj më tej.

Të gjithëve mijëra selam!

Vëllai i juaj

Said Nursi

Unë e pashë se: Në botën shpirtërore, pa u ngatëruar fare, po merren fotografi të pa fundme, bile me ndodhi orgjinale. Në kinemanë e madhe të botës shpirtërore e pashë se ajo ishte e gjerë sa mijëra rruzuj të botës ku kishte edhe xhennete në të cilët u tregohen dashamirëve ndodhitë, pejzazhet dhe tabelat e kësaj jete të përkohshme. Këto më dolën para si një kinema e ahiretit ku shpallëshin fotografitë, dhe duke parë ato m'u plotësua besimi dhe u binda. (shënim)

Si në panoramën e madhe të All-llahut ashtu edhe në botën shpirtërore që na tregojnë me dy shenja dhe pika të vogla të cilat kanë kontakt me kujtesën e njeriut, Kjo kujtesë që është në madhësinë e një kokrrë gruri përmbanë dituritë sa një bibliotekë dhe aty mbron pa u ngatërruar fare. Pra kjo aftësi e vogël e kujtesës është një çelës për të kuptuar dy botra të mëdha: njëra panorama e Levhi Mahfudhit dhe tjetra Bota shpirtërore.

Tani elementet të ajrit dhe të ujit veçanërisht pikat e spermës dhe atomët e ajrit, janë shumë më interesante dhe më precize se elementet e tokës, sepse në to duket shumë qartë vulosja e Gjithëdijes së Zotit të Madhëruar. Prapë duket se në to nuk sundon ndonjë rastisi, apo ndonjë fuqi qorre, apo natyra e shurdhër, apo ndonjë tjetër send që është përmbledhur nga shkaqet pashpirt e të paqëllimta, pra njëqind here është e pamundur që t'i krijojnë këto që thashë. Me siguri e padyshim shkencat na vërtetojnë se këto janë krijuar me lapsin e caktimit të Gjithëdijëshmit Madhështor, duke i shpalosur ai i ka nxjerrë këtu në shesh.

(Të tjerat mbetën pa u shkruar)

Të gjithëve mijëra selame

.....

(Shënim) Fatkeqësisht mbeti pak; koha, gjendja e vendi nuk na lejuan që ta vërtetojmë me argumente të forta si ato të vërtetat të qarta.

.....

POZÝTA E DYTË TË SHTATËMBËDHJETËS FJALË (Shënim)

O fatkeq, mos bërtit, duke u bindur eja mbështetu,
Sepse bërtitjet janë gabimet e tua të mbredshme.

Po që se ke gjetur atë që ty ta ka dhënë belanë,
atëherë ke gjetur dhuratën e madhe të rehatisë.

Braktisi bërtitjet ,falendero Krijuesin tënd,
në këtë rast belaja ty të qeshë, ti bën gazmend.

Por,po qe se nuk mund të gjesh Atë ti;
Atëhere jeta jote boshe dhe plot me fatkeqësira.

Ti mbi kokën tënde duke patur belanë sa bota,
Për çfarë bërtet nga dertet e vogla, eja mbështetu.

Duke iu bindur Atij, ktheu në fytyrën e belasë e qesh,
Prandaj edhe ajo shndërrohet e zvoglohet përballë teje.

Or ti egoistë, mund të kënaqesh vetëm kur ikë nga bota,
Në goftë se beson Zotin ajo ty të mjafton,
Atëhere edhe t'i braktisesh sendet, ato janë në dobinë tënde.

Po qe se je egoist, është shkatërrim, çdo send është kundra teje, Se, në te dy raste duhet ta
braktisësh dapamirësinë e kësaj bote.

Pra, si braktiset? Në emrin e Tij dhe me lejën e Tij ta
shpenzosh mallin hyjnore,
Ne goftë se don dikush tregtinë, le ta përjetsojë jetën e përkohshme.

Ne goftë se don t'i plotësosh dëshirat e veseve epshore; ajo është e kalbur dhe e pathemeltë,
Ne goftë se don objektin ajo mbanë vulën e përkohshmërisë.

Domethënë: Nuk vlen të blesh mallrat e këtij tregu, se janë të kalbur.
Prandaj kalo...mallrat e mira janë radhuar mbrapa.

Shënim

Pjesët e pozitës së dytë, megjithëse i ngjanin poezisë por nuk janë poezi. Nuk janë rreshtuar me
qëllim.Ndoshta përsosmëria e të vërtetave të tyre ato i ka futur në këtë formë.

FRUTA E MONDÝT TË ZÝ

(Saidi i vjetër këto fjalë ika folur në majën e Mondit fisnik)

Para meje nuk është Zija Pashai por adhuruesi i Europës.

Folësi s'është nefsi im, por është zemra ime që flet në emër të nxënësëve të Kur'anit.

Mos u habit që të tërhiqesh se këto fjalë janë të vërteta.

Mos u mashtro mendimeve të huaja se është devijim, atyre mos ua vë veshin se të shtynë të
pendohesh.

Logjika është flamurtari i flaktë, që duke tmerruar gjithmonë thotë "Oh i mjeri, unë po
habitem.Nuk di se kujt e nga kush të ankojem"

Unë them se: Kur'ani po më shtyn të them.

Unë nuk habitem si ti, tek Ai i ankojem për fatkeqësitat që vijnë nga Ai.

Nga shtrëngimet që vijnë nga Zoti, bërtas tek dera e Tij, nuk e tejkoloj si ti,

Unë nuk iki si ti. Sepse: Ideja ime zgjatet deri në qiell.

Unë nuk e ha fjalën si ti. Sepse idea e Kur'anit nga njëra dritë shkon në dritën tjetër.Dobia dhe e
vërteta është në Kur'an; për këtë unë nuk e vlerësoj fare filozofinë e kundërt.

Unë e përqafoj Kur'anin, Atë nuk e shes si ti, sepse Ai është diamanti i vërtetë, nga krijesat sodisi të vërtetën, nuk devijoj si ti.

Unë fluturoj nëpër rrugë me ferra, nuk i shkel si ti. Nga toka e deri në qiell falenderoj Zotin, nuk kundërshtoj si ti.

Vdekja është miku im, prej saj , nuk trembem si ti.

Unë duke qeshur hyj në varr, nuk trishtohem si ti.

Unë varrin nuk e shoh si ti që e konsideron bujtina e egërsirave dhe fyti i zhdukjes; ai është një dashamirës që më bashkon me miqët; atij nuk i hidhirohem si ti.

Ai nuk më shqetëson, sepse është dera e mëshirës e dritës dhe e drejtësisë, Me emrin e Zotit duke mos trishtuar e mos parë mbrapa trokas në atë derë.(Shënim-1)

Mua nuk më vjen vështirë, unë nuk trishtohem, duke falenderuar shtrihem dhe qetësohem në varr. Me borinë e “Israfilin” ringjallet duke thënë:” All-llahu është më i madh” (Shënim-2)

Jam në strehimin e Kur'anit dhe më mbron mëshira Hyjnore, për këtë unë nuk shqetësohem; për të shkuar në hijen e Gjithëmëshirshmit pa u ndalur do të fluturoj. Nuk habitem si ti.

(Shënim-1) Duke u trishtuar nuk them “i mjeri unë “dhe të iki mbrapa.

(Shënim-2) Në varr do ta dëgjoj Ezanin e Melekut Israfil që të shkoi në mahsher, duke thënë:

“All-llahu është më i Madh” do të ngrihem, nuk tërhiqem nga namazi dhe tubimi i mahsherit të madh

Prijsi I Rinise - III

TË NDERUAR VËLLEZËRIT E MI

Së pari: Jua uroJ Bajramin të gjithë nxënësve të Nurit dhe gjithë Haxhive që tani janë duke përmendur All-llahun xh.sh. dhe janë duke krijuar haxhin e madh. Ky urim ndodhi në një ditë që shumë shtete muslimane janë liruara nga kolonia e armiqve, si India dhe vendet arabe që janë shtetet e mëdha të botës Islame. Ne jemi duke shpresuar se ato do të formojnë shtetet e mëdha të islamit. Sepse vetëm India është njëqindë milion një shtete muslimane. Ëndopnezija mbi pesëdhjetë million, këtyre shteti edhe vendet arabe që përbëhen katër-pesë shtete të Islamit. Pra ky festimi i Bajramit të haxhit është një paralajmërim i festimeve të mëdha të Islamit.

E dyta: Sipas shkrimeve të Rifat Beut dhe të Mustafa Uruçit që më kanë dërguar nga Stanbolli, në ballën e derës së universitetit dhe në derën e ushtrisë së Islame, që megurët e mermerit patën mbuluar Ajetet e Zotit. 5)

përsëri siç ishte shkruar me shkronja të mëdha. Lajmi i tyre na gëzoi shumë që ato shkrime tani i kishin zbuluar. Ky lajm është një paralajmërim që do të lirohen edhe shkrimet e Kur'anit në orgjinal. Është një lajm gëzimi për idenë e Risale-i Nurit që në të ardhmen Universiteti do të bëhet një shkollë për t'i mësuar edhe "Mesazhet e Dritës". Disa nga nxënësit e Nurit të qytetit të Denizlisë Ahmedët (*) më tregojnë për dijetarin dhe mendimtarin e madh, për Bismarkun që ai është sociologu më i madh i shekullit të nëntëmbëdhjetë që ai në një anekdotë të librit të tij kishte thënë kështu:

"Unë Kur'anin e studiova tërësisht. Në secilën fjalë të Tijën u përballova me dobi dhe me vërtetë të mëdha. Për të drejtuar njerëzimin nuk mund të gjeni një libër tjetër ligji si Ky dhe asnjëherë nuk mund të vijë ndonjë si Ky"

Dhe për Profetin Muhammed (a.s.m.) thotë kështu:

"O Muhammed: Për arsye se nuk kam patur fatin të përjetoj shekullin tënd jam shumë i mjeruar. Njerëzimi njëherë ka parë një fuqi si Ti! Më nuk do të mundë ta shohë! Prandaj unë, duke treguar ndaj Teje nderim e respekt, përkulem para Teje." Dhe ka nënshkruar Princ Bismarku(*)

(*) S'ç kam shënuar edhe në letrën e Ahmedëve, në librin "Prijësi i rinisë" le të regjistrohet edhe kjo ndodhi e vërtetë e Bismarkut.

Unë i vërtetova fjalët e tyre dhe thashë:

Bismarku ka qenë mendimtari, filozofi, politikani dhe personaliteti më i madh i shekullit të nëntëmbëdhjetë. Jo vetëm ky lajm, por janë edhe disa të tjerë që na gëzojnë, sepse edhe bota islame nëpër disa vende po fiton pavarësinë dhe shtetet e huaja janë duke kërkuar të vërtetat e Kur'anit, si në lindje ashtu edhe në Perëndim. Në favor të Kur'anit është një rrymë e madhe dhe filozofi i madh dhe i famshëm të Amerikës "Mister Karlajli" që duke i dalë zot Kur'anit ka folur njësoj si Bismarku. Duke dhënë vendim e pretekst ka thënë kështu:

"Librat e tjerë nuk mund të arrijnë Kur'anin në asnjë drejtim. Ai është fjala e drejtë. Duhet të dëgjojmë Atë. Në këtë kemi shkruajtur edhe para tridhjetë vjetësh në veprat e vjetra, pra në komentin "Isharatul Ixhaz" që është në arabisht. Sepse, na shtojnë edhe më shumë gëzimin këto fjalë të vërteta të këtij personi të famshëm duke parë që nëpër çdo anë me shpejtësi të madhe po shtohet edhe ngadhnjimi i Risaleve. Këto shenja, po na paralajmërojnë se edhe nëpër vendet e huaja do të dalin shumë Bismarkë dhe Mister Karlajle. Këto paralajmërime po jua dërgon si një dhuratë bajrami sepse këto mbajnë gëzime të mëdha.

Të gjithëve ua përshëndes Bajramin!

Vëllai i juaj Said Nursiu

Në tregimin e letrës së Ahmedëve, është deklarata e Bismarkut e shkruar në këtë mënyrë:

I nderuar mesuesi dhe zotria ynë!

Do t'ua parashtroi deklaratën e Kryetarit famshëm Gjerman, të princ Bismarkut që ka parashtuar mendime ndaj feve qiellore, veçanërisht për fenë tonë Islame. Me këtë tregim do të kuptohet se sa është duke përparuar islami në vendet perëndimore.

Ai është një personalitet i shekullit të nëntëmbëdhjetë. Unë ikam parë shkrimet e tij duke u interesuar për jetën shoqërore. Këto janë mendimet e Bismarkut për fetë qiellore dhe gjykimi i tyre është i ngritur. Ndërsa Bismarku këto fjalë i ka deklaruar pak para se të vdiste:

Megjithëse gjerësisht i kam hetuar të gjitha librat që thuhet se janë hyjnor, për arsye se janë përballuar me fallsifikime, tek asnjëri nuk kam mundur të gjej përpikmërinë që ka kërkuar. Në

fund mora vendimin se këto libra jo një popull, por as lumturinë e një familjeje nuk mund ta garantojnë. Kurse Kur'anin i Muhammedive ishte larg prej këtyre. Sepse unë e hetova Kur'anin gjithësisht dhe në secilën fjalë u përballova me dobi dhe të vërteta të mëdha megjithëse armiqët e Muhammedive thonë se Muhammedi (a.s.m.) vetë e ka shkruar. Por mendja e pastër ato thënie nuk i pranon kurrë, sepse asnjë logjikë superiore nuk mund të japë këtë prodhim. Ky mendim kundërshtohet me të vërtetën dhe diturinë reale, sepse në qoftë se dikush mbyll sytë ndaj të vërtetave të pamohueshme, ka bërë një gabim të madh. Unë pohoj se Muhammedi (a.s.m.) është një fuqi e posaçme. Sepse diçka e tillë nuk është e mundur në botën e qenieve. Le të paraqitet një fuqi tjetër si ky.

O Muhammed (a.s.m.) për arsye se nuk kam pasur fatin të përjetoj shekullin tënd, jam shumë i mjeruar. Ti që je mësuesi dhe shpallësi i Kur'anit famëlartë, ai nuk është prodhimi i yt, por është një libër hyjnor. Ta mohosh këtë fakt, është një marrëzi dhe i ngjan mohimit të të gjitha shkencave. Kështu, Ty njerëzimi njëherë të ka parë, nuk është e mundur më të shohë. Unë duke shpallur nderime, dashuri të sinqertë dhe të përsosura, të përkulem ty.

Princ BÝSMARKU

Unë them se, meqë kjo botë është e përkohshme dhe meqë mosha është e shkurtër dhe meqë punët e vlefshme janë të shumta, meqë jeta e përhershme këtu do të fitohet, meqë kjo botë nuk është pa Zot, meqë në këtë bujtinën e vizitorëve gjykon një Gjykatës i Gjithëdijshtëm dhe meqë nuk do të mbesin as të mirat pa shpërblim dhe as të këqijat pa dënim dhe meqë me sekretin e ajetit:

Ajet“All-llahu nuk e ngarkon askënd përtej mundësive të tij”. (Bakara, 286); nuk jemi të obliguar me atë që s'mund ta përballojmë dhe meqë rruga e sigurtë preferohet ndaj asaj të rrezikshmes dhe meqë vlera e pozitave të kësaj bote vlen vetëm deri tek varri; atëhere me siguri është fatbardhë ai që për jetën e shkurtër, nuk e harron jetën e përhershme, jetën e paskajshme nuk e sakrifikon për këtë të përkohshme dhe nuk e prish jetën e përhershme dhe jetën e kësaj bote nuk e harxhon në vende boshe. Ai duke e pranuar veten si mysafir, të mos kundërshtojë urdhërat e të Zotit të shtëpisë dhe në këtë mënyrë me një besnikëri të madhe mund ta hapë derën e varrit që të hyjë në lumturinë e përfundimtare.

PYETJE E SHTATË AJETÝ 16)

A është ky një Hadith? Dhe çfarë qëllimi ka kjo fjalë?!

Përgjigje: Më kanë thënë se është Hadith. Dhe ka këtë qëllim: “I riu më fatbardhë është ai që jeton si ndonjë plak duke menduar vdekjen dhe përpiqet që të mos humbë ahiretin; mbrohet të mos e pushtojnë veset epshore dhe pakujdesia e rinisë. Dhe plaku më i keq ai është që jeton duke u përpjekur t'i ngjajë të rinjve që mashrohen prej veseve dhe jeton si fëmi që duke mos u kujdesur u dorëzohet veseve epshore”

Pjesa e dytë e tabelës- pllakës tënde që e ke të varur, mban këtë kuptimin të vërtetë që: Edhe unë mbi kokën time e kam varur atë si një pllakë të rëndësishme që, çdo mëngjes e mbrëmje, duke parë atë po marr mësimin tim:

“Po që se don një mik, të mjafton All-llahu”.

Pra, në qoftë se Ai është mik, secili send është miku yt.

Po qe se don jaran të mjafton Kur'ani”.

Ja pra, duke imagjinuar të Vërtetat e kur'anit takohem me ngjarjet e Profeteve dhe me Melekët.

“Po qe se don mall të mjafton bindja”.

Ja kush i bindet All-ahut xh.sh., ai bën edhe ekonomi, kush bën ekonomi ai gjen bereqet.

“Po qe se don armiq të mjafton Uni- egoja”:

Ja kush e pëlqen vehten; ai e gjenë belanë dhe has në vështirësi; kush nuk e pëlqen egon, ai bën ngazëllim dhe hynë në mëshirën e Zotit.

“Po qe se don këshillë të mjafton vdekja”:

Pra, kush mendon se do të vdesë ai nuk lidhet fort pas botës dhe bëhet gati seriozisht për jetën tjetër.

KURA E PESTË

O ti njeri që të është ngjitur sëmundja!

Unë kam bërë provë dhe jam bindur se sëmundja për disa njerëz është një Bamirësi e Zotit xh.sh. dhe një Dhuratë e Çmuar e të Gjithmëshirshmit. Ky është thelbi i këshillave që u jepet atyre që vinin për të më takuar, që unë t'i lutesha Zotit për t'ua larguar sëmundjen sa më parë. Vija re se një djalë i ri që erdhi tek unë i sëmurë, kishte filluar të mendonte për Jetën e Përtejme. Sëmundja e kishte shpëtuar nga veset e kafshës. Të gjithë të sëmurëve që vinin për këshilla u thosha të mos mërzhiteshin, se këtë e kishin prej Zotit xh.sh.. Dhe më pas shtoja: "O vëlla, unë nuk jam kundër sëmundjes tënde dhe nuk e shoh këtë sëmundje si një fatkeqësi për ty, prandaj do t'i lutem Zotit, që të shpëtosh nga kjo sëmundje". I thoja: "Mundohu të durosh, gjersa të zgjasë kjo sëmundje. Inshaal-llah Zoti të shëron" Dhe shtoja: "Shokët e tu që janë shëndosh, në të vërtetë ata janë të sëmurë, kanë braktisur namazin, vdekjen e kanë harruar dhe All-llahun nuk e kujtojnë. Ata e kanë harruar Atë. Për të bërë qejf në këtë jetë, ata humbasin dhe shkatërrojnë Jetën e Përjetshme. Në kllapinë e sëmundjes tënde, patjetër që të dalin parasysh stacionet nepër të cilat do të kalosh. Ty po të shfaqet gropa e varrit dhe pas saj vendi ku do të qëndrosh përgjithmonë. Ti sipas këtij itinerari po lëviz, domethënë për ty sëmundja është në të mirë, prashëndet, kurse shëndeti i shokëve të tu nuk është tjetër gjë veçse një sëmundje.”

(Nga shkëlqimet

17)

Kuptimi: “Nefsi vazhdimisht tështynë nëpër gjëra të këqija.” Këtë pikën e bukur forcon Hadithi që thotë:

HADÝTHÝ :

Kuptimi: Për ty armiku më i dëmshëm është “Nefsi” yt (Uni, egoja dhe veset epshore)

Pa u dalluar fare, kush mbanë “nefsi emmarre“ (nefsin pa kultivuar)

Ai duke mos dashur tjetërkënd, pëlqen dhe e don vetëm vehten e tij. Në dukje edhe në dashtë dikë, ai nuk është i singertë. Ndoshta e don për ndonjë interes dhe për shije që ka në të, ose përpiqet që për qëllimin e tij ta pëlqejnë dhe ta dojnë atë. Ai mundohet vazhdimisht ta prezantojë vehten të mirë dhe nuk merr kurrë përsipër gabimin duke bërë si avokat. Duke paraqitur lloj-lloj demagogji e gënjeshtresh, përpiqet të pastrojë dhe të lavdrojë vehten sipas gradës që ka devijuar dhe merr goditjen e ajetit të All-llahut madhëruar që thotë AJETÝT:

18)

Shënim. Kjo pjesë është e dobishme për secilin.

Ata që veset e vehta konsiderojnë virtyte, duke kërkuar që ta lartësojnë veten, por përballen me kundërtën e saj dhe poshtrohen e ftohen nga Allahu I Madhëruar. Nga këto mendime që kanë e humbin edhe sinqeritetin në punët e ahretit. Pra me këto mendjemadhësi i mbyllen sytë dhe nuk e sheh rrezultatet e punëve të vehta që do t'i paguhen në të ardhmen. Në këtë rast ngjitet shijeve të gatshme dhe bie i mundur nga veset e këqija dhe sillet si ai që ka humbur rrugën. Duke u mashtruar nga ligjet e veseve, për shijen e periudhës së një ore së vetme, duron torturën e gjatë të burgut shumëvjeçar. Për kryelartësinë apo hakmarjen e një minuti të vetëm, vuan dënimin e dhjetë viteve burg. bëhet i ngjashëm me atë fëmi që për një kokërr sheqer e shet librin që po meson në shkollë. Bile për të kaluar dhe plotësuar dëshirat e veseve, të edhe jep veprat e mira që janë në vlerën e diamantit. Kryelarti, duke pëlqyer unin nuk mund t'i dallojë shijet e pakta që janë në vlerën e cepëve qelqit të thyer me ato që i sjellin fitim e begati të mëdha.

(Nga mesnevi-i Nuriije)

Dije o vëlla i nderuar!

Gjendja ime përngjan kuptimit të kësaj vjershe që thotë:

“Syte e mi patën fjetur në kohën e rinisë që i ngjan natës;, u zgjova me mëngjesin e pleqërisë”
Sepse në moshën e rinisë mendoja se kam arritur në kulmin e zgjimit. Tani po e kuptoi se: Ai s’ ishte zgjim por ishte shtresa më e trashë e gjumit. Prandaj, disa njerëz që gjoja janë të qytetëruar dhe duke u lavdëruar asaj i thonë jeta e ndritshme, sigurisht kjo jetë e tyre i përngjan jetës së rinisë sime.

Gjendja e tyre i ngjan atyre që, gjoja i ka dalë gjumi dhe ëndrën ua tregojnë diku tjetër. Ndërsa shembulli i zgjimit të tyre na tregon se ato nga shtresa e hollë kanë rë në shtresën më të trashë të gjumit. Ky njeri është si ndonjë i vdekur. Pra, a ka mundësi ky njeri të zgjojë të tjerët që tani janë të përgjumur?

Or ju që duke qenë në gjumë mendoni se jeni i zgjuar! Në punëra të fesë, mos iu afëroni atyre që vehten konsiderojnë të qytetëruar. Sepse është thelle lumi shumë që qëndron ndërmjet nesh. Nuk është e mundur ta mbushni atë dhe të barazoheni me ta. Apo doni që të dorëzoheni, apo do të gulçiteni duke rënë devijim.

(Nga Menevi-i Nuriije)

Alegoria e tretë: O njeri! All-llahu i madhëruar ka vendosur në brendësinë tënde një virtyt të tillë që: Nganjëherë bota nuk po të zë. Ti, duke dëshiruar një vend më gjerë po ngjanë i burgosurit që ia shtrëngojnë fytin dhe bënë “of, of”; kurse nganjëherë po hynë e po vendosesh për një moment shumë të shkurtër në një punë të vogël, në një atom apo në një mendim. Zemra dhe mendja jote, duke mos mundur të vendoset në botën e madhe, përkundrazi po mundet të vendoset në një grimcë të vogël. Me ndiejshmëritë e tua të furishme për një minutë po endesh në atë mendimin e vogël .

Dhe në cilësitë e tua janë vendosur vegla e shqisa shpirtërore në mënyrë të tillë që, disa edhe ta përpinin botën nuk ngopen dhe ndonjëra nuk po mund të përmbajë atomin e vogël. Koka po mund të transmetojë gurin e madh; syri nuk po mund të mbajë qimen; shqisat shpirtërore nuk po mund të mbajnë gjendjen minimale as sa një qime të pakujdesisë dhe devijimit të njeriut, derisa kjo shqisë shpirtërore nganjëherë s'mund të qëndrojë dhe vdes. Meqë është kështu, bëhu i hollë e duke kujdesur. Kur hedh hapin e shkelë, duhet të friksohesh se edhe mund të gjejsh fundin! Për arsye se je njeri, e ke rrezik mund të përmbysesh vetëm me një kafshatë, me një fjalë, me një kokërr, me një shkëlqim, me një shenjë, me një puthje, prandaj mos i përmbys nëpër to ato shqisa të vyera që mund të përpinin botën! Sepse janë shumë gjëra të vogla që në një fare mënyre mund të përpinin shumë gjëra të mëdha, si p.sh., në cepin e qelqit mund të hyjë dhe të gulçiten qielli me gjithë yjet. Sa një kokërr gruri që është kujtesa jote; shumica e veprimtarisë së ytë dhe faqja e të gjithë moshës tënde hynë në të. Si këto janë shumë gjëra të vogla që përfshijnë çëshjet e mëdha.

(Nga shtojca e Kastamonusë)

Si shumica e Hafizëve, edhe një nxënës i Nurit më tha: Çfarë të bëj, tek unë po shtohet sëmunda e harresës?!”

Atij i thashë: Sa ke mundësi ruaju e mos shiko femrat që janë haram për ty. Sepse transmetohet, siç ka thënë edhe Ýmami Shafija “Shikimi në haram të jep harresë.”

Ja pra, nëpër vendet e muslimanëve kur shtohet shikimi në femrat huaja, atëhere duke u entuziazmuar ngadhnojnë dëshirat veseve epshore. Në këtë rast (edhe po u mbrojte nga harami) e shpërdoron trupin, për një javë detyrohesh të bashkohesh disa herë, dhe të bëhesh për gusul Për kujtesën e njeriut edhe në pikëpamjen mjeksore kjo është e dëmshme.

Ja pra në këtë shekull nga lakuriqësia e grave, veçanërisht nëpër këto vende të nxehta, shikimi i femrave të huaja po bëhet shkak i shpërdorimit të trupit, Në këtë rast po del përfundimi me harresën e përgjithëshme. Dikush pak, dikush më shumë secili po ankohet nga sëmundja e harresës. Pra kjo sëmundje po e nxjerrë në sheshë sekretin e kuptimit të hadithit të Pejgamberit(a.s.m.) që thotë: “Në kohën e fundit Kur’ani do të tërhiqet nga gjoksi i hafizëve, dhe do ta harrojnë.”

Domethënë kjo sëmundje do të tmerrojë disa njerëz, dhe shikimi në haram do t’i pengojë të behen hafiza, duke sqaruar kështu kuptimin e hadithit të Pejgamberit

(Kjo letër shumë është e rëndësishme)

Të nderuar vëllëzërit e mi të sinqertë!

Në këto ditë mendova, se për çfarë në pamjen e Kur’anit, pas besimit për njëherë i jipet rëndësi devotshmërisë ndaj All-llahu xh.sh.. “Ameli salih” (Të bëjsh urdhërat e Zotit). “Takvaja” (Të mbrohesh nga ndalesat e Zotit);(nuk dimë nëse gjuhën shqipe devotshmëria e plotëson këtë fjalë) Gjithnjë të mos bësh gjynah parapëlqehet ndaj bërjes e sevapeve; veçanërisht në këtë kohë që na kanë ngadhnjuar shkatrimet e mëkatet, që të shpetojm prej tyre duhet të mbështetemi tek mos bërja e gjynaheve, se në këtë kohë ajo shumë vlenë. Sepse në ditët e sotme për të shpëtuar nga rryma të tmerrshme negative, devotshmëria vlen shumë. Jemi duke përjetuar një kohë që na sulmojnë mëkatet të mëdha në këtë rast rrallëkush mund të bëjë me sinqeritet punë të mirë (sevape)

Nga del se sot kush i bën farzet dhe largohet nga mëkatet e medha ai shpëton.

Dhe nën këto kushtet e rënda kush bën pak punë të mirë, kjo punë e tij mbanë shumë vlerë. Dhe Takvaja mbrojtja nga mëkatet vetvetiu mbanë edhe “Amel-i salih” punë të mira të sevapeve. Sepse të braktisësh haramin është vaxhib* dhe të krijosh një vaxhib, mban sevape përmbi shumë synnete. Pra devotshmëria - të mbrohesh nga mëkatet, në realitet s’është një vepër e lehtë. Në këtë kohë të vështirë që me lakuriqinë na sulmojnë mijëra gjynahe, me devotshmerinë kur mbrohesh prej tyre ajo ta garanton tërhiqjen nga njëqind haramë, pra me këtë ke bërë njëqindë vaxhibe.

*Vaxhibi është një urdhër i Zotit, që pas farzit zë vendin e dytë, megjithë se në termologjinë e arabëve vaxhibi përdoret edhe si detyrë parësore, pra në vendin e farzit.

Kur kjo vepër bëhet me qëllim të mirë, duke u friksuar nga All-llahu xh.sh dhe me mendimin që të ikësh nga gjynahet, ke bërë sevap të madh pa bërë adhurim me vepër. Vetëm për arsye se nuk e ke parë femrën e huaj që është haram, ke fituar shumë sevape (bërja e njëmijë synneteve nuk mund të arrijë se vapin e një vaxhipit të vetëm).

Në këtë kohë nxënësit e Risale-i Nurit, përballë shkatërtimeve shpirtërore të gjynaheve do të kenë qëllim kryesor të mbrohen nga bërja e tyre. Meqë me sistemin e sotëm jeta shoqërore po na sulmon në çdo minutë me njëqind gjynahe, me siguri për t’u mbrojtur nga këto sulme është e nevojshme të kesh qëllimin që të mbrohesh nga gjynahet dhe t’i mbështetesh devotshmërisë, sepse me pak punë ke bërë njëqind sevape.

E dimë se një njeri mund të shkatërrojë një vilë për një ditë, ndërsa njëzet vetë nuk mund ta ndërtojnë atë as për njëzet ditë. Pra, për të përmirësuar shkatërrimin një njëriut të vetëm duhet të punojnë njëzet vetë; ndërsa për të përmirësuar përballë mijëra shkatërrimtarëve, mund të qëndrojnë Risale-i Nuri, që padyshim ka një ndikim jashtëzakonshëm. Këto fuqi të kundërta po të kishin një nivel krahasimi, atëherë do të duket më mirë ngadhnjimi i Risale-i Nurit.

Ne jetën shoqërore është tronditur fuqia më e rëndësishme, mëshira dhe nderimi. Në ndonjë vend me ankesa të prindërve për fëmijët e tyre po dëgjohen rezultate shumë negative. E falenderoj shumë All-llahun e Madhëruar se Risale-i Nuri është duke qëndruar shumë mirë ndaj këtyre shkatërtimeve në ato vende që ka hyrë. Anarkistët mizorë, mosbesimtarët me gjynahe të ndryshme janë duke shkatërruar e prishur moralin e muslimanëve. Në këtë rast ka marrë plagë kalaja e Kur’anit që ka dalë në shesh si drejtësi e Muhammedit (a.s.m.) Zullumqarët e sotëm që kanë hapur plagë të mëdha ngjanin zullumqarëve që titullohen “Je’xhuxh” dhe “Me’xhuxh” që kanë shkatërruar “seddi zulkarnejnin” (murin e Kinezëve që ka ndërtuar Zulkarnejni).

Si Je’xhuxhi e Me’xhuxhi që e kanë shkatërruar murin e Seddi Zylkarnejnit, njësoj edhe drejtësia e Muhammedit (a.s.m.), pra kalaja e Kur’anit me shkatërrimin e zullumqarëve mosbesues, në një formë më ashpër ka marur plagë, nga anarkizmi që bënë ata në moral.

Në këto ngjarje, lufta shpirtërore e nxënësëve të Risale-i Nurit Inshall-llah do të bëhet e vlefshme dhe plotë me sevape si në kohën e Sahabeve që e kanë luftuar imoralitetin njerëzimit duke ua sjellur paqë e qetësi.

Vëllëzër të nderuar! Në një kohë të tillë, për t’u bërë ballë këtyre ngjarjeve të tmerrshme, pas sinqeritetit ndaj Zotit të Madhëruar, ne na vlejnë përpjekjet, “bashkpunimi shpirtëror”. Si në fletoren e sevapeve, ku regjistrohen dhe përshkruhen këto vepra me laps, njësoj edhe me gojë duke u lutur për njeri-tjetrin, dërgohet mbrojtje dhe ndihmë në kalanë e devotmërisë së vëllëzërve. Veçanërisht në këto muaj të madhërueshëm dhe këto ditë fisnike unë dua të më dilni zot duke u lutur dhe të më ndihmoni ndaj sulmeve që vijnë si stuhitë, se ata kanë si qëllim kryesor të dobëtin dhe të varfërin. Kjo juve ju ka hije sepse jeni mirëbërës dhe heronj besnikë. Me shpirt nga ju jam duke u lutur për ndihmën shpirtërore edhe unë, me kusht që të jeni të

sinqertë në shërbimin e besimit, ju që jeni nxënësit e Nurit nganjëherë; 100 herë në ditë edhe juve ju shoqëroj në fitimin e sevapeve.

Said Nursi

(Nga shtojca e Kastamonusë)

Kur dëgjoi prefekti fjalët e vajzës, përkundrejt mërive të huaja, vrapon në dhomën e Saidit të ri, të ndershëm e me namus dhe i thotë:

“Secili ka një prijës, e prijësi im je ti!”, - dhe pastaj ia puthë edhe dorën. Pas kësaj ngjarjeje, nderi dhe respekti i prefektit ndaj Saidit dyfishohet.¹⁸

Bediuzzamani vetë thotë këto fjalë:

“Kush e ka lexuar biografinë e jetës sime e di mirë se para pesëdhjetë e pesë vjetëve, duke qenë në moshën njëzet vjeçare, për respektin që kishte ndaj diturisë, me ngulm m’u lut pashai që të banoja në shtëpinë e tij. Aty qëndrova dy vjet dhe ai kishte gjashtë vajza, tre ishin më të vogla, të tjerat më të mëdha.. Të mëdhatë, as për dy vite që qëndrova në shtëpinë e tij, nuk i njoha, se cila ishte e madhja apo e dyta, sepse nuk i shikoja me vëmendje që t’i njoh. Është për t’u habitur se pati ardhur tek unë një mysafir që ishte edhe teolog dhe për dy ditë secilën vajzë mundi t’i dallojë nga njëra-tjetra se cilat janë. Shokët që kisha pranë duke u habitur me këtë gjendje timen, më pyetën:

- Përse nuk i shikon?

I thashë atyre:¹⁹

- Nuk më lejon t’i shikoj nderi i diturisë.”

Para dyzet vjetësh, në një festimin e ermenëve, në Kaðëthane të Stanbollit djathtas e majtas në breg detit ishin ulur mijëra vajza e gra gjysëm lakurike të romëve dhe të ermenëve, Sajjid Taha dhe deputeti Haxhi Iljasi më hipën në një barkë që të shëtisim bashkë pranë atyre femrave,. Unë nuk e dija që ata më kishin marrë me qëllim që të më kontrollojnë mua (më kishin kontrolluar me roje) nëse unë do t’i shikoj ato femra. Ndërsa pas një orë shëtitjeje ata vetë pohuan që më kishin kontrolluar dhe më thanë; “Ne u habitëm prej gjendjes tënde që nuk i shikove fare ato”. Atyre u thashë: Unë nuk i dua gjërat e panevojshme se ato janë shije e qejfe me gjynahe që më në fund më shtyjnë që të pendohem. (Nga jeta e autorit)

...

(PJESA E TRETË E "FJALËS SË
TRIDHJETË E DYTË)

Tema e dytë e "Notës së Dytë"

Përfaqësuesi i mosbesimtarëve, kur mbeti pa rrugëzgjidhje dhe ra i mundur tha:

"Unë kënaqësinë e jetës sime, lumturinë e kësaj bote, përparimin e qytetërimit dhe përsosmërinë e teknikës, e gjeja në vetvete tek mosvlerësimi i jetës tjetër dhe tek mosnjohja e Zotit xh.sh..Kur

adhuroja botën dhe kur ndihesha i lirë duke mos iu përlur kujt dhe kur besoja në aftësinë time, me ndihmën e shejtanit kam tërhequr shumë njerëz pas vetes dhe vazhdoj akoma.

Në emër të Kur'anit them: "O ti njeri i pafat! Ty po të drejtohem! Mos dëgjo përfaqësuesin e rrugaçëve, por po që se e dëgjon atë, atëhere dëmi yt do të jetë aq i madh, sa kur ta mendosh atë, zemra dhe shpirti do të të trishtohen sa nuk bëhet më. Ti ke përpara dy rrugë:

Njëra, ajo që po të tregon përfaqësuesi i mosbesimtarëve; tjetra, është rruga e lumtur që të tregon Kur'ani i Bekuar.

Tani krahasimin e këtyre dy rrugëve veçanërisht e kemi paraqitur tek "Fjalët e Vogla". E ke parë dhe e ke kuptuar, që përsëri ka ardhur rasti, t'i krahasosh dy rrugë të tilla. Rruga e mosbesimit dhe e mëkateve njeriun e dobët dhe të paafat e zhdok, ku është i angazhuar me pesha të rënda dhe të hidhura e të panumërta, që e fundosin krejt. Sepse në qoftë se njeriu nuk e njeh dhe nuk mbështetet në Krijuesin e vet, atëhere ai duke qenë një krijesë e dobët, e pafuqishme ndaj nevojave të panumërta dhe i varfër, si dhe një krijesë që në çdo rast përballohet me momentet e fatkeqësive të pallogaritura, mosbesimi atë e kthen në një kafshë të përkohshme, që vazhdimisht vuan ndarjen nga mirësitë e botës. Ai ndëshkohet dhe më në fund ndahet nga dashamirët dhe të afërmit, dhe atëhere në të vërtetë vetë shkon drejt errësirës së varrit.

Pra mbi këtë fatkeq gjatë jetës së tij mbisundon vetëm një vullnet i vogël, një aftësi e paktë, një moshë e shkurtër, një jetë me brenga dhe një logjikë e shuar. Me këtë jetë të pavlerë ai mundohet të përballojë qëllimet e së ardhmes dhe ngjarjet e hidhura. Mosarritja e qëllimeve që ka, atë e zhdok rëndë, për arsye që dihen dhe ndoshta për një minutë merr fund. Po ky njeri, megjithëse nuk ka aftësi për të mbajtur trupin e vet, merr mbi shpinë dhe mbi kokën e vet, botën gjigande. Akoma pa shkuar në ferr, ai vuan torturën e ferrit (xhehennemit).

Pra nga dehja e pakujdesisë, nuk e ndjejnë këtë dhimbje të tmerrshme dhe këtë torturë pikëluese, vetëm për një kohë të shkurtër. Kur t'i afrohen varrit përnjëherë do të ndjejnë dhimbjen e madhe. Në të vërtetë kush nuk pranon se është rob i All-llahut xh.sh. e quan veten pronë të tij. Kurse në këtë jetë ekzistojnë stuhi të fuqishme. Kush është ai që me këtë vullnet të dobët dhe me këto aftësi të kufizuara, në këtë botë me stuhira do të mund të vazhdojë jetën që vazhdimisht përballohet me armiqtë e panumërt, që fillojnë nga mikrobi i vogël dhe deri tek tërmeti? Ata janë gati ta sulmojnë dhe po që se kësaj gjendje i shton grupet e armiqve dhe hidhërimet e tjera që i shkakton si p.sh. nga imagjinata e vdekjes, ai shqetësohet tmerrshëm dhe atëhere e kupton më mirë se çfarë ndëshkimi e pret mosbesimtarin. Gjendjes së saj të tmerrshme do t'i rreshtojmë akoma vetëdijen, që e ka lidhjen me jetën njerëzore si dhe me të gjithë botën. Ti me këto brenga të tmerrshme duhet të mbështetesh tek një Zot xh.sh., që në të gjithë botën përdor funksionet absolute, si emrat: Alim, Kadir, Rrahim dhe Kerim, që kanë kuptimin: i Ditur, i Fuqishëm, i Mëshirshëm dhe Bujar. Mendimi i tij çdo gjë e konsideron të rastësishme, apo që e ka krijuar natyra. Me këtë besim ti o njeri, nga frika e botës dhe gjendja njerëzore do të zhdokesh vazhdimisht. Hidhërimet e tua po u shton edhe të tjera si tërmetet, stuhitë, sëmundjet ngjitëse, uria, ndarja nga kjo jetë, si dhe ndonjë fatkeqësi tjetër edhe më e madhe, ty do të të zhdokin. Këtyre hidhërimet po t'u shtosh edhe ato që nuk i përmendëm, merre me mend se me çfarë telashesh do të përballohesh.

Tani duhet ta pranosh se ky njeri nuk duhet të të dhimbset, sepse nuk e meriton dhimbshurinë, sepse këtë gjendje të tmerrshme e ka kërkuar vetë. Ky i ngjan atij krahasimit me ata dy personat që kemi treguar në "Fjalën e tetë", kur ranë në pus. Kështu një njeri hyn në një kopësht të bukur, ku ka gostitje të bollshme midis shokëve të dashur, ku zhvillohen lojëra zbavitëse, ekspozohen gjellë të shijshme dhe të shumëllojshme e të lejuara, por nuk kënaqet, dhe shkon e pi verën e ndyrë dhe haram, që e bën pijanec. Në këtë mënyrë ai e imagjion veten në mes të dimrit, në një

vend të ndyrë dhe në mes të egërsirave. Pikërisht ky njeri, do të bërtasë duke u dridhur, por askujt nuk i dhimbset. Sepse dashamirët e tij fisnikë, ai i konsideron egërsira dhe fillon t'i shajë e t'i fyejë. Edhe enët e bukura dhe të vyera i imagjinojnë si copa guri, gjellët i derdh dhe enët i thyen. Kuvendimin dhe librat e bukur me faqet plot kuptim, duke i konsideruar si gjëra të pakuptimta dhe të thjeshta, i shqyen dhe i hedh nën këmbë duke vazhduar më tej. Ky njeri nuk të dhimbset fare, por ndoshta për të do të thuash se e ka merituar një dënim të rreptë. Po kështu edhe dashakeqësia e njeriut që e ka zgjedhur vetë atë, e shtyn të futet në rrugën e mosbesimit, si të dehur dhe rrugaçë të çmendur. I mjeri, nuk po bindet për Mjeshtrin e Ditur që është Zoti xh.sh. i kësaj bote, të cilën e ka krijuar si një vend të gostive të bukura.

Ai duke i imagjinuar se këto qenie janë të rastësishme, apo që ato i ka krijuar natyra, nuk mundet ta kuptojë se të gjitha qeniet janë reflektime ku pasqyrohen të gjitha Emrat e Bukur. Me kalimin e kohës ato e kryejnë detyrën dhe shkojnë në vende të padukshme. Zoti xh.sh. ato i ka dërguar për t'i freskuar dhe çliruar vendin për ato që ka caktuar që më parë. Këtë të vërtetë ky i çmendur nuk po e kupton dhe gjendjen ku ndodhet e quan si një zhdukje dhe shkuarje drejt asgjësë. Të gjithë zërat që janë si një "tesbih" ndaj All-llahut xh.sh. ai i imagjinojnë si zëra të ndarjes dhe pikëllimit. Faqen e botës që është një shkrim dhe qëndisje e "Nakkashit" (Qendistarit) Madhështor, e imagjinojnë sikur është një gjë e thjeshtë dhe e pakuptimtë, bile edhe bulevardin e madh. Kurse varrin që është një rrugë për të shkuar nën Mëshirën e All-llahut xh.sh., e konsideron si një vend të errët ku zhduken krijesat e vetëdijshme. Çastin e vdekjes nuk e konsideron si një shkak dhe një ftesë për t'u takuar me të dashurit e vërtetë, por thotë se të gjitha qeniet e gjalla kanë hyrë në rradhë për t'u ndarë nga dashamirët. Kjo nuk bën gjë tjetër, vetëm se veten e vet e hedh në tortura të dhimbshme. Kështu vlerën e qenieve dhe Emrat e Bukur që janë funksionet e All-llahut xh.sh., i përçmon nëpër gjithësi dhe i mohon. Më poshtë do ta shohësh edhe vetë se ky njeri nuk meriton më mëshirë, por dënim të rreptë.

Tani o ju të paudhë që po udhëtoni nëpër rrugën e rrugaçerisë, përgjigjuni, kush shpëton prej kësaj zhdukje të tmerrshme ku keni rënë të pashpresë? Cila përsosje, cila shkencë, cili përparim dhe cili qytetërim iu shpëton? Kush është ajo natyrë që ju shpëton, cili shkak, cili shok, cila pozitë, cili zbulim i juaj, cili popull, cili kryq që ju adhuron mund t'ju shpëtojë prej vdekjes. Ju e imagjinoni atë sikur është një shkatërrim dhe një errësirë dhe nuk mundeni ta mbyllni portën e shkuarjes për në jetën e varrit, që është rruga e Mah'sherit, gjer tek ura e Siratit. Për shpirtin e njeriut që nevojiten me të vërtetë shpresa të sigurt nuk mund t'i gjeni tek ato që ju u besoni shumë, tek Artet që ato janë Mirësitë e Zotit xh.sh.. Pra në qoftë se nuk mundeni të mbyllni dot derën e varrit, patjetër nëpër të do të kaloni. Udhëtari i këtyre rrugëve mund të kalojë me lehtësi nëpër të, vetëm kur të mbështetet në një Fuqi të plotë, ku Sundimi i Tij është i aftë, të tejkalojë tej e tej rrathët madhështorë.

O njerëz të pakujdesshëm, ju po ecni nëpër rrugën e mosbesimtarëve, ngaqë nuk e dini këtë thënie: "Përfundimi i dashamirësisë së pavend është vuajtje e torturës së pamëshirshmërisë". Ju me atë dëshirë që ju ka dhënë All-llahu xh.sh., t'i doni Funksionet e Emrave të Bukur dhe aftësinë që ta njihni Atë, sepse organet e adhurimit e të falenderimit po i shpenzoni nëpër dëshira dhe vese epshore. Po që se e adhuron këtë botë,

patjetër do të vuani edhe ndëshkimet e saja, sepse në vend që të doni Zotin xh.sh., ju doni veset e nefsit. Atij nuk po ia jepni dashamirësinë e vërtetë dhe nuk po mbështeteni tek Pronari i Vërtetë. Në këtë mënyrë gjithmonë do të hidhërohëni. Në vend që dashurinë tuaj t'ia kushtoni funksioneve të Emrave të Bukur, ju ia kushtuat kësaj bote. Veprat dhe Artet e Tija ia dedikuat shkaqeve të panumërta. Disa prej tyre që keni dashur shumë duke ua kthyer shpinën juve, po ikën pa e kthyer kokën dhe pa iu thënë "mirupafshim!" Disa prej tyre nuk ju njohin, por edhe ata

që ju njohin, nuk iu duan që edhe sikur t'iu duan nuk ju bëjnë dobi. Vazhdimisht pa shpresë do të vuani ndëshkimin e ndarjes, sepse me mosbesimin tuaj mendoni se i vdekuri kurrë nuk ringjallet. Kjo është edhe arsyeja që shpesh torturoheni, ngaqë mendoni se dashamirët largohen njëherë e përgjithmonë.

A e pe brendësinë e mosbesimtarëve që thonë se përsosmëria e njerëzimit, bukuria e qytetërimit dhe shijet e kënaqësisë, janë mbi gjithçka. Dëfrimet dhe dehja janë si një perde e përkohshme, për të mos e ndjerë dhimbjen e gjendjes së tyre. Thuaju "tuh!" mendjeve të tyre prej maskarenjsh.

Por bulevardi i gjerë i rrugës së Kur'anit të Ndritur, me të vërtetat e besimit, ia shëron plagët nga të cilat vuajnë rrugaçët e mosbesimit. Të gjitha errësitat që të kanë mbyllur në rrugën e keqe, i shpërndan dhe i shndërron në dritë, të gjitha dyert e shkatërrimit prapësive i mbyllë.

Kështu dobësitë, pafuqishmëritë, varfëritë dhe të gjitha nevojat e njeriut, shërohen atëhere kur ai mbështetet tek i Plotfuqishmi Mëshirëplotë dhe barrën e jetës dhe të trupit e mbështet tek Fuqia dhe Mëshira e Tij. Atëhere shpirti nën peshën e jetës nuk zhduket por e lartëson atë, duke gjetur një pozicion të lehtë. Edhe vetë e kupton se njeriu nuk është ashtu siç thojnë filozofët materialistë, një kafshë që flet, por një mysafir i të Gjithëmëshirshmit. Duhet ta pranosh se ti në këtë botë je një mysafir i All-llahut xh.sh., ashtu si dhe të gjitha qeniet që janë një pasqyrë e Emrave të Bukur, si dhe Artet e qendisura kaq bukur, që janë Mesazhe dhe Letra Hyjnore që freskohen vazhdimisht. Kjo pikëpamje dhe ky mendim ia shëron plagët njeriut dhe e shpëton nga shqetësimi se çdo gjë zhduket, si dhe nga ankthi i ndarjes. Besimi e shpëton edhe nga lidhja me sendet e përkohshme dhe nga errësira e imagjinatës së turbullt. Vdekjen dhe fundin e jetës (exhelin) i sheh si një mjet që do ta dërgojë në një sallon pritje dhe si një fillim për t'u takuar me dashamirët e panumërt. Mosbesimtarët vdekjen e konsiderojnë si një gjë të tmerrshme, që të ndan nga të dashurit e shumtë. A e pe se si besimi ndarjen e

shndërron në një takim, duke e shëruar këtë plagë të tmerrshme? Më mirë nuk ka se si bëhet. Ai shumë qartë vërteton se varri është një dritë për të soditur vreshtat e parajsës (xhennetit) dhe vilat e lumturisë së përjetshme. Me këtë të vërtetë e mjekon problemin më të madh të njerëzimit për jetën e varrit, që nën vështirimin e të pabesëve duket si një trishtim i madh. Në të vërtetë atë e kthen në një udhëtim gazmor, duke treguar se varri nuk është goja e dragoit, por një derë për të hyrë në vreshtat e bukura.

Besimi në fenë Islame i thotë besimtarit : "Meqenëse e ke vullnetin të paktë, punët e tua lëri në vullnetin e fortë të All-llahut xh.sh.. Meqenëse e ke aftësinë të kufizuar, beso në Fuqinë e Fuqiploetit Absolut. Meqenëse e ke jetën të shkurtër, mendo se do të shkosh në një jetë të pafundme. Pra për asgjë mos u shqetëso! Meqenëse e ke logjikën të shkurtër, hyr nën Diellin e Kur'anit. Shiko me Dritën e Besimit se atëhere mendimet e tua që janë si një insekt ndriçues, secili ajet i Tij do t'i shndrisë si yje të vërtetë. Meqenëse ke shumë brenga dhe mendime të turbullta, mos u bë i pashpresë, se ty të presin sevape të panumërta dhe një mëshirë e pafundme. Po qe se ke

qëllime të pafundme, duke i kujtuar ato mos u dëshpëro, se kjo botë ato nuk mund t'i konceptojë dot. Këto qëllime dhe dëshira do të plotësohen në një vend tjetër. Ti vetë ato nuk mund t'i realizosh, por dikush tjetër i plotëson".

Besimi vazhdon akoma duke na dhënë këshilla:

"O njeri! Ti nuk je pronari i vetvetes. Pronar është Ai që Fuqia dhe Mëshira e të Cilit është e Paskajshme. Pra mos e merr

barrën e jetës tënde mbi vete, se më pas do të torturohesh. Këtë jetë Ai ta ka dhënë dhe beso se po të kursen shumë mirë. Përse nuk bindesh që kjo botë nuk është pa Zot dhe mundohesh që

barrën e botës ta vendosësh përmbi kokë. Mos u merakos kot dhe mos mendo vetëm gjëra të frikshme. Mos kështu, se Zoti i kësaj bote është aq i Ditur, sa që në secilën vepër preferon anët më të dobishme. Meqë ti je mysafir, mos u përzie se i ngatërron më keq".

Akoma vazhdon duke thënë se:

"Njerëzit nuk janë kokë bosh si kafshët, pa dyshim që janë nëpunës me detyra të rëndësishme dhe lëvizin nën kontrollin e Mëshirëplotit të Gjithëdijshtëm. Pra duke menduar vështirësitë e kësaj bote, shpirtin tënd mos e hidhëro dhe mëshirën tënde mos e prefero para Mëshirës së Zotit xh.sh.. Beso se frerin e armiqve të panumërt, që nga mikrobi i padukshëm deri tek murtaja, stuhija, apo tërmeti e ka në dorë i Gjithëpushtetshmi. Ai është "Hakim", që vepron me një dituri të pastër dhe që në secilën vepër parapëlqen dobinë, se është i Plotmëshirshëm. Mëshira e Tij nuk sosit kurrë. Po të vësh re, në secilën punë do të shohësh një lloj Mëshire".

"Në të vërtetë kjo botë është e përkohshme, por këtu prodhohet materiali i nevojshëm për në jetën e përjetshme. Është kalimtare, por në të arrihen frutat e përshtatshme për në jetën tjetër dhe këtu pasqyrohen Emrat e Bukur të Zotit xh.sh. të Përjetshëm. Kjo jetë në të vërtetë të hidhëron shumë dhe të shijon pak, por kur kujton Mëshirën e Tij që po ta dhuron Një Mëshirëplotë i Gjithmëshirshëm, atëhere ngopesh me këto shije të vërteta. Bile edhe për hidhërimet që nuk i ke merituar fiton sevape të ëmbla. Pra rrethi i gjërave "hallall" i të gjithë qejfeve, shijimeve, kënaqësive të zemrës dhe të shpirtit të mjaftojnë. Mos hy në vende të palejuara sepse në to shpesh herë një shije e vetme të sjellë mijëra shqetësime dhe të bëhet shkak që ta humbësh shijen e vërtetë të Dhuratave të të Gjithmëshirshmit".

Me këto tregime e kuptuat shumë mirë se për çfarë arsyeje rruga e mosbesimit njeriun e hedh në poshtërim të thellë, që është edhe problemi më i mprehtë i racës njerëzore. Prej këtij pusi njeriun asnjë qytetërim, asnjë filozofi dhe asnjë përparim njerëzor nuk mund ta shpëtojë. Me tregimet e Kur'anit të Bekuar, duhet të bindesh se kush beson dhe bën punë të mira, jo vetëm që shpëton prej pusit të thellë që përmendëm, por edhe ngrihet në lartësinë e lartësive. Këto çështje me argumente të thella Kur'ani i vërteton kur thotë se, njeriu shpëton nga ky pus i thellë, me anë të shkallëve të përparimit qytetar dhe të shkencave, me një kusht të vetëm duke e pajisur shpirtin dhe zemrën me ndjenja shpirtërore.

Besimi ia lehtëson rrugën e largët të përjetshme njeriut, sepse medoemos ka për të udhëtuar në mes të stuhive. Atij ia tregon mënyrën për të kaluar rrugën e njëmijë apo të pesëdhjetëmijë vjetëve, për një ditë.

Kur'ani i Bekuar i njofton njeriut Sulltanin e Pafillimtë dhe të Pambarimtë dhe e bën atë ndaj Tij një rob të ndershëm dhe një nëpunës të bindur. Kështu që njeriu në bujtinën e kësaj bote i beson All-llahut xh.sh., udhëtimin e jetës së varrit dhe të asaj të përjetshme, do t'i kalojë me kënaqësi të zemrës, meqë detyrat i ka plotësuar, si një nëpunës i bindur i një mbreti, prandaj ky njeri në të gjitha rrethinat e atdheut, brenda kufijve të tij, me të gjitha mjetet e udhëtimit të atij vendi, aeroplan, anije dhe tren, shëtit pa kurrfarë pengese. Po kështu edhe ai njeri që i bindet Sulltanit të Pafillimtë dhe i nënshtrohet duke zbatuar urdhërat që ka dhënë Ai, megjithë kënaqësitë e kësaj jete dhe jetën e varrit, në të gjitha udhëtimet brenda kufijve të Mah'sherit, pra pas varrit në të gjitha vendet e gjera, udhëton duke shkuar në lumturinë e përjetshme me shpejtësinë e rufesë dhe të "burakut" (Pejgamberi a.s. me të ka shkuar në miraxh). Këtë të vërtetë Kur'ani ua tregon besimtarëve dhe njerëzve të shenjtë e të devotshëm, duke ua vërtetuar me dokumente të forta. Përsëri të vërtetat e Kur'anit, besimtarëve u thonë: "O ju besimtarë! Aftësinë e dashurisë që iu ka dhuruar All-llahu xh.sh., mos e shpenzoni në vende të ndyra, të mangëta dhe të dëmshme, që nuk të sjellin fare dobi! Mos shko në rrugën e nefsit të pakultivuar që të imponon vetëm të këqija! Ato mos i prano si të dashur dhe mos adhuro veset e këqija! Ndoshta ti e ke aftësinë e një

dashurie të pafundme, prandaj duhet ta shpenzosh për Atë! Ai e ka merituar me të vërtetë një dashuri të pafundme, sepse ty të ka kompletuar me mirësi të shumëllojshme. Në të ardhmen do të të kënaqë me lumturi të pafundme... jo vetëm ty, por edhe të tjerët, pra dashamirët e tu besnikë sepse edhe nga kënaqësia e tyre do të ndiesh të njëjtën kënaqësi. Sepse Ai është në shkallën më të lartë të përsosmërisë dhe pafundësisht është i Patëmeta, i Lartësuar, i Pastër, i Pagabueshëm dhe zotëron një Bukuri që kurrë nuk zhduket. Të gjithë Emrat e Bukur (Esmā ul Husnā), janë në shkallën e pafundme të bukurisë dhe në secilin prej tyre gjendet Drita e Bukurisë. Parajsa (xhenneti) me të gjitha bukuritë dhe mirësitë, tregon vetëm një shkëlqim të Bukurisë së Tij të mëshirshme. Të gjitha bukuritë, hijeshitë dhe bamirësitë e kësaj gjithësie të shtyjnë ta duash dhe janë shenja e dëshmi të Një të Bukuri të Rrallë dhe të Përsosur. Kështu Një i Tillë, Madhështia e të Cilit nuk mund të tregohet sepse është në një gradë të lartë e të papërcaktuar, të bën ta duash dhe ndaj të gjitha dashamirëve, ta preferosh Atë. Adhuroje pa gabime Atë!"

Mesazhi i Kur'anit vazhdon duke thënë:

"O njeri! Mos shpenzo aftësinë e dashurisë në vende të padobishme dhe në qenie të përkohshme, sepse ajo dashamirësia jote i takon vetëm funksioneve të Emrave të Bukur, shkëlqimet e të cilave duken në Artet e qendisura dhe në krijesat e Tij! Ato janë të përvetshme dhe të vazhdueshme. Beso se në secilin funksion të Emrave të Bukur ekzistojnë mijëra shkallë të bamirësisë dhe Bukurisë së Tij, si dhe mijëra gradë të përsosmërisë dhe dashamirësisë së Tij! Ti kujdesu vetëm për Emrin e Gjithmëshirshëm, që tregon se Parajsa (xhenneti) është një shkëlqim i këtij emri dhe lumturia e përvetshme një rreze e këtij emri. Gjithashtu në këtë botë që jetojmë, të gjitha bamirësitë dhe ushqimet janë një pikë e këtij emri".

Tani kujdes me ajetin: 25)

"Vërtetë Ne krijuam njerin në formën më të bukur. Pastaj e zbritëm atë në më të ultin e të ultëve. Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira."

Ky është një drejtpeshim që tregon kulmin e besimtarëve. Ajeti që vjen tregon rezultatin e përfundimit të jetës së njerëzve. Po ta vini re ajetit tjetër, thotë se: 20)

"Përmbi ta nuk qajnë as qiejt dhe as toka"

Mrekullia Kur'anore u vë vulën tregimeve tona që po krahasojmë deri tani, pra besimtarët dhe mosbesimtarët.

Të vërtetat e mrekullisë dhe të gojtarisë së ajetit të parë i kemi sqaruar gjerësisht në "Fjalën e njëmbëdhjetë" dhe kujt i intereson le t'i studjojë.

Këtu do të analizojmë vetëm disa pika të veçanta të ajetit të dytë që të sqarohet kuptimi i kësaj shprehje të lartë:

Kështu: Ky ajet me një kuptim të qartë thotë: "Kur vdesin mosbesimtarët, mbi ta toka dhe qiejt nuk qajnë". Mosbesimtarët i mohojnë detyrat e tokës dhe të qiejve, duke mos e ditur kuptimin e tyre i poshtërojnë dhe ua zbresin vlerat e tyre reale. Nuk e njohin mjeshtërinë e tyre dhe ndaj qenieve marrin pozicionin e armikut. Sigurisht për mosbesimtarët toka dhe qiejt jo vetëm të qajnë, por meqenëse kanë kundërshtuar Krijuesin i mallkojnë ato, dhe gëzohen kur të ngordhin.

Në kuptimin e kundërt ky ajet thotë: "Kur vdesin besimtarët, toka dhe qiejt qajnë, sepse besimtari që ka vdekur i ka ditur detyrat, e ka vërtetuar rëndësinë e tyre dhe ka besuar se ato shprehin një domethënie, duke u thënë: "Sa bukur i ka krijuar Zoti dhe sa mirë shërbejnë nën urdhërin e Tij!" Në këtë mënyrë i kanë vlerësuar ato në shkallën e duhur në llogari të All-llahut xh.sh. dhe për dashurinë e Emrave të Bukur që pasqyrohen në Të. Nga ky sekret theksohet se kur vdesin besimtarët, tokën dhe qiejt i mbulon hidhërimi dhe ngashërehen.

Një pyetje e rëndësishme

Po thoni se dashuria nuk varet nga vullneti. Nga nevojat që kam i dua ushqimet e nevojshme dhe frutat e shijshme. Nënë, babain dhe fëmijët i dua. Gruan time e dua. Miqtë dhe dashamirët i dua. Pejgamberët dhe njerëzit e shenjtë (evlijatë) i dua. Jetën dhe rininë time e dua. Pranverën dhe sendet e bukura i dua. Si ka mundësi të mos i dua të gjitha këto? Po si i bëhet që të gjitha t'i dua për hir të All-llahut xh.sh. dhe për funksionet e Emrave të Bukur? Kjo çfarë domethënie përmban? Kërkoj sqarimin e tyre.

Përgjigje: Lexo këto katër pika!

E para: Megjithëse dashurinë nuk mund ta frenosh, pra nuk e ke në dorën tënde, të paktën vullnetin dhe fytyrën e dashamirësisë ktheje nga njëri tek tjetri.

Përshebull: Duke treguar fytyrën e shëmtuar të një dashamirësi, apo duke treguar fytyrën dashamirë të vërtetë, që pasqyrohet në një fytyrë tjetër, duke ia hequr perden, që e ka penguar pamjen e fytyrës së vërtetë, kjo fytyrë artificiale do të kthehet në reale.

E dyta: Edhe pse nuk i njeh dashamirësit, nuk po të them të mos i duash, por të them që t'i duash për llogari të All-llahut xh.sh. dhe për hatër të të Dashurit të Vërtetë.

Përshebull: Ushqimet e shijshme dhe frutat e ëmbla t'i duash se ato janë dhurata dhe bamirësi të të Gjithmëshirshmit Mëshirëplotë, sepse atëhere ti do të duash Emrat e të Gjithëpushtetshmit dhe Bamirësit. Ky veprim mban vulën e një falenderimi shpirtëror. Kjo dashamirësi nuk është në llogari të nefsit, por në atë të të Gjithmëshirshmit, gjë që del në shesh kur ato i fiton me djersë dhe me lejen e Zotit xh.sh., duke iu bindur Furnizuesit. Kur i ha duke kujtuar se si dhe kush i ka krijuar, të bësh falenderimin ndaj Tij.

Babain dhe nënën duaje, duke kujtuar se kush e ka dhënë atë mëshirë në duart e tyre për të të edukuar ty, atëhere ti do të duash më shumë Atë Dashamirës, që ua ka dhënë atyre këto cilësi. Pra kjo dashuri do të shkojë drejt Zotit xh.sh.. Drejtpeshimi i asaj që ke dashur për All-llahun xh.sh., del në shesh atëhere kur dihet që edhe kur plaken, ti ata i do edhe më shumë, kur e di që prej tyre nuk ke kurrfarë dobie dhe je i braktisur në vështirësi. Në këtë rast ke nderuar prindërit, pa u nisur nga gjendja e tyre fizike, por vetëm e vetëm për hir të Zotit xh.sh.. Më pas ky ajet na tregon se: ajet.....51

21)

“Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, e ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëhere mos u thuaj atyre «of-oh»”.

Në pesë shkallë e fton të nderojë prindërit. Këtu kuptohet nga pikpamja e Kur'anit, se sa është e rëndësishme vlerësimi i prindërve. Përkundrazi një dëm shumë i madh do të shkaktohej në qoftë se fëmija nuk do t'i përballonte me të mirë të gjitha të drejtat e prindërve. Me që ata dëshirojnë t'i shohin fëmijët e tyre më mirë se veten, përballë kësaj sakrifice fëmija kurrë nuk duhet të ngrejë padi se i ka mbetur pa plotësuar diçka nga prindi dhe se midis babait dhe fëmijëve nuk ka asnjë arsye që të bëhen debate. Arsyet e vërteta të debatit janë xhelozia dhe lakmia, të cilat asnjë baba ato nuk i ushqen kurrë ndaj fëmijës së tij. Këto mosmarrëveshje në përgjithësi vijnë nga mosnjohja e të drejtave të njëri-tjetrit. Fëmijës tek prindërit nuk i ka ngelur asnjë e drejtë pa u plotësuar që ta kërkojë atë më pas. Edhe sikur fëmija të shohë një padrejtësi tek babai i vet, nuk ka të drejtë të ngrejë krye kundër tij.

Domethënë: Kur kundërshton apo ndëshkon babain, ky fëmijë është një egërsirë, që ka marrur formën e njeriut.

Tani është momenti që të tregojmë se si ta duam fëmijën. Atë duhet ta duam sepse ai është një

dhuratë e të Plotfuqishmit Bujar me mëshirë, kështu që kësaj dhurate duhet t'i afrohesh, ta duash, ta mbrosh dhe në këtë rast kjo dashuri të shprehet për All-llahun xh.sh.. Me këtë veprim ti ke treguar se këtë fëmijë e ke dashur për llogari të Tij. Kur fëmija vdes, ti duron dhe falenderon All-llahun xh.sh. dhe nuk bërtet i pikëlluar. Ty të takon të thuash se Krijuesi m'i dërgoi këto krijesa të dashura për t'i mbikqyrur, por unë nuk mund t'u dal zot sepse kjo është punë e Tij. Dija e Tij e Gjithanshme, kështu e ka parapëlqyer dhe prandaj e mori për ta çuar në një vend më të mirë.

Duhet të themi se po qe se tek kjo krijesë në dukje ne kemi një pjesë, njëmijë pjesë të vërteta janë të Tijat. Duke iu bindur Atij, duhet ta falenderojmë me gjithë zemër.

I erdhi rradha shokëve dhe dashamirëve: Po qe se ata besojnë në fenë Islame dhe i nënshtrohen All-llahut xh.sh., atëhere ata janë edhe dashamirët e Tij. Me sekretin e kësaj Fjale të Bukur që thotë: "Duaj për All-llahun xh.sh."; kjo dashuri në të vërtetë është treguar për Atë.

Bashkëshorten nuk duhet ta duash vetëm për llogari të nefsit, por duhet ta dish që duhet dashur për shkak se ajo është një dhuratë e butë dhe nazike e Mëshirës Hyjnore. Nuk duhet ta vendosësh dashurinë vetëm në kohën e rinisë dhe të bukurisë që së shpejti do të kalojnë, por duhet të mos harrosh se bukuria më e përkryer dhe më e ëmbël e gruas është atëhere kur ajo ruan bukurinë shpirtërore, që është një dukuri e veçantë e grave. Ajo ka këto cilësi të vyera si; nazet, moralin, nderin, mëshirën, seriozitetin dhe buzëqeshjen ndaj burrit dhe të afërmeve të lejuar. Sidomos kur ajo mban mendime të larta për jetën e amshuar. Duke lulëzuar këto bukuri të mëshirës bëjnë të vazhdojë edhe bukuria shpirtërore deri në fund të jetës. Burri që e ka pikësynimin e dashurisë pikërisht tek këto cilësi, do të dijë se si t'i shpërblejë detyrimet ndaj kësaj krijese të dobët dhe të bukur. Sidomos kur i humbet bukuria fizike, ajo ka më shumë nevojë që burri t'i dalë zot.

Përndryshe i humbasin të drejtat e saja.

Po qe se i duam pejgamberët dhe të gjithë njerëzit e shenjtë, duhet të duhen për arsye se janë dashamirët e All-llahut xh.sh.. Kjo dashuri duhet të ekzistojë jo për gjë tjetër, por për hir të All-llahut xh.sh., sepse ato janë dashamirët e Tij.

Jetën duhet ta duash por ajo nuk është e jotja. Atë ta ka dhënë Zoti xh.sh., si një kapital kryesor dhe si një thesar, për të fituar një jetë të përjetshme. Ai e ka pajisur njeriun me shumë mjete që të bëjë dobi dhe të përsoset vazhdimisht. Me këto mendime duhet ta duash jetën dhe ta vësh në shërbim të All-llahut xh.sh. dhe të fesë Islame, që ta shpenzosh në dobi të tyre dhe atëhere kjo dashuri ka gjetur vendin e duhur.

Të duash rininë duke e pranuar si një dhuratë të bukur të All-llahut xh.sh.. Duke e vlerësuar nga kjo pikëpamje, ta shfrytëzosh në vende të mira dhe të lejuara . Kjo quhet një dashuri dhe falanderim i natyrshëm.

Dashuria për pranverën, merr kuptim më të plotë kur atë e pranon si një qendrisje antike të Mjeshtrit të Madh, si dhe një art të hijeshuar të bukurisë së Zotit të Nditur. Kjo do të thotë se Emrat e All-llahut xh.sh. i ke dashur në vendin e duhur.

Botën ta duash se është një Arë e "Ahiretit" (Jetës së Mbrapme) dhe një pasqyrë e madhe e Emrave të Bukur të Zotit xh.sh., si dhe një vend miqsh të përkohshëm. Po qe se në këtë dashuri nuk përzihet nefsi, ajo shkon në llogari të All-llahut xh.sh..

Shkurtimisht: Botën dhe të gjitha qeniet duaji në llogari dhe në Emër të Krijuesit të tyre dhe jo në llogari dhe emër të vetë qenieve. Thuaj: "Sa mirë e ka krijuar atë Krijuesi!" dhe mos thuaj: "Sa e mirë që është!" Në brendësinë e zemrës tënde mos lejo të hyjë tjetër dashamirësi përveç Zotit xh.sh.. Brendësia e zemrës është pasqyra e Gjithëdrejtuesit dhe i takon vetëm Atij. Thuaj:

“O Zot! sjellna që të duam Ty dhe ato që na afrojnë tek Ti!”

Të gjitha ato dashuri që njohëm deri tani po qe se shfaqen në formën që thamë, do të fitojnë një shije të ëmbël dhe pa hidhërimi. Kjo është një arritje drejt një qëllimi pa pasur fare zhdukje, që shton dashamirësinë e All-llahut xh.sh.. Është një dashuri normale, që pritët nga njeriu, sepse Zoti xh.sh. e ka kërkuar atë për t'i shprehur në këtë mënyrë falenderimet e zjarrra dhe mendimet e lumtura.

Për shembull: Po qe se një mbret i famshëm ty të falë një mollë (1), në të ka dy lloje shijesh.

Dashuria ndaj saj ndahet në dy pjesë;

E para: Është për vetë vlerën e mollës, prandaj e do atë, por kjo shije nuk ka lidhje fare me mbretin, sepse ti kur ke ngrënë mollën nuk e ke kujtuar fare atë, por shijen e saj. Kjo gjendje nuk i ka pëlqyer mbretit dhe është mërziur prej teje sepse shija e mollës do të jetë e pakët dhe e përkohshme. Ajo vazhdon gjerë sa të soset molla dhe jo më tepër, kurse për ty fillon mjerimi kur mendon se ke hidhëruar mbretin.

E dyta: Shija e dytë e mollës ka vlera në atë se duke e ngrënë atë mendon se kjo mollë nuk i përngjan asnjë tjetre, sepse është dhurata e mbretit dhe duhet respektuar përmbi kokë. Në këtë situatë ky njeri përballë atij që thamë më parë, e do mbretin dhe e kujton atë, kur ha mollën, që në këtë rast ka një shije të veçantë, saqë njëmijë të tjera së bashku nuk do të krahasoheshin me të. Ky shijim është një falenderim i pastër dhe tregon respekt dhe dashuri ndaj Mbretit.

Njëllor si ky shembull, po qe se të gjitha frutat dhe mirësitë i do për bukurinë dhe shijen e tyre dhe në mënyrë të pakujdesme i ha vetëm e vetëm për të shijuar vlerat e tyre materiale, kjo ngrënie dhe ky shijim shkon në llogari të nefsit. Duhet ta dish se këto shije mbajnë në vetvete hidhërimi dhe janë të përkohshme. Po qe se këto fruta dhe dhurata i pranon si të dhuruara nga Krijuesi i Gjithësisë dhe Barmësi i Mëshirshëm duke i vlerësuar dhe menduar se ato janë mrekulli Hyjnore, atëherë shijimi i tyre nuk ka hidhërim, përkundrazi një shije aq të mirë sa që me të gjitha shqisat duhet t'i shprehësh falenderimin.

E treta: Dashuria ndaj Emrave të All-llahut xh.sh. është shkallë-shkallë. Siç treguam edhe më parë, nganjëherë duke pasur edhe dashamirësinë ndaj veprave të Tijë edhe Atë vetë e do.

Nganjëherë ato i do sepse janë tituj të Përsosmërisë Hyjnore. Nganjëherë njeriu vëmendjen e vet e kthen nga gjerësia e nevojave të panumërta që ka dhe duke ia atribuar ato Emrave të Bukur, ndjen dashamirësi për Ta. Pra ky i do Ato nga nevoja.

Shembull: Ti kur i mëshiron të gjithë të afërmit e tu, fukarenjtë, të dobët dhe nevojtarët, nuk ke vetë asgjë në dorë për t'u ndihmuar atyre dhe në moment del një njeri që i përballon nevojat e tyre. Fisnikëria e këtij personi a mund të tregohet se sa të gëzon ty. Këtë person jo për vetveten, se sa për ato cilësi të bukura fisnikërie dhe bujarie që ka, duhet ta duash.

Po njëllor: Ti vetëm nga Emrat e Zotit xh.sh. që janë këta dy, i Gjithëmëshirshëm dhe i Plotmëshirshëm, mendo që ke dashur dhe ke ndjerë mëshirë për të gjithë besimtarët, gjyshërit dhe dashamirët, të cilët All-llahu xh.sh. i ka kënaqur me të gjitha të mirat e kësaj bote. Kurse Ai do t'i kënaqë edhe në xhennetin e bukur, me ata Emra të Bukur, me të gjitha shijet e pakursyera dhe me lumturinë e pafundme. Me Emrat, i Gjithëmëshirshëm dhe i Plotmëshirshëm, All-llahu xh.sh., do të të kënaqë me tepër se sa e meriton me një dashamirësi të zjarrrë. Këtë gjë mund ta krahasosh edhe vetë, se sa nevojë kanë shpirtërat e njerëzve për këta dy Emra dhe se sa është me vend kjo fjalë fisnike që thotë: "Elhamdulillah ala Rrahmanijjetihî ve ala Rrahimijjetihî", që duhet kuptuar: "Falenderojmë All-llahun xh.sh. për Emrat i Gjithëmëshirshëm dhe i Plotmëshirshëm!" Ai vazhdon akoma: "Për këtë botë që konsiderohet si një lloj shtëpie e jotja, ti hidhërohesh nga shkatërrimet që i bëhen asaj, si dhe gëzohesh nga gëzimet që ndjejnë krijesat e gjalla. Me të gjitha shqisat ty të lumturojnë bukuritë dhe lumturitë e kësaj bote, sepse

janë qendrisur me lloj-lloj bimësh dhe krijesash, që i ka krijuar dhe edukuar me Diturinë e Tij të Kulluar Një i Gjithëditur dhe Edukator. Po qe se mendon se sa nevojë ka shpirti yt për Ta, atëherë do ta kuptosh kur vëren me vëmendje se me sa kujdes ke për t'i dashur ata, Emrat e Bukur. Të gjithë njerëzit që je interesuar dhe je hidhëruar në çastin e vdekjes nga zhdukja e tyre, Ai i ka çuar në një vend shumë më të mirë se sa kjo botë. Këtë nuk e bën tjetërkush, përveçse Një All-llah xh.sh., që zotëron tituj si Baki, Kerim, Muhji dhe Muhsin, që do të thonë, i Përvetshëm, Bujar, i Gjithëngjallshëm dhe Bamirës.

Kështu kuptove se njeriu ka nevojë për këta Tituj të All-llahut xh.sh. sepse funksionojnë në interes të lumturisë së njeriut. Dhe se për të përballuar nevoja të panumërta, ky njeri si një krijesë e veçantë dhe me cilësi të larta, ka nevojë për ndihmën e Emrave të All-llahut xh.sh. dhe për shumë shkallë të Emrave, i Gjithëmëshirshëm dhe i Plotmëshirshëm. Kur shumëfishohen nevojat lind një dashuri e zjarrtë, por kur shumëfishohet kjo dëshirë, atëherë lind një dashuri e thellë. Pra kuptove shkallët e përsosmërisë që me devotshmërinë e njeriut ndaj Emrave të Bukur, zgjidhin nyjet që pengojnë dashamirësinë ndaj Tyre. Atëherë dashamirësia ndaj të gjithë Emrave të Bukur do të kthehet tek kroi i Tyre, All-llahu xh.sh.. Për ta ilustruar këtë, prej njëmijë e një Emrave të All-llahut xh.sh. po japim një shembull: Përsëri prej njëmijë e një shkallëve të Emrave, Ad'l, Hakem, Hak dhe Rrahim (i Drejtë, Gjykatës, i Vërtetë dhe Mëshirëplotë), do të tregojmë vetëm një shkallë të tyre. Brenda Drejtësisë dhe Diturisë së Kulluar të Zotit xh.sh., (që i përket vetëm Atij) po qe se do të njohësh Emrat, i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë dhe i Vërtetë, lexo këtë shembull:

Supozojmë se kemi një ushtri të përbërë nga katërqind kompani të ndryshme. Secila kompani e do ushqimin veç, që ta përdorë me lehtësi armën e vet, bile secili ka nevojë edhe për njëlloj ilaçi të veçantë. Por të gjitha këto kërkesa të ndryshme, është e vështirë të realizohen për të katërqind kompanitë dhe ekipet e

shumëllojshme. Vetëm një mbret i mëshirshëm me aftësitë e tija të përkryera dhe me një dituri të mrekullueshme si specialist dhe me një drejtësi të jashtëzakonshme, pa ndihmën e askujt, pa u habitur fare, secilit i jep atë që i takon, si veshjet dhe ushqimet, ilaçet, armën, etj.. Dhe ec e mos u çudit, se me çfarë aftësie, drejtësie dhe fisnikërie, i ka krijuar këto punë ky mbret i mrekullueshëm! Po qe se në një batalion do të gjenden sikur edhe dhjetë individë të nacionaliteteve të ndryshme, është i pamundur pajimi i përshtatshëm i tyre sipas traditave dhe veshjeve kombëtare, meqenëse nuk është e lehtë pajimi njëlloj. Po kështu, po qe se brenda konceptit të Drejtësisë dhe Diturisë së Pastër të shkëlqimit të Emrave të Bukur, Hak dhe Rrahmanurr-rrahim (i Drejtë dhe i Plotmëshirshëm - Mëshirëplotë), do ta shikosh stinën e pranverës dhe do të vëresh se sipërfaqja e tokës, si ajo e ushtrisë, është ekspozuar me kafshë dhe me katërqind mijë krijesa të shumëllojshme. Të gjitha këto grupe duke qenë brenda njëri-tjetrit, përsëri midis tyre kanë dallime esenciale, sepse u ka dhënë petka të veçanta, ushqime të ndryshme, armë të veçanta, kushte të jetesës dhe ushtrime të ndryshme. Lirimin dhe obligimin ua ka dhënë në kohë të veçanta dhe asnjëra prej tyre nuk ka aftësi për t'i siguruar vetë konditat e jetesës. Ato nuk kanë gjuhë për të kërkuar nevojat e veta me një drejtësi dhe dituri të përkryer. Me një ekuilibër të shkëlqyer Titujt dhe Funksionet e All-llahut xh.sh., Hak (i Drejti), Rrahman (i Gjithëmëshirshëm), Rrezak (Furnizues), Rrahim (Mëshirëplotë) dhe Kerim (Fisnik), pa asnjë gabim, pa i përzier me njëri-tjetrin, i rregullon dhe i kursen këta individë dhe këto vepra që s'janë katërqind, por katërqindmijë llojesh të ndryshme! Tani si ta merr mendja në këtë sipërfaqe të gjerë, që bëhen me rregull kaq preçiz këto punë të mëdha, kush përveç All-llahut xh.sh. do të kishte mundësi t'i bënte? Përveç Zotit që është Një, përveç Sundimtarit Absolut, përveç Atij, Fuqia e të Cilit arrin kudo, në të gjitha Edukimet e Tija të Matura, a ka mundësi dikush të zgjasë

dorën?

Pika e katërt: Ti më pyet: Po qe se unë që të gjitha; nefsin tim, ushqimet e mia, gruan time, prindërit e mi, fëmijët, dashamirët, njerëzit e shenjtë, profetët, gjërat e bukura, pranverën dhe botën, sipas urdhërave të Kur'anit i dua, në fund të fundit, me çfarë dobish do të shpërblehem?

Përgjigje: Për të rreshtuar të gjitha dobitë e këtij veprimi, mbushet një libër i madh, por në mënyrë të përmledhur do të shënoj një ose dy përfundime:

Së pari do të parashtroj përfundimet që merren si parapagesë në këtë botë.

Kështu siç e kam treguar edhe më parë, ato dashamirësi që bëhen në llogari të kësaj bote dhe të nefsit tënd, përfundojnë me shumë vështirësi dhe ngatërresa. Veç kësaj edhe kënaqësitë dhe lehtësirat i kanë shumë të pakta.

Për shembull: Mëshira bëhet një bela e madhe edhe për faktin e dobësisë. Dashuria e djeg fort, për shkak të ndarjes që do të vijë. Shija për shkak të zhdukjes i humbet, duke iu bërë si një sherbet i hidhur. Por për shkak se nuk ke dashur për llogari të All-llahut xh.sh. dhe pa lejen e Tij, dëshira të shkon kot dhe pa dobi. Pa lejen e All-llahut xh.sh., çdo gjë kthehet në torturë dhe në asgjë tjetër.

Pyetje: Si ka mundësi të shkojë kot dashamirësia ndaj njerëzve të shenjtë (evlijave) dhe Profetëve?

Përgjigje: Nuk kanë për të bërë dobi ashtu si tek të krishterët, që Hz. Isain e quajnë si birin e Zotit xh.sh. dhe Rafizitë që duan Hz. Alinë, përkundër tre sahabeve të tjerë Ebubekir, Umer dhe Othmanin radijallahu anhum (mëshira e Allahut qoftë mbi ta).

Pra po qe se dashamirësitë i përdorni brenda udhëzimeve të Kur'anit dhe në llogari të dashamirësive të All-llahut xh.sh., gjë që e kthen atë në të dobishme, atëhere përfundimet e saj të bukura jo vetëm në këtë botë, por edhe në tjetrën do të fitohen. Ata që hanë ushqimet dhe frutat e shijshme duke kujtuar Krijuesin e tyre, pa kurrfarë hidhërimi bëjnë një falenderim të pastër. Po qe se ti e do nefsin tënd, duke iu dhimbsur dhe duke e edukuar atë, e largon nga veset e këqija, pra e përmirëson. Atëhere ai nuk të gllabëron në vorbullën e veseve, por ndoshta frerit e tij ti e merr në duar që të mos të çojë në vende të palejuara, por në rrugën e Zotit. Dashurinë që ke shpenzuar me bashkëshorten tënde, e ke ndërtuar mbi bukurinë e saj shpirtërore, duke menduar se këtë bukuri ta ka dhuruar Mëshira e Zotit xh.sh.. Në moshën e rinisë duke mos e përcaktuar pozicionin e dashamirësisë në mënyrë korrekte, atë duhet ta duash me sinqeritet dhe ta trajtosh me respektin e duhur, që ajo të mund të të respektojë ty. Në këtë rast respekti midis jush vazhdon deri në fund të moshës, pra deri në pleqëri, duke u bërë shkak që këto çifte ta kalojnë jetën në lumturi. Përkundrazi siç e thamë edhe më parë, po qe se dashurinë e shfaq vetëm për moshën e bukurisë fizike, ajo shumë shpejt do të kalojë dhe do të fillojë ankesa midis tyre.

Dashamirësia e prindërve kur kthehet në llogari të All-llahut xh.sh., llogaritet si një adhurim, sidomos kur këto t'i bësh me një respekt dhe ndërgjegje të lartë dhe me një logjikë e humanizëm serioz. Kur ti dëshiron për prindërit jetëgjatësinë dhe ulesh e iu puth dorën me respekt për t'i gëzuar dhe nderuar, për shkak të këtyre veprimeve do të fitosh sevape shumë të mëdha. Ky veprim për një djalë besimtar është një lumturi e madhe. Nuk është normale që t'i duash prindërit për interes dhe me plakjen e tyre t'i përbuzësh duke menduar se ata janë shkak që jeta jote nuk po të ecën mbarë, ngaqë ata tani janë nevojtarë ndaj teje. Është një marrëzi e tmerrshme dhe një katastrofë shpirtërore, që të presësh humbjen e tyre fizike, për të shpëtuar nga vuajtjet e tua.

Fëmijën ta duash dhe të mendosh se e

tregon këtë dhembshuri, duke menduar që

All-llahu xh.sh. të ka caktuar si mbikqyrës për këto krijesa të dobëta. Kjo detyrë për ty është një

mirësi dhe dashamirësi e pastër. Kur e gjen këtë ndjenjë, nuk vuan nga ndonjë shqetësim dhe kur vdes nuk bërtet i pashpresë. Në këtë kohë ti mendon se Krijuesi i tyre është i Gjithëmëshirshëm Mëshirëplotë dhe vdekja e tyre për ty në këtë çast është një mëshirë, duke menduar se All-llahu xh.sh., ata t'i ka dhënë ty prej Mëshirës së Tij dhe në këtë mënyrë mund të shpëtosh nga hidhërimi i ndarjes nga ata.

Po qe se shokët dhe dashamirët i ke dashur për llogari të All-llahut xh.sh., ndarja prej tyre si dhe vdekja e tyre, dashamirësinë tuaj të singertë dhe bisedat e ngrohta nuk i zbeh. Kjo dashamirësi e singertë meqenëse ka qenë pa kurrfarë interesi material dhe e shtyrë nga kontaktet shpirtërore, shija e takimeve zgjatet deri në përjetësi, por në qoftë se ato nuk i ke bërë për Hir të All-llahut xh.sh., shijet e takimit vetëm për një ditë ta japin përfundimin e ndarjes së njëqind ditëve (1).

Dashurinë e Profetëve dhe evlijave, duhet ta keni si qëllimin e jetës së pasvdekjes, të cilën mosbesimtarët e shohin si një errësirë të

thellë. Ti ata duhet t'i duash për shkak të jetës së vërtetë, sepse beson tek ekzistenca e një vendi ku tubohen trupat e njerëzve të ndritur. Shkuarja në ato vende për ty nuk është një arsye frike, përkundrazi ky vend ty të entuziazmon.

Prijsi I Rinise - IV

Pra dashamirësia për profetët dhe evlijatë, rrjedh nga besimi në fenë Islame, sepse ekzistenca e tyre është shkak që nuk i ka humbur shijet e kësaj bote dhe me tregimin e tyre ka shndritë jeta pas varrit deri në përjetësi. Dashamirësia ndaj tyre nuk ka qenë si ajo e të "qytetëruarve" materialistë që duan njerëz të posaçëm me mendimin që t'u plotësojnë nevojat e një jete të përkohshme, sepse pastaj do të zhduken në thellësinë e një varri të madh të së kaluarës. Vetëm mendimi i shkuarjes drejt asaj jete pa kthim, atyre ua shton hidhërimin, sidomos duke menduar se edhe njerëzit e shquar nuk kanë mundur të shpëtojnë nga zhdukja. Në këto momente atyre sa herë që iu kujtohet varri thonë: "Ah!". Mendimin e parë të besimtarit, ua kanë shndritur profetët, duke i garantuar një besim, që shpirti do ta braktisë rrobën e trupit në të kaluarën e vet dhe do të shkojë në ardhmëri, tek salloni i jetës së varrit. Në këtë mënyrë me një qetësi të zemrës e pret ditën, kur do të shkojë në lumturinë e përjetshme. Përfundimisht besimtari nuk frikësohet kurrë nga varri, por e mirëpret atë.

Dashamirësia për sendet e bukura meqenëse është në llogari të Mjeshtrit të tyre, pra ato i ke dashur duke menduar se sa të mira i ka bërë Mjeshtri, dashamirësia me këtë mendim të jep një shije të ëmbël. Kjo shije sidomos është edhe më e madhe në rastin kur mendon se në jetën e Ahiretit do të sodisim gjërat më të vlefshme dhe të hijshme. Kurse këtu i shijojnë me të gjitha shqisat e brendshme të shpirtit duke veçuar ato gjëra që janë me mijëra herë më të bukura se sa këto që po shikon. Këto vepra atij ia hapin anët, për të parë dhe soditur veprat Hyjnore të mrekullueshme dhe gjithashtu imagjinojnë prej saj bukuritë e Emrave të Bukur me funksionet e Tyre, duke i hapur rrugën zemrës për të soditur Atë i Cili është Madhështor dhe i Pashoq.

Përfundim: Rininë tënde e ke dashur për arsye se ajo është një mirësi e All-llahut xh.sh. dhe në të vërtetë atë nuk e ke shpenzuar në vende të mëkatshme, ku nuk e lejon Zoti, por vetëm duke e adhuruar Atë. Duke vepruar kështu, që në moshën e rinisë ke mundur të bësh këto adhurime dhe ke siguruar frutat e përjetshme, të fituara nga kjo jetë. Ngaqë rininë e ke shpenzuar në vendin e duhur, ajo do të të lulëzojë në moshën e pleqërisë. Dalëngadalë e ditë për ditë, duke bërë

adhurime dhe duke menduar se po e përfiton më tepër Mëshirën e All-llahut xh.sh., në shpirtin tënd ndjen më shumë shije dhe nuk je si ata që vajtojnë ngaqë e kalojnë rininë pa kujdes, përballë pesë apo dhjetë vjetëve të saj. Duke bërë titur si ata nuk vajton pesëdhjetë vjet duke thënë: -"...Oh i mjeri unë që më iku rinia!..." Në këtë mënyrë njëri prej tyre kishte radhitur, këto fjalë:

"Në qoftë se do të ishte e mundur, që një ditë të më kthehej rinia, do t'i rreshtoj në kokën time ato që më ka sjellur pleqëria".

Çfarë rezultati do t'i sjellë njeriut pranvera, sikur ai t'i dojë bukuritë e saja për hir të All-llahut xh.sh.? Po qe se kur sodit sipërfaqen e tokës mendon për Mjeshttrin e saj, atëhere shija e kësaj soditje nuk ikën. Pranvera është si një letër e qenditur plot me kuptime të shijshme, që Krijuesi yt t'i ka vënë në dizpozicion për t'i soditur në çdo çast, sepse imagjinata jote dhe periudhat e kohës të jepen për t'i freskuar si në një shirit filmi. Ti duke menduar kuptimin e bukurisë së pranverës, shijet vazhdojnë edhe më tej. Në këtë rast dashuria nuk të bëhet e mjerueshme, por si një shije e freskët të lumturon.

Po frutat e saja kur këtë botë e ke dashur për All-llahun xh.sh.? Po qe se ka qenë në Emrin e Tij, atëhere qeniet e tmerrshme të kësaj bote, të bëhen si një shok i dashur. Nëse botën e ke dashur sepse është si një arë e jetës së mbrapme, në secilin shqetësim për ty mund të bëhen nga një fidan dhe nga një frut, për në jetën tjetër. As fatkeqësitë e saj nuk të tmerrojnë dhe as përkohëshmëria dhe zhdukja nuk të shqetëson. Periudhën e të qenit misafir që do të përjetosh në të, do ta kalosh me rehati. Përndryshe po qe se i do si ata të pakujdesshmit, mbase njëqind herë ta kam përsëritur se do të gulçasësh midis shtrëngimeve të vështira të jetës së pafrutshme.

Të tregova një për qind frutet e disa dashamirëve që ke dashur me udhëzim të Kur'anit, por në qoftë se nuk i përshtatesh udhëzimeve të Tija, atëherë do të përballohesh me dëmet që më parë kemi shënuar një për qind të tyre. Tani në qoftë se do që të dish me argumente të Kur'anit se çfarë përfundimi kanë në jetën e mbrapme ata që kanë dashur për All-llahun xh.sh., në vazhdim me një parathënie do të parashatrojmë nëntë shenja, të dobive të këtij veprimi në mënyrë të përmbledhur.

NJË PARATHËNIE

Zoti xh.sh. me Madhështinë Hyjnore të Tij, me Bujarinë e Mëshirshme, me Dhembshurinë Fisnike, me Fuqinë e Madhe dhe me Bukurinë e Gjithëdijshme, trupin e këtij njeriu të vogël, e ka krijuar me të gjitha ndjenjat, ndërgjegjet, shqisat dhe elemente të organeve të vogla dhe të ndryshme, si dhe me ndjenja të thella shpirtërore. Që ky njeri të mund të drejtpeshojë anët e Bamirësive të panumërta dhe mirësi të

shumëllojshme, duhet njëkohësisht të pasqyrojë edhe madhështinë e Mëshirës së Tij. Ai me këto reklamime pasqyron edhe shkëlqimin e njëmijë e një Emrave të Tij, që njeriut t'ia tregojë ekuilibrin e dashamirësive duke e tërheqë ndaj Vetes. Pra me këtë tregim duhet të kuptojmë se për secilin element që i ka dhuruar Zoti xh.sh., të cilat janë të panumërta, Ai të kërkon një shërbim dhe adhurim të veçantë, duke pasur në dijeni se edhe shijen, hidhërimin, detyrën dhe shpërblimin do ta kenë të veçantë.

Përsëmbull: Syri tregon shkallën e bukurisë së çdo fytyre duke u kënaqur prej tyre, si dhe me bukuritë e natyrës, që janë ekspozuar në Gjithësi në një shumëllojshmëri të mrekullueshme, nëpërmjet Fuqisë së

All-llahut xh.sh.. Detyra e tij e të soditurit është për të nxjerrur në pah kuptimin e tyre. Është e njohur shija dhe hidhërimi për syrin dhe nuk ka nevojë të zgjatemi.

Le të marrim p.sh. veshët. Ai duke dëgjuar llojet e zërave, me meloditë e bukura, vlerëson edhe shkallët e bukurisë së tij, si për rastin e mirë edhe për atë të botërave të frikshme. Duke bërë dallimin e tyre, ai ekuilibron dhe ndjen Mëshirën e All-llahut xh.sh.

Të përmendim organet e shqisave të të nuhaturit. Duke ndjerë të gjitha kategoritë e nuhatjeve, përcaktojnë llojet e aromave dhe të parfumeve, për të ndjerë Mëshirën e Krijuesit të tyre. Pra secili në vetvete ka një detyrë falenderimi dhe adhurimi të veçantë. Me anë të kësaj të vërtete edhe shpërblimin do ta ketë sipas realizimit të detyrës.

Shqisa e shijes duke vlerësuar shkallët e shijeve të ushqimeve, pikërisht për këtë detyrë krijon një falenderim të gjerë.

Të gjitha shqisat e mëdha të trupit të njeriut, si p.sh. zemra, mendja dhe shpirti, secila veç e veç, kanë detyra të rëndësishme, sepse ato ndjejnë shijet dhe hidhërimet e ndryshme të shqisave të panumërta.

Pra All-llahu i Madhëruar, me Pozicionin e Tij Absolut, tek ky njeri, ka vënë që t'Ishërbejnë këto shqisa dhe me të vërtetë sipas meritave, secilin do që ta shpërblejë. Siç treguam edhe më parë, përballë dashamirësive të lloj-llojshme, ta parashikojnë me ndërgjegje edhe ta marrin parapagesën. Kjo vërtetohet me argumente të forta, se çfarë rezultati merr në jetën e mbrapme. Në "Fjalën e dhjetë"(Ringjallja), sqarohet në mënyrë të përmbledhur me anë të dymbëdhjetë argumenteve të sakta, kurse në "Fjalën e Njëzetënëntë", akoma më mirë theksohet. Fjala amshueshem

Fjala më e drejtë dhe gojtaria më e përsosur është fjala e All-llahut, Zotëruesit të Madhështisë së Gjithëdijshme”.

Me argumentet e Tij, Kur'ani në mënyrë domethënëse dhe të padyshimtë, shënon dhe vërteton ato që thamë. Nuk ka nevojë për të vazhduar më gjatë. Zakonisht edhe në të tjera "Fjalë" dhe në temën e xhennetit në gjuhën arabe, në "Pozitën e dytë" të "Fjalës së Njëzetetë" dhe të "Njëzetënëntë", kemi paraqitur argumente të shumta.

Tani do të fillojmë t'i radhisim shenjat:

E para: Ushqimet e shijshme dhe frutat e bukura që ke ngrënë për All-llahun xh.sh., në bazë të argumenteve të Kur'anit, në botën tjetër, në xhennetin e lumtur edhe më mirë do të kënaqesh për ato falenderime që ke bërë këtu. Me një oreks më të madh do të shijosh dhe do të kënaqesh prej tyre. Në këtë botë për mirësitë që ke thënë: "Elhamdulillah!", ato falenderime në atë jetë do të paraqiten si fruta të xhennetit, dhe në këtë botë që ke thënë "Elhamdulillah", përballë këtij falenderimi, atje ke për të ngrënë si fruta

"Elhamdulillahët". Me shenja të Kur'anit dhe me transmetime të haditheve të Pejgamberit (a.s.), theksohet se këtu duke ngrënë prej Mirësive të All-llahut xh.sh., pse ke kujtuar Bamireshinë Hyjnore dhe Dhuratën e Mëshirës së Tij, këto falenderime shpirtërore atje ty do të paraqiten si mirësi tepër të shijshme.

E dyta: Për rrugën e lejuar ku e ke drejtuar nefsin tënd, pra duke mos e kryelartësuar veten dhe duke korrigjuar gabimet e bëra, je munduar dhe e ke futur atë në veprim për punët e "hajrit". Kështu për të shpërblyer këto sakrifica, All-llahu xh.sh. në xhennet do të japë më tepër, duke marrur parasysh se ky njeri veset e nefsit i ka kthyer në Rrugën e Tij dhe për Të i ka shpenzuar. Shqisat dhe organet kush i ka përdorur me një mjet më të bukur, Bujari Absolut, atij për këtë përdorim të suksesshëm, si shprehje adhurimi, do ta shpërblejë me "huri" (vajza të bukura) të xhennetit të lumtur. Do t'i veshin atyre shtatëdhjetë lloje petkash të qendisura dhe të modeleve të larmishme. Këto vajza, huri të xhennetit, janë për të kënaqur më mirë ata që s'i kanë shpenzuar veset e epsheve në haram. Secilës "huri", nëpërmjet shtatëdhjetë palë fustaneve, do t'u duket nyja e këmbës, Ajo do të jetë si një xhennet i vogël, për të lumturuar besimtarët që janë ruajtur nga harami. Këtë të vërtetë All-llahu xh.sh. e ka vërtetuar me shumë ajete.

Kështu edhe për rininë. Kush e ka shpenzuar atë në rrugën e All-llahut xh.sh., në xhennet do të fitojë një rini të përjetshme, që nuk ka kurrë pleqëri.

E treta: Kush e ka dashur gruan sipas urdhërit të All-llahut xh.sh., pra kush e ka vlerësuar dashurinë në bazë të moralit të saj të bukur, nga ana e bukurisë shpirtërore dhe në respektin e mëshirshëm, si dhe kush e ka mbrojtur atë nga ruga e gabuar dhe e mëkatshme, Mëshirëploti Absolut këtë burrë do ta shpërblejë në jetën e lumtur. Atij do t'ia paraqesë bashkëshorten në një shkallë më të bukur se sa "huri". Me një mjet më të përshtatshëm, në karrike përrallore, përballë njëri-tjetrit, me një hijeshi të pa arrirë do t'u tregojnë njëri-tjetrit ato pjesë të jetës që kanë përjetuar. Ja pra në këtë trajtë do të shndërrohet dhe do t'ua paraqesë Zoti bashkëshorten tuaj, si një vajzë që nuk mund ta imagjinosh, e butë, e ëmbël, si një shoqe të dashur, për një jetë të pambarim. Këtë e ka premtuar All-llahu xh.sh. dhe pa dyshim që Ai premtimin e mban dhe nuk e mohan!

E katërta: Dashuria për prindërit dhe fëmijët, të cilën e ka bërë për hir të Zotit xh.sh..

Më i Mëshirshmi i të mëshirshmëve, në Kur'an ka theksuar se prindërit me fëmijët edhe në qoftë se i kanë pozitat veç e veç, përsëri atë familjen e lumtur Zoti në xhennet nuk do ta ndajë, por në një bisedë të këndshme do t'i bashkojë njëri me tjetrin.

Ai do t'u dhurojë xhennetlinjëve jetën që u takon. Para moshës madhore (nën pesëmbëdhjetë vjeç), siç tregon Kur'ani: aje:

22)

“Djelmosha (fëmijë) të gjithmonshëm”; do t'i jepet një hijeshi, në një formë shumë të përsosur dhe do të lihen në prehër të nënave dhe të baballarëve për t'u kënaqur me një jetë të përjetshme. Këtë dëshirë ia plotëson atyre prindërve që janë nënshtruar urdhërave të Zotit, që tani duan të përkëdhelin fëmijët e tyre. Meqenëse u kanë vdekur fëmijët pa hyrë në moshën madhore, në xhennetin e lumtur, gjithmonë ka për të mbetur si një fëmijë i dashur. Pra në xhennet çdo gjë e këndshme është më e mirë se sa në këtë jetë. Meqë atje nuk është vend riprodhimi, mendohej se do të ishte bosh nga fëmijët dhe dashamirësia e tyre. Me tregimin e parë pamë se edhe ajo do të ekzistojë, bile në një formë më të bukur. Tani u dhamë një lajm të mirë, atyre që i vdesin fëmijët pa hyrë në moshën madhore.

E pesta: Përfundimi i dashamirësisë ndaj shokëve që janë në rrugën e Zotit xh.sh..

Ata do t'i gjeni në xhennetin e lumtur të ulur ballë për ballë në karrike të bukura, duke këmbyer gëzimet e tyre. Këtë të vërtetë Kur'ani e ka theksuar në ajetin:

23)

“Ata në mbështetëse qëndrojnë ballë për ballë njëri-tjetrit, duke qenë të vëllazëruar”.

Pra nuk ka më mirë për njeriun kur do të ulet dhe të bisedojë me dashamirët që i ka dashur vetëm për hir të All-llahut xh.sh. njëri-tjetrit do t'i tregojnë histori të lashta për jetën e kaluar, në një vend pa brenga ku nuk ka gjë tjetër veçse kënaqësi. Kështu i gëzon All-llahu xh.sh. të gjithë ata që njëri-tjetrit e kanë dashur pa kurrfarë interesi.

E gjashta: Çfarë përfundimi ka për ata që profetët dhe evlijatë i kanë dashur siç ka thënë Kur'ani? Megjithëse ndihma e profetëve dhe e evlijave do të vijë në ditën e mah'sherit dhe në jetën e varrit, përsëri edhe nga pozita dhe bisedat e larta të tyre do të përfitohet. Kjo Fjalë e Shenjtë përmban sekretin e vet që thotë:

“Njeriu është me ata që do”.

Si shembull një njeri i thjeshtë po qe se ka hyrë në rrethin e një personi që është me pozitë të lartë, ai mund të hyjë edhe në vende të larta të atij personi.

E shtata: Po qe se i ke dashur duke menduar për Mjeshttrin e tyre pranverën dhe sendet e bukura,

duke thënë se sa mirë i ka krijuar Mjeshtri Madhështor, pas këtyre mirësive do të shohësh ndihmën e Emrave të Bukur dhe pasqyrimin e funksioneve të këtyre Emrave, duke thënë se këto qenie të praruara, vetëm Një i Gjithëmëshirshëm mund t'i krijojë. Përfundimi i një dashamirësie të tillë është kështu: Në jetën e përjetshme, në xhennet, për këto krijime që i ke parë këtu, shkëlqimi i funksioneve të Emrave të Bukur shkëlqejnë më një mjet njëmijë herë më të mirë se këtu, përderisa Imami Rabbani (r.a.) ka thënë: "Bukuritë e xhennetit janë Shkëlqimet e Emrave të Bukur!..."

E teta: Në këtë botë dashamirësinë që ke treguar për të kujtuar Emrat e Bukur, është një arë dhe një pasqyrë e atyre Emrave. Përballë kësaj dashurie, në jetën tjetër i bëhet një xhennet i përjetshëm. Në këtë botë janë treguar vetëm hijet e Emrave të Bukur, po atje do të tregohen krejtësisht, me një mjet të përkryer, frutet e dashurisë së kësaj bote që ke dashur si një arë e Ahiretit, një arë që pjek vetëm fruta të xhennetit dhe kështu veprimtaria jote do të të bëhet fidan për në xhennet. Veset dhe dëshirat e njerëzve këtu duke qenë si një fidan i vogël, do të lulëzojnë në xhennet në një formë më të bukur. Në këtë botë aftësia e njeriut duke qenë në formën e një fare të vogël që lulëzon shije të shumëllojshme, atje do të jepen xhennetet si shpërblim, ngaqë në këtë botë e ke përdorur në vendin e duhur dashamirësinë. Këto që treguam janë forcuar me transmetime të haditheve dhe shenja të Kur'anit, se kështu e nevojit Mëshira dhe Gjithëdija e Pastër e All-llahut xh.sh.. Meqenëse ty nuk të përfshin krimi që thotë se të adhurosh botën është faj kryesor, ndoshta ti botën e ke dashur sepse aty përfshihen dhe pasqyrohen Emrat e Bukur dhe jep prodhimin e jetës tjetër.

Ti e ke dashur këtë botë me mendimin që të bësh një adhurim dhe duke soditur ke kujtuar Atë, duke kultivuar në këtë mënyrë detyrat e kësaj bote. Duke dashur botën, me këtë mendim ke adhuruar All-llahun xh.sh..

Pra Mëshira dhe Gjithëdija e Zotit xh.sh. e bën të nevojshme, që të marrësh një shpërblim sa e gjithë kjo botë. Përsëri duke e dashur jetën e pastajme, këtu ke dashur "arën" e saj dhe ke pasqyruar dashurinë për All-llahun xh.sh. dhe Emrat e Tij. Me të vërtetë kjo vepër e do një shpërblim sa kjo botë. Ajo nuk është gjë tjetër vetëm se një xhennet shumë më i bukur se sa kjo botë që jeton.

Pyetje: Çfarë vlen gjithë ai xhenet madhështor?

Përgjigje: Sikur të ishte e mundur, me shpejtësinë e imagjinatës, kishe ecur nëpër yje dhe do të kishe thënë, që të gjitha botërat janë të tuat. Shoqëria e melekëve, e njerëzve dhe e krijesave, këtë gjykim nuk do ta trazonin ty.

Kështu: Po qe se ai xhennet do të ishte plot me krijesa që e hijeshonin, mund të thoshe se ishte i yti, sepse nuk të bëhet kush pjesëtar në kënaqësinë tënde. Në një hadith të Pejgamberit (a.s.) theksohet: "Disa xhennetlinjëve do t'u jepet një xhennet në gjerësinë e pesëqind vjetëve". Sekret i kësaj të vërtete është treguar në "Fjalën e njëzetetë" dhe në "Shkëlqimin e singëritetit".

E nënta: Evlijatë janë bashkuar në këtë pikë se fruti i besimit dhe i dashamirësisë ndaj All-llahut xh.sh., njeriut i garanton takimin me All-llahun xh.sh., që përbën edhe vlerën e patregueshme. Lumturia e njëmijë vjetëve të kësaj bote nuk vlen sa një "orë" e xhennetit, por edhe njëmijë vjet të jetës së xhennetit nuk vlejnë sa një orë e takimit me All-llahun xh.sh.(1).

Tani e kuptove se çfarë na garanton besimi dhe dashamirësia ndaj All-llahut xh.sh., të saktësuara qartë në lajmin që na ka dhënë Kur'ani dhe Hadithi i Pejgamberit (a.s.).

Në vetën e tij secili me një zell të madh ka merak për ta parë Sulejmanin Alejhisselam (një person i famshëm që është me një përsosmëri të jashtëzakonshme). Çdokush ka merak për ta parë, Jusufin Alejhisselam, që ka qenë me një hijeshi të posaçme. Çdo njeri a nuk ka vallë

dëshirë t'i shohë përsosmëritë e xhennetit, që janë me mijëra herë më të larta se ato të kësaj bote? Dihet se përsosmëria e xhennetit është vetëm një shkëlqim prej bukurisë dhe përsosmërisë së Zotit xh.sh.. Se sa dëshirë duhet të kesh për ta parë Atë, për ta dashur, për t'u bërë merak dhe për ta kërkuar, nuk mund të krahasohet me asgjë. Ajet

“O All-llah, në këtë botë sillma dashurinë ndaj Teje dhe ndaj atyre që më afrojnë tek Ti dhe t'u mbështetemi urdhërave të Tua dhe në jetën tjetër sillma mëshirën Tënde që të bëj të mundur takimin me Ty.

13) O All-llah Ti je i Patëmeta, ne nuk kemi dije tjetër përveç asaj që na mësove Ti, Vërtetë Ti je i Gjithëdijshmi i Urti. O All-llah derdhi bekimet Tuaja mbi Atë të cilin e ke dërguar si simbol të mëshirës për të gjithë botërat dhe mbi familjen e Tij të pastër dhe të gjithë shokëve të Tij të dashur. Amin!...”.

.....
POZITA E DYTË E TË KATËRMBËDHJETIT SHKËLQIM.

Këtu do tua tregojmë vetëm gjashtë sekrete të “Bismillahirrahmanirrahimit”, ndërsa ajo (Besmeleja) mbanë edhe mijëra sekrete të tjerë.

VËTEJTJE: Në pikëpamjen e mëshirës, mendimit tim të shuar prej së largu, Besmeleja m'u duk si një dritë e shndritshme. Për vehten time desha ta regjistroja Atë në formën e notave duke filluar ta ritheksoi me njëzetë, tridhjetë sekrete dhe u mundova ta gjuaj dhe ta pushtoj. Por fatkeqësisht, nuk munda të kem sukses ashtu siç dëshirova. Nga njezet-tridhjetë ato kanë rënë në gjashtë.

Duke shkruar, kur them “O njeri” ta dini se nënkuptoj vehten time. Ky mësim është veçanërisht për mua, për atë që shpirtërisht më përngjan mua si dhe për atë që është më i zgjuar se unë. E shkrova edhe “pozitën e dytë të shkëlqimit të katërmëdhjetë”, duke braktisur vullnetin e vëllezërve që shohin hollë që të bëjnë dobi edhe ata. Pikësynimi i këtij mësimi është më tepër zemra se sa mendja, sepse ajo përballet më tepër me shijet shpirtërore se sa me argumentet. AJET 1)

Në këtë pozitë do të rradhisim disa sekrete.

Sekreti i parë: Unë e pashë kështu një nga shijet e “Bismillahirrahmanirrahimit” :

Në fytyrën e gjithësisë, në fytyrën e ruzullit, dhe në fytyrën e njeriut, njëri brenda tjetrit, njeri duke treguar mostrën e tjetrit, duken tri vula të Edukatorit të Madhërishëm.

E para: Në të gjithë sendet e Universit sqarohet ndihma, solidariteti dhe shtjellimi e ndërthurja me njeri-tjetrin. Pra përgjigjen e këtyre veprimeve që treguam, mund të merni në vulën e madhe Hyjnore, pra tek fjala “Bismil-lah”-i që Ai perballohet me të.

E dyta: Në sipërfaqen e tokës, nëpër bimët e kafshët, përngjashmëria e ekuilibritit dhe edukimit të pagabuar na sqaron se tek ato po sundon përshtatshmëria, rregulli, kompaktësia që është dhuruar nga Mëshira e Pasosur që mban vulën e madhe të të Gjithëmëshirshmit të rrjedhur nga “Bismil-lahirrahmanirrahimi”.

Më pas shikova tërësinë e cilësive të njeriut në të cilën secila pjesë është pajisur me hollësitë e mëshirës, me ndjeshmëritë e dhimbshurisë. Këto sqarojnë se mbanin patjetër vulën e lartë të Mëshirëptotit dhe është kuptimi i Errahimit në të është një pjesë e Bismil-lahirrahmanirrahimit. Domethënë: “Bismil-lahirrahmanirrahimi” duke zbritur nga lart ka arritur të zgjatet si një rreshtë tek fleta e madhe të Universit dhe tek fruta e Gjithësisë, pra tek njeriu. Është Ai që botën e lidh me qiellin më të lartë. Ai i hap njeriut rrugën që të arrijë në vendet më të larta.

Sekreti I dytë: (shënim) Në Kur'anin famlartë.

(Shënim) Në gjuhën arabe me dy emra tregohet Njësia e Zotit xh.sh.: “Vahidijet” edhe “Ehadijet”.

Vahidijeti: Njësinë e All-llahut xh.sh. e tregon në tërësinë e një çështjeje. Kurse Ehadijeti në pjesët e saj. Përshembull: Vahidijeti në tërësinë e njeriut, Ehadjeti në veglat e njeriut, syri, veshi, gjuha, zemra etj.

Allahu kur u tregon krijesave Njësimit e Tij, që të mos ngulçitë mendjet në Vadihjet në hapësirën e gjerë, mbrenda Vahidijetit tregon shkëlqimet e Ehadijetit. Domethënë Vahidijeri i koncepton shumë gjëra sikurse dielli me dritën e tij që i koncepton shumë sende . Për të parë vetë diellin, ne na duhet një përfytyrim i gjerë dhe një sy i madh. Që ne të mos harrojmë diellin se është e shndritshëm, ai me anën e jehonës na tregon vehten. Dhe sipas aftësisë së çështjeje secili send që ndriçon na tregon dritën, nxehtësinë, ngjyrën dhe nganjëherë në sipërfaqe më të gjerë, sikurse na tregon dritën dhe nxehtësinë na tregon edhe shtatë ngjyrat e tjera të Tijën. Njesoj ajet duke dhenë shembull të mos gabojmë.

“Ehadijeti dhe Samedijeti Ýlahije” janë funksionet e Njësimit dhe Gjithëdrejtuesit Hyjnor. Duke na treguar të gjithë funksionet e Emrave të tjerë Hyjnorë në të gjithë sendet, veçanërisht në qeniet e gjalla dhe sidomos në pasqyrën cilësore të njeriut na tregon shkëlqimet e funksionet e Emrave të Vet. Njësoj, si veç e veç ashtu edhe i njësuar Vahidijeti me funksionet e Emrave tjerë, konceptojnë edhe krijesat e tjera. Tani që të mos ngulçiten mendjet me Vahidijetin dhe zemrat që të mos harrojnë Zotin e Patëmetë, duke parashtruar vazhdimisht brenda Vahidijetit na tregon vulën e Ehadijetit që:”Bismil-lahirrahmanirrahimi” na tregon tre nenet e rëndësishme të tyre. Sekreti i tretë: Po duket shumë qartë se Mëshira e ka hjeshtuar Universin e paskajshëm. Dhe me siguri është Mëshira që ndriçon dhe qeniet të errëta. Dhe s’ka dyshim se mëshira i edukon këto qenie që rrokullisen në nevojat e tyre të panumërta, duke ua përballuar ato (nevojat e tyre). Si një dru frutor që me tërë mjetet ka lidhje me frutin e tij, njësoj s’ka dyshim se prap kjo Mëshirë, i ka kthyer të gjithë qeniet të vrapojnë t’i ndihmojnë dhe t’i shërbejnë njeriut. Dhe kosmosin bosh e të paanë, e ka mbushur me yje që ndriçojnë; me siguri aty prapë është Ajo Mëshirë. Dhe njeriun e përkohshëm që e ka bërë anëtar i përvetshëm dhe e ka paraqitur para një Mikut të Pafillimtë e të Pambarimtë. Me siguri e patjetër prapë është Ajo Mëshira e Mëshirëplotit.

O njeri! Mëshira e All-llahut është një forcë aq e madhe tërheqëse e shpëtuese dhe një e vërtetë e dashur. Atëherë për t’iu ngjitur kësaj Mëshire thuaj: “Bismil-lahir-rahmanir-rahim”. Vetëm në këtë mënyrë mund të shpëtosh nga vrazhdësitë absolute dhe nga nevojat e dhimbshme të panumërta. Vetëm kështu mund të afroresh tek fronin e Sulltanit të Pafillimtë dhe Pambarimtë dhe për t’iu ngjitur rrezeve të dhimbshurisë së Mëshirës dhe për t’u bërë dashamirë dhe miku i Sulltanit dëgjo fjalët e Tij!

Rreth njeriut që i sjell qeniet në formën më të dobishme të cilat duke i shërbyer i ndihmojnë dhe t’ia plotësojnë tërë nevojat që ka, patjetër nga dy alternativa, njëra është e vërteta. Apo vetvetiu secili send po e njeh njeriun. A nuk është kjo njëqind herë larg mendjes dhe e pamundur? A është e mundur që njeriu që mban një dobësi absolute ti sjellë rreth vehtes këto sende si një sulltan. Apo këto po bëhen me ndihmën e Një Fuqiploti që është pas perdes së këtij Universi. Domethënë, këto lloje që i ndihmojnë njeriut, nuk e njohin atë. Ndoshta patjetër që këto i bën një Mëshirëplotë që me mëshirën e Tij e njeh njeriun dhe në ndihmën e Tij i sjellë ato.

O njeri, mblidhe mendjen,dhe mendo!

A është e mundur ty që të mos të dijë, të mos të njohë e të mos të shohë një Fuqiplotë që i

shtyn të gjitha qeniet, që me tërë fuqinë e tyre të vrapojnë pas teje dhe kërkesave të tua dhe të të thonë vazhdimisht ty “Urdhëroni! Çfarë doni”. Dhe meqë Ai të di ty dhe po të tregon me mëshirën e Tij se po të di, edhe ti dije Atë dhe tregoja Atij nderimin tënd dhe kuptoje saktësisht se: është Mëshira e vërtetë Ajo që është duke të ndihmuar ty, një njeriut që je me dobësinë, varfërinë dhe ligëshkrimin absolute , një njeriut të vogël e të përkohshëm, të të shërbejë Universi Madhështor. Ai, Mëshira të ndihmon ty me Gjithëdijen e Tij. Të gjitha I sjellë me dijen , me fuqinë dhe me ndihmën e Tij të Pashoqe. Pra , patjetër kjo Mëshirë don prej teje një falenderim të përgjithshëm dhe një nderim të pastër. Pra, ti që të qartësosh nderimin, falenderimin e respektin me zemër, me sinqeritet thuaj: “Bismil-lahirrahanirrahim” dhe hyn në ndërhyrjen e Gjithëmëshirëshmit dhe arrin Mëshirën. Ja pra, qenia dhe realizimi i Mëshirës është e qartë sa dielli. Sepse si një qëndisje që është në qendër, ajo sigurisht është formuar nga literat e gjithanshëm: Njësoj, edhe në rrethin e madh të Universit si litera janë zgjatur njëmijë e një Emra Hyjnore të shndritshëm dhe ato në fytyrën e Universit tregojnë vulën e Mëshirëplotit dhe me rrezet e Mëshirës së Tij po duket qartë se po qindisin pëlhurat e Mëshirëplotit dhe në këtë mënyrë Mëshira më i shndritshëm se dielli ua sqaron vehten atyre që logjikojnë. Ja pra, Ai Mëshirë, me njëmijë e një Emrat Hyjnorë me Mëshirën e Pashoqe e ka qëndisur diellin, hënën, elementet, minierat, bimët e kafshët dhe i ka shtyrë ato t’i shërbejnë gjallesave. Duke dhënë pjesë nënëve të bimëve dhe të kafshëve, Mëshira i ka bërë ato sakrifikuese. Prap ajo Mëshirë, I ka bërë të gjithë gjallesat shërbëtorë të jetës së njerëzëve. Dhe Ai Mëshirë ,nëpër këto veprime, me një formë të shkëlqyer, me Mëshirën e Edukatës Hyjnore dhe me funksionin e Gjithëmëshirshëm Madhështorë atë duke mos përngjanë askujtë në fytyrën e njeriut, si një vulë Hyjnore sqaron sovranitetin e Tij absolut. Njeriu duke parë këtë funksion e sheh shumë më mirë nevojën e vet absolute bashkë me dobësinë dhe varfërinë që ka.

O njeri! Ne qoftë se je njeri, për të gjetur atë Mëshirë dhe për të hyrë në ndërhyrjen e Tij, thuaj “Bismil-lahirrahanirrahim!”. Se Ai ka krijuar në sipërfaqen e tokës karvanin e katërqind mijë lloje bimëve e kafshëve, të gjitha këto pa harruar as njërin. Pa gabuar, në kohën e duhur dhe me një përsosmëri të lartë i edukon dhe i drejton ato duke i vendosur në këtë mënyrë fytyrës së tokës vulën e Njësimit të Tij Hyjnor. Askush tjetër, por patjetër vetëm Mëshira e Tij i bën ato!.

Ekzistenca e Mëshirës duket më qartë se ekzistenca e qenieve që janë në sipërfaqen e tokës dhe këto argumente janë aq shumë sa sasia e këtyre qenieve. Ashtu si në fytyrën e tokës që ekziston një Mëshirë e një vulë e Njësimit Hyjnor, edhe në cilin njeri shpirtërisht ekziston një Mëshirë që atë e vërtetojnë argumentet sa sasia që është në fytyrën e tokës dhe në Univers, Dhe duket shumë qartë Vula e madhe e Mëshirës Hyjnore. Ndërsa tek njeriu Ajo shkëlqen e duket si një përmbledhje e njëmijë e një Emrave të Zotit xh.sh..

O njeri! A është e mundur që Zoti I Madhëruar ,duke të mos dhënë rëndësi dhe duke të mos kontrolluar lëvizjet e tua të të lërë të sillesh si ndonjë vagabond kokëbosh Ty që mbanë vulën e Mëshirës dhe të Njësimit të Tij Hyjnore dhe të shkojnë kot këto shërbime që Universi të ka parashtruar ty?!

Duke mos kërkuar llogari nga ti, pema e Gjithësisë do të mbetet e kalbur dhe e prishur. Dhe a ka mundësi që të lejojë ta mohosh

Mëshirën e Gjithdijen e Tij që është e qartë si dielli dhe si drita edielit, që nuk ka dyshim dhe nuk mohohet kurrë asnjëherë?!..

O Njeri! Dije se për të arritur në fronin e saj Mëshire “Bismil-lahirrahanirrahimi “është një mjet shumë i bukur. Dhe që të kuptosh se sa e rëndësishëm është ky fron, shikoj zanafillet e njëqind e katërmëdhjetë kaptinat e Kur’anit, fillimin e librave fisnikë dhe nisjet e punëve të mira që mbanin në ballë nga një” Besmele”. Pra për të kuptuar vlerën e “ Bismil-lahit” shihe

argumentin më të saktë që si Imam Shafija edhe personalitetet e mëdha që kanë nxjerrë kuptim nga Kur'ani, kanë thënë se: “Besmeleja është ajeti i vetëm që ka zbritur 114 herë”.

Sekreti I Katërt: Brenda Shkëlqimeve të panumërta secilit nuk po i mjafton leximi i “ajet:24) së; mendja po shpërndahet, nëpër shkëlqime për të konceptuar njësimin e Zotit. Atij po i duhet një stomak sa rruzulli që të mund të lexojë ajetin: . Nga kjo sekreti është se, All-llahu i madhëruar me Ehadijetin Njësimin e Tij ka treguar nëpër pjesë të vogla edhe me Vahidijetin prapë Njësimin e Tij na tregon nëpër tërësinë e llojeve, në këtë rast brenda vulës së Mëshirës së Tij na tregon vulën e Ehadijetit, vetëm kështu me AJETIN 25) drejtëpërsëdrejti mund të kthehesh që të flasësh me All-llahu xh.sh.. Tani nga ky sekreti madh është se Kur'ani famëlartë kur flet për rrethin e Gjithësisë..Përshebull kur flet për krijimin e qiellit e të tokës, menjëherë flet nga ndonjë rreth më i vogël minimal; në këtë mënyrë më një formë më qartë mund të tregojë vulën e Ehadijetit. Përshebull: Kur bën fjalë për krijimin e qiellit e të tokës, bën fjalë edhe për krijimin e njeriut; bën fjalë nga zëri i tij dhe nga mirësitë që ai ka në fytyrë, në këtë mënyrë e mbron mendjen që të mos shpërndahet, që zemra të mos ngulçitet dhe që shpirti ta gjejë adhuresin e tij. Përshebull: AJETI:26 Ky ajet me një formë shumë qartë, si një mrekulli na tregon të vërtetën e temës sonë. Ja pra, me një sasi të pafundme duke marrë nga më i vogli e deri tek ai më i madhi duken vulat e Njësimit të Zotit duke qenë në shkallë të ndryshme janë si rrathët njëri brenda tjetrit. Por ajo vula e Vahdetit (e tekllukut) patjetër sqaron vehten edhe edhe nëpër grupe të mëdha. Për këtë ka nevojë për Ehadijetin, sepse mendja në hapësira të mëdha ngulçitet; zemra për t'u përballur direkt me Zotin ka nevojë ta shohë edhe në pjesë të vogla vulën e Njësimit Hyjnore. Dhe Zoti i Madhëruar, për ti kthyer kokat e tyre nga Vehtja dhe për t'i tërhiqur zemrat nga Mëshira e Tij dhe që të duken qëndisjat e tërheqse, drita e shndritshme dhe ëmbëlsira e shijëshme dhe bukuria e dashur ka vendosur vulën e Mëshirës. Ja pra forca e Mëshirës është se, me anën e saj shohim edhe Ehadijetin, edhe në pjesët e vogla dhe i tërheq vëmendjen e njerëzve nga Vehtja. Ato i përballon me AJETË: Tani, për këtë arsye “Bismil-lahirrahmanirrahimi “është një titulli madh, sepse është parathënie e “Fatihasë” dhe përmbledhje e Kur'anit famëlartë. Pra kush e merr në dorë këtë titull, ai mund të shëtisë nëpër shtresat e Mëshirës, atëhere, duke parë Mëshirën e Mëshirplotit sheh se cili sekret e ka shtyrë këtë përkthyes t'i flasë këto fjalë.

Sekreti i pestë: Në një hadith thuhet HADËTHI (Apo siç ka thënë) Disa tarikatçinj këtë Hadith të Pejgamberit e kanë përkthyer me një formë të habitshme që nuk përputhet me besimin islam. Derisa ajo ka rrjedhur nga disa dashnorët e All-llahut, fytyrën shpirtërore të njeriut, kanë shikuar sikur e shikon I Gjithëmëshirshmi. Këta mistikë, për këtë mund të falen, se nga dehja e dashurisë ato nuk kanë mundur të mendojnë mirë.Por ata që mund të mendojnë mirë, nuk mund t'i pranojnë mendimet e tyre këtë. Kështu, të gjithë Universin që e drejton si një vilë, si një shtëpi; dhe yjet në një formën më të mirë dhe ato në lehtësinë e atomëve që i sjellë i rregullon, atomët si nëpunësit e bindshëm që i detyron një Zot patëmeta, që nuk ka ndihmës apo shok,ajet 27) që ta shikosh njeriun me atë Funksion nuk është e drejtë. Ndërsa edhe nga AJETI 28)

kuptohet se asnjë send nuk i ngjanë Atij. Por ne vetëm me shembuj mund t'i njohim funksionet e Tij. Pra, ne me shikimin tonë mund ta njohim “Shikuesin” apsolut. Hadithi që përmendëm më parë ka edhe shumë kuptime të tjera, por njëri është që: Njeriu është në gjendje t'i sqarojë të gjitha funksionet e të Gjithëmëshirëshmit. Ja siç treguam edhe më parë funksioni i të Gjithëmëshirëshmit është vetëm Ai që nga njëmijë e një Emërat Hyjnore që funksionojnë në fytyrën e universit duke sqaruar Vehten. Pra siç në fytyrën e botës dhe në vendet e panumërta me Emrin e Tij I Gjithëmëshirëshëm sqaron edukatën e Tij të absolute. Njësoj edhe në fytyrën e

cilësive të përgjithëshme të njeriut edhe në Botën e Universin i sqarohen të gjithë shkëlqimet e Gjithëmëshirëshmit. Dhe me këtë japë shenjë se, Emrat e Gjithëmëshirëshmit aq pasqyrohen në gjërat e gjalla veçanërisht nëpër njerëz që: Siç dielli kur bie në pasqyrë dikush asaj që po mund të thojë se “ pasqyrë është dielli” pra edhe për arsye se tek njeriu pasqyrohet Funkcioni i të Gjithëmëshirëshmit është e mundur që mistikët të thonë se “ tek njeriu sqarohet funksioni i të Gjithëmëshirëshmit”. Dhe për këtë arsye është se disa tarikatçinjët thonë: “ Përveç Atij nuk ekziston gjë”

Sekreti i gjashtë:

O njeri i pafat që rrokullisesh brenda dobësisë dhe varfërisë së paanë! Me këto që do ta tregoi mund ta kuptosh se Mëshira për ty sa është një mjet i vlefshëm. Që kjo Mëshirë të lidhë me një Sultan të Madhërisëm që: Yjet së bashku ma atomët janë ushtarët e Tij të bindur krijuar që t’i shërbejnë ushtrisë së Tij. Dhe patjetër është se Ai Sulltani zotëron një Sovranitet Absolut.

Ja pra, Ai Sulltani është Zoti Madhështor që nuk ka nevojë as për një send dhe secili send është nën urdhërin e Tij dhe duke u poshtruar ndaj Tij secili send i nënshtrohen Atij.

Tani o njeri! Ajo Mëshirë është që të bën një rob dhe mik të dashur dhe të sjellë para Tij që t’i dëgjosh fjalët e Sulltanit Sovran të pambarim. Por, siç ti që nuk mund të afrosh që të arrish diellin sepse prej tij je shumë i largët. Por dielli me anën e jehonës së tij dhe me anën pasqyrës së tënde të afrohet dhe dritën e tij ta jep në dorë; njësoj, edhe ne megjithëse prej Personalitetit të Sulltanit të Pafillimtë dhe të Pambarimtë jemi në largësinë e pafundme nga ku nuk ka mundësi t’i afrohem Atij, por drita e Mëshirës së Tij ne po na afron tek Ai.

Tani o njeri! Kush mund të gjejë këtë Mëshirë ai ka gjetur arkën e pasosur, dhe shkak më i madh për të arrish Tek Ai, që është Personaliteti, shembulli, gjuha dhe lajmëtari i mëshirës dhe Kur’ani atë Mëshirën trupore e përmend me Titullin e Tij “Mëshira e botërave” I Dërguari fisnik Alejhis-salatu ves-selam. Pra ti mbështetu në rrugën- synnetin e Tij. Dhe për të arritur tek Mëshira e botërave bëji Salavat Atij. Sepse edhe kuptimi i Salavatit është Mëshirë. Ndërsa gjallesat e vetëdijëshme, që të arrijnë në mëshirën trupore, le të lexojnë duanë e rahmetit, pra Salavatit. Meqë është ashtu, ti me salavatit për vehten tënde bën shkak që të arrish tek Mëshira e botërave dhe e bën Atë një shkak që të arrish tek Mëshira e Gjithëmëshirëshmit. Ummeti Mëshirës së botërave me një sasi të madhe bën salavat me fjalën e bukur Es-salatu Ves-selamu Alejke Ja Resulall-llah. Me këtë lutje që bën ummeti kuptohet se salavati është në një sipërfaqen aq të gjerë për ne, sa është një dhuratë e vlefshme e Hyjnisë.

Fund: Siç Pejgamberi Alejhis-salatu Ves-selam është një brilantë dhe një roje i Arkës së Mëshirës së Zotit të Madhëruar, Dhe çelësi i parë i asaj arke është “Bismil-lqahirrahmanirrahimi”. Dhe çelësi më i lehtë është Salavati për Pejgamberin (a.s.m)..

FJALA E 1NJEZETE TRETE

Ky përbëhet nga tri tema Ajet

TEMA E PARË

Bukuritë e BESIMIT ISLAM janë me mijëra: Këto do t’i tregojmë brenda pesë pamjeve: Pamja e parë:

Me dritën e Besimit Islam në zemër njeriu ngjitet në majat më të larta, meriton parajsën (xhennetin).

Me errësirën e mosbesimit njeriu zbret në fundin e errësirës dhe meriton ferrin (xhehennemin). Besimi është lidhje e fuqishme midis njeriut dhe Krijuesit të tij, Allahut xh.sh.. Besimi i lidh ata fort me njëri-tjetrin. Njeriu duke i besuar Krijuesit të tij stoliset me cilësitë më të çmuara dhe në bazë të tyre vlerësohet. Njeriu çmon dhe lartëson veten me Besimin e vet, me përkushtim ndaj vlerave të tij.

Mosbesimi i pret marrëdhëniet e njeriut me Krijuesin e Plotmëshirshëm. Prej kësaj shpëputjeje njeriu zbehet dhe zhvlerësohet deri në atë pikë, sa qëllimi dhe pikësynimi i tij në jetë kufizohet vetëm me vlerësimin e sendeve materiale të kësaj bote. Duhet të dimë se materia është e përkohshme. Ajo shpërbëhet dhe shkon drejt asgjësë, pra drejt zeros. Çdo trup fizik ka për bazë jetën shtazore, d.m.th. asgjënë, hiçin. Për të sqaruar këtë sekret të madh dhe me shumë domethënie po japim një shembull konkret:

Nganjëherë krijimtaria e njeriut në artet e bukura u jep sendeve vlera të veçanta. Sendet në vlerën materiale, ashtu edhe në atë artistike nuk kanë të njëjtën barazi. Ka raste kur vlerësohet në shkallën më të lartë mjeshtëria, por ka edhe raste të tjera, kur vëmendja kryesore i përkushtohet anës materiale. Shpesh ndodh që një copë hekuri e çfarëdoshme nuk ka asnjë vlerë. Pasi të punohet nga mjeshtri, kjo copë hekuri mund të marrë vlerën e një monedhe floriri. Pra është vlera e dorës së mjeshtrit ajo që kushton më tepër se sa lënda nga e cila u krijua sendi. Kjo vlerë mund të shkojë në miliona, kur vetë materiali nuk vlen as pesë lekë.

Duke kaluar koha, vlerat e këtij sendi të prodhuar nga duart e mjeshtrit, ekspozuar në një atelje arturinash, rriten në miliona.

Të njëjtën copë hekuri, po ta punojë farkëtari për ndonjë vegël bujqësie, nuk vlen ndoshta as pesë para. Nëse e ke kuptuar këtë shembull, do të mësosh se njeriu është pra një krijim artistik i Allahut xh.sh. dhe një Mrekulli e rrallë dhe nazike e Tij. Krijimi i fuqisë së Zotit xh.sh. merr këto vlera, sepse tek Ai janë pasqyruar të gjithë Emrat e Bukur me stoli të përsosura.

Zoti xh.sh. e ka krijuar njeriun si një ekzemplar, si një mostër të Gjithësisë. Po qe se njeriu zotëron Dritën e Besimit, atëhere të gjithë elementet e shqisave që janë dhunti e Zotit xh.sh. do të lexohen vetëm nën Dritën e qartë të Besimit. Kjo lidhet edhe me vetëdijen e besimtarëve. Njeriu besimtar, i ndriçuar prej të gjithë Emrave të Bukur të Krijuesit, pasqyron bukurinë e ndërgjegjes së tij të pastër dhe bën të lexueshëm këtë Besim edhe për Gjithësinë.

Besimtari indirekt, me krijimet e tij të matura dhe të logjikshme të thotë: "Shihmëni! Unë jam vepra dhe krijesa e Mjeshtrit të Madh! Mëshira e Tij pasqyrohet tek unë, në të gjithë pamjen time. Tek unë do të vësh re talentin e Krijuesit". Duke e vlerësuar kështu, ky njeri i thjeshtë lartësohet mbi të gjitha krijesat e tjera dhe bëhet një përçues i Mesazhit të Zotit xh.sh. si dhe një mik që meriton paraajsën.

Po qe se shpirtin e njeriut e sundon mosbesimi që shpëput lidhjet e tij me Krijuesin, atëhere stolitë e vyera të Emrave të Bukur Hyjnorë i mbulon errësira e mosbesimit dhe është i palexueshëm, si një shkrim i fshirë. Po qe se harrohet Mjeshtri i një arti të rrallë, edhe vlerat e artit të Tij do të harrohen. Po qe se do të lini në harresë mjeshttrinë e një Mjeshtri absolut, atëhere këtë gjë do ta bëni edhe për çdo lloj krijese që shihni në këtë tokë. Mosbesimtari me shkurtpamësinë e tij mendon se çdo gjë në këtë botë është e rastësishme dhe kalimtare, duke mosvlerësuar në këtë mënyrë edhe artet e Bukura.

Çdo organ shqisor, duke pasur vlerën e një diamanti, rrezaton i përthyer në mijëra thërmija, duke i dhënë vlera materiale dhe jo shpirtërore këtij fenomeni. Siç kemi thënë, qëllimi dhe esenca e filozofisë materialiste është jeta e shkurtër, e cila e ulë njeriun në pozitën e një kafshe, gjithmonë të mbushur me pakënaqësi dhe nevoja të pashtershme. Me kalimin e kohës materia shndërrohet e shkon drejt asgjësë.

E shikon pra se ku e zbret mosbesimi krijesën më të vyer, njeriun, që shkëlqen si diamant?

Pamja e dytë:

Besimi si një Nur plot me dritë, e ndriçon njeriun, ndriçon çdo shqisë, çdo molekulë të qënies së tij, ku në secilën mund të lexosh një Mesash Hyjnor. Kur ndriçon kjo krijesë, e gjithë Gjithësia, katërcipërisht ndriçon. Këtë sekret të Madh më mirë e zbulon ky ajet:29

All-llahu është mbikëqyrës i atyre që besuan. I nxjerr ata prej errësirave në dritë.

Po tregojmë një ndodhi të imagjinuar:

Ndër dy male të lartë varej një urë e tmerrshme. Nën të kalonte një lum i thellë dhe i rrëmbyer. Unë rrija mbi urë. Gjithë botën e kishte kllaposur errësira. Me imagjinatën timë çava errësirën dhe pashë në të djathtë një varr të stërmadh, në të majtë përmes errësirës dallova dallgët e fuqishme që krijonte stuhia. Të paktën mua kështu m'u shfaq. Hodha përsëri sytë nën urë dhe vura re greminën e thellë. Për t'u përballuar me errësirën, në xhep kisha një fener të vogël, të cilin e përdora në këtë çast të vështirë. Nën dritën e tij të vagëlluar pashë gjendjen e mjerë ku ndodhesha. Përreth urës një lukuni ujqërish prisnin me vështrim dhe me gojë të çapëlyer në drejtimin tim. Aty kishte gjithfarë lloj egërsisrash: dragoj, luanë, etj.. Mbase, po të mos kisha këtë fener me dritë të dobët, nuk do të kisha vënë re asgjë. Atë e ktheja në të gjitha drejtimet dhe ngado e njëjta pamje më shfaqej. Me vete thosha: "Ky fener po më bën dëm!" dhe u hidhërova pa masë. Në inat e sipër e përplasa fenerin me sa fuqi që kisha pas gurëve dhe e bëra copë-copë. Kur përplasa fenerin, m'u bë sikur përplasa çelësin e një llambe elektrike, që në çast e shpërndau errësirën dhe të gjithë vendin ku ndodhesha, e mbështolli drita në të katër anët. Kur llamburiti drita, pashë anën e vërtetë të secilit vend. Por çfarë kisha parë në të vërtetë? Ura nuk ishte urë, por një bulevard i gjerë dhe i drejtë në mes të një fushe. Në anën e djathtë nuk kishte varr, por një plantacion të gjelbërt dhe për rreth kopshte të blertë, që i punonin njerëz të mbështjellë nga gëzimi dhe hareja. Ata shprehnin në fytyrat e tyre një ndjenjë të ngrohtë adhurimi. Biseda e tyre ishte e përzemërt dhe gazmore. Ata bënë "dhikër" (përmendnin Zotin) gjatë gjithë bisedës. Ana e majtë, ku më parë kisha greminën dhe ku dëgjoheshin britma të tmerrshme, nuk ishte ashtu. Ajo ishte e hijeshuar dhe e zbukuruar si për festë. Harxhime të mëdha ishin bërë për një gosti, që pritej të shtrohej nga çasti në çast. Kudo shëtisnin njerëzit. Kafshët e egra që m'u shfaqën në errësirë, ishin ca kafshëza të buta dhe të bukura. Aty kishte deve, kuaj, qe, dhi, etj. Kur pashë këtë ndryshim falenderova Zotin, që më dha Dritën e Besimit.

Ajet 29)

Prijsi I Rinise - V

All-llahu është mbikëqyrës i atyre që besuan. I nxjerr ata prej errësirave në dritë.

Kur këndova ajetin e Zotit xh.sh., përnjëherë u zgjova.

Tani po u sqaroj kuptimin e kësaj ndodhie. Njëri mal është fillimi i jetës, kurse tjetri, fundi i saj, pra dy botërat dhe fundi - jeta e varrit.

Ura është rruga e jetës.

E djathta është e kaluara.

E majta është e ardhmja.

Feneri është koka e njeriut që i pëlqen vetëm mendimi i vet, që nuk i përgjigjet mesazheve të Zotit xh.sh., pra është "uni" i vetvetes.

Ato që i quajtmë egërsira, janë ndodhitë dhe ngjarjet e ndryshme të njerëzve.

Kush i beson "un"-it të vet, bie në errësirën e pakujdesisë. Ai që u ngjitet pas atyre që ndjekin rrugën e prapësive, ngjan me atë gjendjen time të fillimit. Drita e fenerit është njohuria e pamjaftueshme e materialistëve, të cilët të kaluarën e çmojnë si një varr të madh. Sipas tyre, jeta shkon nga hiçi.

E ardhmja për sytë e materialistëve duket si një stuhi e tmerrshme, sepse ata janë të verbuar nga mosbesimi dhe e quajnë çdo gjë të rastësishme. Ky mosbesim ua bën atyre të ardhmen si një egërsirë të tmerrshme, që do t'i përlejë nga çasti në çast. Në realitet secili është një nëpunës i Zotit xh.sh. që lëviz nën dritën e Diturës së Tij të Kulluar. Ajet 39)

E kujdestarët e atyre që nuk besuan janë djajtë që i nxjerrin ata prej drite e i hedhin në errësira. Ata janë banues të zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.

Kur në zemrën e njeriut të kenë hyrë udhëzimet e Zotit xh.sh. dhe besimi të jetë rikthyer, duke mos i lënë hapësirë palaçolleqeve dhe djallëzive, atëhere ai do të më ngjajë mua, në gjendjen time të dytë shpirtërore, siç ua tregova më lart nepërmjet imagjinatës. Për të arritur në këtë gjendje shpirtërore, njeriu duhet t'u nënshtrohet urdhërave të Librit të Zotit xh.sh. dhe papritur hapësira do të mbushet me Dritën e Nurit Hyjnor. Në këtë çast Gjithësia duket e qartë. Këtë gjendje e shpjegon ajeti i famshëm: ajet : 30

All-llahu është dritë (ndriçuese, udhëzues) i qiejve e i tokës..

Njeriu i zgjuar, me syrin e zemrës së tij, do ta shohë të ardhmen, e cila nuk do t'i duket si një varr, por si një rrugë plot dritë.

Njerëzit në çdo periudhë i ka drejtuar një Pejgamber i Zotit xh.sh. apo një Evlija i Shenjtë. Ata e kanë udhëzuar popullin me shpirt të pastër dhe me adhurimin ndaj Zotit xh.sh.. Pasi kanë përmbushur detyrën e tyre duke thënë: "All-llahu Ekber", kanë fluturuar në të ardhmen, me pozita të larta, të cilat i kanë merituar duke bërë të mira në këtë jetë.

Në të majtë, do të vësh re shndërrime të çuditshme, vila luksoze dhe vreshta të begata të xhennetit, të përgatitura për kënaqësinë e njerëzve. Aty do të shtrohen gosti hyjnore për të gjithë besimtarët. Me Dritën e Besimit do të shohësh se si do të shndërrohen të gjitha ato dukuri që ndodhin në jetë si: stuhitë, tërmetet dhe murtaja, në gjëra krejt të vlefshme. Me Dritën e Besimit stuhitë dhe shirat e furishëm në stinën e pranverës janë mjaft dobiprurës dhe një argument i Mëshirës së Kulluar të Zotit xh.sh..

Pra, për besimtarin edhe vdekja quhet si

fillimi i kënaqësive të përjetshme, bile varri është si një portë për të kaluar tek kjo shtëpi përrallore.

Pamja e tretë:

Besimi është Dritë (Nur) dhe Fuqi.

Kush e zotëron Besimin e vërtetë, nuk i trembet askujt dhe asgjëje. Për të zotëruar këto cilësi duhet të thotë: "Tevekkeltu Alall-llah", që domethënë: "Mbështetem tek Zoti, për të gjitha presionet, shantazhet dhe problemet që kam". Vetëm në këtë mënyrë mund të shpëtoj pa marrë

asnjë goditje në anijen e jetës, që përplasen midis dallgëve e trishtuar. Me një siguri të përsosur, besimtari do t'i soditë ngjarjet dhe fenomenet e botës së bashku me peshën e rëndë të jetës, duke qenë i ndërgjegjshëm se të gjitha këto janë kurdisur nga ana e të Plotfuqishmit të Plotmëshirshëm. Njeriu e di fort mirë se fuqia e tij nuk mund të mposhtë kurrgjë, prandaj përulet nën pushtetin e Zotit xh.sh., që kështu të largohet nga kjo botë e qetë dhe pa probleme. Ai largohet nga kjo botë për të pushuar përjetësisht në jetën e varrit. Pastaj duke "fluturuar" hyn në parajsë.

Nëse nuk i je bindur Zotit xh.sh., atëherë të gjithë peshën e jetës e ke mbi shpatulla dhe ndoshta kjo të zhyt në thellësinë e xhehennemit.

Domethënë, njeriu duhet të besojë se Zoti xh.sh. është Një dhe i Vetëm. Ai duhet të mbështetet dhe t'u bindet urdhërave të Zotit xh.sh. dhe pikërisht, kjo bindje mundëson kënaqësinë e të dy jetëve.

Sidoqoftë mbështetjen dhe bindjen ndaj Zotit xh.sh. mos e mendo si një sakrificë për të fituar të drejta më shumë, por si një mundësi të analizosh shkaqet dhe arsyet dhe të besosh tek Ai. Mbase të duhet që shkaqet dhe arsyet t'i pranosh, si perde përpara fuqisë së Zotit xh.sh..

Përdorimi i shkaqeve apo arsyeve në vetvete është një farë lutjeje, e cila bëhet përmes punës dhe më vonë pret rezultatin prej Zotit xh.sh.. Mirënjohjen për këtë realizim duhet t'ia shprehësh vetëm Atij dhe askujt tjetër. Këtë të vërtetë e kuptojmë më mirë nga ky shembull:

Në kohëra shumë të lashta jetonin dy njerëz. Një ditë, pasi prenë nga një biletë, hipën në një anije për të bërë një rrugë të gjatë. Njëri nga ata, pasi e lëshon barrën e vet diku në anije, ulet edhe vetë mbi të. I lehtësuar nga pesha ai hedh sytë në të majtë dhe në të djathtë duke soditur pejsazhin e mrekullueshëm.

Tjetri, që ishte pak si fyçkë nga mendja, vazhdon të mbajë peshën e vet mbi shpinë. Shoku i thotë: "Hej bre, pse nuk lehtësoshesh prej barrës që ke mbi shpinë?"

Mëndjelehti ia kthen: "Jo, nuk mund të bëj ndryshe. Unë jam ca i fortë dhe barrën e mbaj mbi shpinë, që mos të më humbasë". Përsëri shoku i thotë: "Kjo anije e Mbretit, që po na mban është më e fortë se ne. Mbi anije barra do të jetë më e sigurtë dhe më e mbrojtur. Ty, mbase të trulloset koka prej barrës dhe bie mbi valë së bashku me ngarkesën që ke mbi shpinë. Gjatë rrugës forca të humbet dhe me lartësinë e trupit që ke, duke u kolovitur majtas dhe djathtas dhe me mëndjelehtësinë tënde, do të biesh sëbashku me ngarkesën. Ti do të mërzhitësh timonierin dhe ai do të dëbojë apo të shajë, duke të quajtur shpirtkeq, sepse po nënvleftëson anijen e tij me kryeneqësinë tënde. Ka mundësi që ai të urdhërojë punëtorët e t'u thotë: "Burgoseni këtë mendjelehtë!" Në këtë rast, ti i shëmbëllen një njeriu maskara, sepse për njerëzit e kulturuar sjellja jote tregon dobësinë e karakterit tënd. Kështu shfaqet pafuqia jote, sedra e sëmure, hipokrizia dhe poshtërsia e sjelljes tënde artificiale. Nuk e kupton se sa bajat u bëre para njerëzve për rreth!? Ata po qeshin me ty."

Pas këtyre fjalëve njeriu u pendua, i thirri mendjes dhe hodhi mbi anije barrën e rëndë të plaçkave duke thënë: "Zoti të mëshiroftë! Tani shpëtova nga burgu i mendimeve të këqija dhe nga rruga e pamoralshme".

O njeri, që nuk i bindesh Zotit xh.sh.! Ti i ngjan këtij personi që treguam më lart. Mblidhe mendjen dhe bindju deri sa të shpëtosh nga pozita e një lypësi ku ke rënë dhe të mos lëkundesh nga trishtimi i jetës! Mundohu të shpëtosh nga pesha e kokës, nga mizerja dhe vuajtjet. Mendo për Jetën e Mbrapme si dhe për detyrimet e kësaj jete.

Pamja e katërt:

Që njeriu të bëhet me të vërtetë njeri, i duhet Besimi. Ky besim i jep atij shansin të bëhet sulltan,

mbret. Për të mos humbur këtë fat, detyra parësore e njeriut është: Të besuarit dhe të luturit ndaj Zotit xh.sh., Krijuesit të tij. Mosbesimi e ul njeriun në rangun e një kafshe të egër dhe të dobët. Ky fakt dhe tregimi i mëparshëm bëhet i besueshëm dhe i argumentuar katërcipërisht. Me ardhjen e njeriut dhe të kafshës në këtë botë, vihen re dallime. Duke krahasuar të veçantat e ardhjes së njeriut dhe të kafshës, do të kuptojmë se njeriu vetëm nëpërmjet Besimit mund të arrijë cilësitë e nevojshme.

Kafsha në këtë botë është e pajisur me të gjitha vetitë dhe cilësitë e një kafshe. Ajo nuk e ka të vështirë që brenda dy orëve apo muajve të njohë dhe reflektojë ndjesitë e realitetit ku jeton. Ndërsa njeriu i duhen njëzet e ca vjet të njohë veçoritë e jetës së vet, kur miza apo një zog mali ato i mëson për njëzet ditë.

Domethënë çdo tipar i secilës kafshë, frymëzohet dhe udhëhiqet nga Zoti xh.sh.. Nga kjo kuptojmë se kafsha si detyrë parësore nuk ka që çdo dhunti ta arrijë nëpërmjet studimit. Ajo nuk përparon duke mësuar dhe pasi të ketë kuptuar dobësinë e vet, të lutet. Sigurisht që, detyra e saj është që simbas aftësive të punojë, veprojë dhe në këtë mënyrë ajo të shprehë adhurimin e vet ndaj Allahut xh.sh., Krijuesit të vet.

Me ardhjen e tij në këtë botë, njeriu e ka të nevojshme të marrë njohuri për çdo send dhe është tepër i paditur ndaj ligjeve të jetës. Mbase edhe për njëzet vjet të jetës së vet ai nuk do të jetë informuar mbi të gjitha ligjësitë dhe të fshehtat e ambientit ku jeton. Procesi i njohjes do ta shoqërojë atë deri në fund të jetës së tij, sepse nevojat e tij nuk kanë fund. Shpeshherë, ai do të ndihet i pafuqishëm dhe i pazoti për t'u përballuar me vështirësitë e jetës. Në këtë botë njeriun Zoti xh.sh. e ka dërguar që të mësojë deri në momentet e fundit të jetës. Nga pafuqia dhe dobësia e vet ai brenda një apo dy vjetësh do të ngrihet në këmbë. Pas pesëmbëdhjetë vjetësh mund të jetë në gjendje të dallojë të mirën nga e keqja. Po qe se e ndihmon dikush, ai mund të marrë nga ana e të mirave dhe të braktisë të këqijat.

Detyra parësore e njeriut është të arrijë përsosmërinë duke studiuar dhe mësuar, duke u lutur dhe adhuruar.

Njeriu duhet të kujtohet se me mëshirën e kujt ka ardhur në këtë botë dhe kush ia ka dhënë atij përsosmërinë e pakursyer. Ai duhet t'i drejtohet vetes: "Me Bujarinë e kujt po edukohem si jo më mirë? Nga po më vjen kjo fisnikëri që po më ushqen kaq bollshëm dhe po më kuron nga sëmundjet?"

Prej mijëra krijesave, vetëm njeriu ka shansin që me gjuhën e varfërisë dhe dobësisë së tij, duke u lutur ta kthejë fytyrën nga Ai, që gjithmonë lexon këtë gjuhë dhe ia pranon lutjet sipas nevojave që ka.

Njeriu me krahët e pafuqishëm dhe me varfërinë e tij, nëpërmjet Besimit tek Zoti xh.sh. dhe lutjeve ndaj Tij, mund të fluturojë në majat më të larta të hapësirave.

Njeriu në këtë botë ka ardhur që duke studiuar të mësojë dhe me lutje e besim tek Zoti xh.sh., të përsoset vazhdimisht. Cilësitë dhe aftësitë e çdo gjëje varen nga dituria që njeriu ka ardhë për të, bile miniera, drita dhe shpirti i të gjitha diturive të vërteta, është prania dhe dijenia e ekzistencës së Zotit xh.sh., "Marifetull-llah" (zgjerimi i diturisë në ekzistencën e Tij), thelbi i të cilit është Njësimi i Zotit xh.sh. si Një dhe vetëm Një.

Njeriu është i pajisur me pafuqi dhe varfëri të pafundme. Atij gjithë jeta i duhet për t'u pajisur dhe kompletuar, për t'u përballur me vështirësi të mëdha dhe të pallogaritshme. Ky vlerësim i tij të lë të kuptosh se për të përmbushur detyrat e tij të pashtershme dhe për të ekuilibruar pafuqinë e tij, njeriu si detyrë parësore ka Besimin e pastër ndaj Krijuesit të tij, Zotit xh.sh.. Atij duhet t'i lutet përjetësisht. Baza e duasë, lutjes, është adhurimi, ashtu si dora e një fëmije, e cila, që në fillim të jetës së vet nuk mund të plotësojë nevojat e veta më elementare. Për të përmbushur

kërkesat e tij fëmimore ai qan apo grindet, gjersa prindërit t'ia plotësojnë ato. Kjo duhet kuptuar se jo vetëm me veprim, por edhe me gjuhën e paaftësisë ai lutet në një farë mënyre. Kështu fëmija i arrin qëllimet e veta.

Edhe i rrituri në një farë mënyre i ngjan atij shembulli. Ai midis qënieve të gjalla është më naziku dhe më i përkëdheluri. Ngjan shumë me fëmijën e vet. Do apo nuk do, në derën e Mëshirës së të Plotfuqishmit do të trokasë. Me dobësinë apo pafuqinë e tij ai do të shkojë drejt saj për të plotësuar qëllimet dhe dëshirat e veta. Për të arritur këto nevoja njeriu nuk duhet të qajë si fëmijë, por do të lutet tek Krijuesi i tij. Duhet që nëpërmjet lutjes t'i shprehë Atij mirënjohjen dhe falënderimin, për të gjitha ato qëniet, që i ka vënë në shërbim. Të veprosh ndryshe, pra të mos shpallësh këto falenderime ndaj Zotit, nuk është brenda logjikës njerëzore. Nuk duhet të bëhesh si një fëmijë që në njërin anë ulërin prej pickimit të një insekti dhe nga ana tjetër në inat e sipër thotë që: "Unë me fuqinë dhe logjikën time i bëra të më shërbejnë mua këto qenie, edhe pse janë disa herë apo disa mijëra herë më të mëdha dhe më të fuqishme se unë. Me logjikën time këto qenie të pasjellshme i bëra të nënshtrohen dhe binden ndaj meje!"

Të pranosh këtë fakt, ti bën një çmenduri dhe bukëshkalje, duke mohuar cilësitë njerëzore, të cilat nuk pajtohen me vlerësimin tënd dhe nuk meriton veçse një dënim të tmerrshëm.

Pamja e pestë:

Besimi, për të plotësuar detyrën e krijimit të njerëzve, e bën të nevojshme lutjen. Këtë e ka saktësuar Kur'ani me ajetin:31)

Thuaj: Zoti im as nuk do të kujdesej për ju, sikur të mos ishte lutja juaj.

Me ajetin tjetër e urdhëron njeriun të lutet:Ajet 32)

Më thirrni mua, Unë ju përgjigjem.

Por, po qe se njeriu e zë në gojë shpesh këtë fakt, duke thënë se po lutem, por lutja nuk po më pranohet, ky ajet në përgjithësi përgjigjet: "Secila lutje ka një përgjigje". Atëherë ju replikoni: "Të përgjigjesh është një gjë dhe të pranosh është gjë tjetër". Secila lutje ka një përgjigje, por për ta pranuar këtë dhe për të dhënë pikërisht atë që kërkon, kjo nuk përputhet me Diturinë e Tij Absolute". Për shembull: Një fëmijë i sëmurë bërtet: "O doktor, shikoma pak plagën dhe më jep këtë ilaç!" Dhe mjeku, pasi dëgjon ankesën, i jep ilaçin e duhur duke ia plotësuar kërkesën, por duke iu referuar shkencës së mjekësisë. Mjeku e di fare mirë se fëmijës i nevojitet ilaç tjetër për kurimin e dhimbjeve, një ilaç më i efektshëm, ndërsa ilaçi që kërkon fëmija, nuk bën efekt, ndaj dhe mjeku nuk ia jep, edhe pse i lutet. Pra

All-llahu i Madhërishëm, ngaqë është Mbizotërues Absolut dhe Mbikëqyrës, secilin nga robtë e Vet nuk ia lë lutjen pa përgjigje. Në qoftë se ndokush është në gjendje të trishtuar, All-llahu atij i paraqitet shpirtërisht duke i thënë: "Robi im, mos u trishto dhe mos u frikëso! Unë, Krijuesi yt, jam pas teje!" Zoti më mirë se kushdo tjetër e di se cila nevojë duhet përmbushur më parë, sepse kjo lidhet me Diturinë e Tij të Kulluar dhe të Mrekullueshme. Ia plotëson apo jo kërkesën dikujt, kush mund ta dijë më mirë se Ai?

Lutja ndaj Zotit xh.sh. është një adhurim (ibadet) dhe frutet e saj do të vilen në jetën e ardhshme. Me lutjet tona (duatë) ne përcaktojmë edhe qëllimin e tyre të menjëhershëm. All-llahu më mirë e di se çfarë vlere kanë ato për këtë jetë apo për jetën e ardhshme. Çdo lutje ka kohën dhe qëllimin e vet. Kërkesat nuk janë qëllimi kryesor i lutjes. Për shembull, lutja që bëhet për të rënë shi, më tepër se kërkesë është koha e një adhurimi për All-llahun. Thatësia është koha e saj reale, pra e Adhurimit, dhe lutjet nuk janë për të sjellë shiun. Është e vërtetë se, në qoftë se këto lutjet kanë

pasur si qëllim kryesor rënien e shiut, atëhere kuptohet se në to ka munguar sinqeriteti ndaj Zotit xh.sh., e si rrjedhojë nuk miratohet lutja e tyre. Njëlloj të gjithë e dimë se me perëndimin e diellit ka ardhur koha e faljes së namazit të mbrëmjes, ndërrimi i diellit me hënën përcakton ato kohë të veçanta që quhen "Kusuf" dhe "Husuf" dhe që janë dy kohë të ndryshme adhurimi.

Domethënë me argumentet e veçanta të natës dhe të ditës, kur Madhëria e Tij dritën e shndritshme e mbulon me errësirën e zezë, do t'iu kujtojë robëve të Vet se është koha kur duhet të bëjnë adhurimin e tyre. Nuk është e thënë që, pikërisht këto dy lloj adhurimesh bëhen me qëllimin e vetëm që të agojë dita apo të vijë nata. Edhe shkencërisht dihet se errësira është e kufizuar. Ajo do të vazhdojë derisa të agojë dita e re.

Po kështu, thatësira ka kohën e lutjes dhe të adhurimit të vet. Në mënyrë të njëjtë, pllakosja e fatkeqësive, apo sulmi i egërsirave ka kohën e vet të përcaktuar, ku All-llahu xh.sh. e fton njeriun të pranojë dobësinë e tij dhe me anë të lutjeve të adhurimit të mbështetet tek Ai. Megjithëse ne shumë lutemi dhe fatkeqësitë nuk mbarojnë, kjo nuk do të thotë se lutja jonë nuk është pranuar. Mbase është më mirë të themi se nuk ka ardhur koha kur lutja të na pranohet. Në qoftë se Zoti e tërheq fatkeqësinë nga ne, gjatë kohës që ne jemi lutur dhe kemi bërë adhurimin tonë, kjo është akoma më mirë dhe koha e lutjes në këtë çast merr fund, sepse nevoja u zgjidh.

Domethënë, lutja në vetvete përmban një lloj sekreti të adhurimit. Adhurimi duhet të jetë i singertë dhe i pastërt ndaj Zotit xh.sh. dhe për Hirën e Tij. Pra gjithmonë duhet besuar në Mëshirën e Zotit, në kujdesin e Tij, sepse Ai ka një Dituri të Kulluar dhe universale. Mos të dyshojmë kurrë në këtë të Vërtetë Absolute. Me këto argumente qiellore, tepër reale, vërtetohet se të gjitha krijesat e All-llahut bëjnë nga një "tespih" dhe adhurim të veçantë. Secila nga ato bën një "sexhde", gjë që do të thotë se çdo qenie, sipas mundësisë dhe gjendjes së vet, lutet dhe bën dua ndaj All-llahut xh.sh..

Si shembull mund të sjellim bimët dhe kafshët, të cilat me një gjuhë dhe aftësi të veçantë, kërkojnë nga Krijuesi një fytyrë të vetën, ku të pasqyrohen të gjithë Emrat e Bukur. Gjithashtu, secila krijesë me gjuhën e nevojës, për të arritur sukses dhe për të vazhduar jetën e mëvonshme, në mënyrë të veçantë shprehin kërkesat e tyre ndaj Fisnikut. Për të përmbushur këto kërkesa të domosdoshme jetësore, ato përpiqen që duke u lutur t'i përmbushin ato, në formën e ushqimit, sipas aftësisë së tyre. Po me gjuhën e paaftësisë, ato bëjnë një lloj duaje për të shpëtuar nga fatkeqësitë. Çdo qenie që është me shpirt kërkon mbështetjen e fortë të All-llahut xh.sh..

Këto tri lloj lutje, në qoftë se diçka nuk i bëhen peng, gjithmonë janë të pranuar.

Lloji i katërt është lutja jonë e cila është edhe më e fuqishme. Ajo ndahet në dy pjesë:

- Njëra lutje është me punë dhe mirëqenie.

- Tjetra, me zemër dhe me gojë.

Po japim një shembull:

Njeriu nga Krijuesi kërkon me gjendjen e tij. Ai duke lëvruar tokën e ka bërë trokitjen e parë në Arkën e Zotit xh.sh.. Këto lloj lutjesh që bëhen me punë dhe janë të mbështetura nga funksionet e Emrave të Bukur të Fisnikut Absolut, shumë rrallë mund të ndodhë që të mos pranohen.

Me gjuhë dhe zemër njeriu duhet t'i lutet Zotit, për ato nevoja apo kërkesa, ku dora dhe mendja e tij nuk arrin. Fruti më i rëndësishëm i kësaj lutjeje është se, ai që lutet e kupton që është "Një", që dëgjon gjithçka që kalon nëpërmes zemrës së tij, pra Zoti xh.sh., i Cili i vlerëson mendimet e mia. Dora e Tij arrin të plotësojë çdo dëshirë, sado e vogël qoftë, duke mëshiruar dobësinë. Ai i gjen shërimin varfërisë sime.

Shiko pra o njeri i pafuqishëm dhe i varfër! Mos e hiq nga duart këtë mundësi, që është çelësi i Thesareve të Mëshirës dhe një levë e zotërimit të një force të pashterruar. Nëpërmjet kësaj leve ngjitu dhe ngrihu në kulmin e lartësive të njerëzimit. Bëhu si një mbret që i tërheq nga vetja

lutjet e Gjithësisë, ku lutja jote të përzihet me mijëra të tjera. Bëhu një rob i përgjithshëm dhe njëkohësisht një përfaqësues i të gjithëve. Atëhere do të bëhesh si një shembull i bukur i Gjithësisë! Kur thua:

Ajet:

Tek Ti ndihmë kërkojmë.

TEMA E DYTË

Njeriu është krijuar si shembull i bukur. Atij i është dhënë një aftësi e rrallë dhe e gjerë.

Hapësirat e dijeve të tij janë universale. Ato

radhiten nga e rëndomta, deri tek gjenialja, nga shtresa më e ulët, deri tek ajo më e larta. Tek ai janë gdhendur një mori karakteresh, që nga më i ligu, deri tek më i moralshmi (arshi ala).

Bota e njeriut ndryshon radhë pas radhe, duke filluar nga grimca më e padukshme dhe deri tek dielli gjigand. Njeriu i ka në dorë të gjitha çelësat e shkallëve për të arritur në sferat më të larta apo në të kundërt, për të zbritur në thellësitë me të errëta. Kjo tregon se njeriu nuk është unik dhe i njëtrajtshëm. Kapaciteti dhe mentaliteti i tij ndryshon, ç'ka do të thotë se ai është në evolucion dhe ndryshim të vazhdueshëm, drejt përsosmërisë apo rëndomësisë së tij.

Me këto prova të pandërprera njeriu do të jetë në gjendje të përballet çdo çast. Përpara tij shtrihen dy rrugë dhe ai do të jetë i detyruar të zgjedhë atë më të mirën, rrugën drejt lumturisë së përjetshme, apo rrugën e vuajtjeve të pambarim. Ai që është krijuar si një mrekulli e Zotit xh.sh. dhe si një krijesë e çmuar dhe e vetëdijshme, a do të dijë se cilën rrugë të zgjedhë? Apo në këtë zgjedhje të tij do të anojë nga veset, si disa njerëz që humbin në këtë botë? Njeriu duhet të jetë largpamës dhe i zgjuar, sepse është krijuar si përfaqësues i Gjithësisë.

Tani, brenda pesë pikave do të rendisim arsyet e zhvillimit të njeriut dhe shkaqet e prapambetjes së tij.

Pika e parë.

Njeriu është një krijesë e bukur, e pajisur me aftësi të shumanshme. Nevojat e tij janë të shpërndara në të gjitha fushat e jetës, dëshirat e tij shtrihen deri në përjetësi. Ashtu siç e do një lule të vetme, do edhe të gjithë pranverën madhështore. Siç do dhe kënaqet me bukuritë e një kopshti të vogël, po ashtu edhe parajsën madhështore e dëshiron. Siç ka dëshirë dhe mall të takohet me shokun e tij më të dashur, po ashtu ka dëshirë të njihet dhe të shohë me padurim të madh edhe Zotin e Lartmadhërisë dhe të Bukur.

Siç ka dëshirë të vizitojë shtëpitë e farefisit të tij, ashtu ka dëshirë të takohet me nëntëdhjetë e nëntë përqind të dashamirëve që kanë vdekur prej kohësh dhe tani janë në jetën e përtej varrit. Është në dobinë e njeriut të shpëtojë nga ndarja e përjetshme duke u mbështetur tek Fuqiploti, që mund t'i mbyllë derën e kësaj bote. Fuqia e këtij Zoti arrin deri atje, sa t'i grumbullojë të gjithë këta njerëz në një Mah'sher të Çuditshëm, në jetën e ardhme: një tërësi botë ta sajë dhe tjetër në të përjetshmen ta dërgojë.

Në këtë gjendje që ndodhet njeriu, nuk i mbetet gjë tjetër, veçse ta adhurojë Atë që ka në dorë frenin e secilit send, në duart e të cilit

ndodhen arkat e thesarit të pambaruar, Atë që vend nuk ka dhe kudo ndodhet, që është i gatshëm dhe larg pafuqisë dhe dobësisë, të cilit nuk i gjendet asnjë e metë dhe që ndodhet përmbi të gjitha lartësitë. Ai duhet adhuroar dhe lavdëruar në çdo çast.

Për njeriun Zoti është Një dhe i Vetëm, Fuqizor dhe Ngadhënjimtar, Mëshirëplotë, i Bukur dhe

Sundimtar i Përsosur, sepse Ai pa asnjë të metë plotëson çdo nevojë të njeriut, ngaqë Fuqia dhe Dituria e Tij është e Pafundme.

Meqenëse e Vërteta është vetëm një, vetëm Atij, All-llahut xh.sh. i falemi (i bëjmë ibadet).

Tani o njeri, a e kupton se je rob vetëm i Atij dhe nga të gjitha qëniet ti ke përfituar një pozitë më të lartë? Në qoftë se nuk e adhuron Atë, atëhere je ende një rob i ulët dhe nën nivelin e krijesave të palogjikshme. Po qe se mbështetesh tek "uni" dhe aftësia jote, duke braktisur mbështetjen tek Zotit i Madhëruar xh.sh.. dhe duke ecur në rrugë të gabuar, një ditë do të përfundosh në ferr. Kryelartësia jote duke adhuruar vetveten, duke thënë se çdo gjë "e bëj unë", do të të lërë në rrugë pa krye. Aftësia jote dhe bëmat e tua s' do të kenë as vlerën e krahut të bletës apo të milingonës. Si rrjedhim, do të të duket vetja i dobët dhe i mjerë, sa një merimangë apo mizë. Barra e ligësive të tua është aq e madhe dhe e rëndë, sa pesha e një mali të lartë, apo sa dëmi i sëmundjes së murtajës.

Pra o njeri, ti ke dy rrugë:

E para, krijim, ekzistencë, dobi, realizim, veprimtari...dhe...

E dyta, rënie, shkatërrim, grindje, mosrealizim, dhe vendqëndrim vagabondash.

Në rrugën e parë, me aftësi je më poshtë se bleta apo zogu i malit, më i pafuqishëm se merimanga. Kur të kalosh në anën tjetër, atëhere fuqia jote i kapërcen edhe malet, edhe qiejt. Barrën më të rëndë, që malet s'kanë mundur ta ngrenë, pra amanetin e Zotit xh.sh., pa frikë e merr mbi shpinë. Pas kësaj, me fuqitë e tua mundohesh të shfrytëzosh një sipërfaqe të gjerë sa të gjithë qiejt dhe malet. Kur ke si qëllim të bësh mirë, mund të bësh aq sa të arrijë krahu apo forca jote. Në qoftë se ti o njeri, priresh nga e keqja dhe e bën atë, atëhere do të sjellësh vetëm shkatërrim, dhe dhunë, duke përhapur panik. Mosbesimi është si një konglomerat i paditursë dhe i pavërtetësisë së fenomeneve. Kjo e keqe e madhe e poshtëron Gjithësinë, Emrat e Bukur dhe mbi të gjitha është një e keqe që tërë qëniet i nenvlerëson, sepse për çdo gjë mohon Mjeshttrin e saj. Mosbesimi njeriun e hedh në nivelin më të ulët dhe e poshtëron. Të gjitha krijesat që kanë një rang të lartë pranë Zotit xh.sh. dhe janë ngarkuar për përmbushjen e detyrimeve ndaj Tij, janë një Mesazh i Bukur edhe pse janë vendosur në rangun e lartë, me një detyrim të caktuar, si një Mesazh i Bukur dhe si një farë nëpunësash të Tij, mosbesimi i ul ata në nivelet më të rëndomta dhe më të pakuptimta. Në këtë rast atyre u hiqet e drejta e pozitës dhe nuk mund të jenë më pasqyrues të Zotit dhe Përfaqësues të funksioneve të Emrave të Bukur. Pra, mosbesimi zhvlerëson qënien e tyre si krijesa të preferuara dhe i shndërron në sende të zakonshme dhe të pavlera. Ai i hedh ata në harresë dhe veçim, duke i konsideruar si të përkohshëm, që shumë shpejt do të shkatërrohen dhe prishen duke shkuar drejt hiçit. Sikur të mos mjaftonte kjo, njeriu ngaqë është krijesa më e përkryer, pasqyron Emrat e Bukur të Zotit xh.sh. e megjithatë Ai i refuzon ato. Nuk mund të mohojmë faktin se kjo krijesë, njeriu, është një pasqyrë e të gjithë Emrave të Bukur, që krahasohet me një vjershë të këndshme dhe të mrekullueshme, ku spikat dëshira e kulluar e Zotit xh.sh. që mban në vetvete farën dhe të gjitha cilësitë e pemës së Përjetshme. Ky njeri pra ka marrë mbi shpinë Amanetin e Madh, pra Mesazhin e Madh, Kur'anin dhe me këtë përkushtim ngrihet mbi malet dhe lartësohet nepër të gjithë qiejt, me bindjen e tij ndaj Krijuesit të vet. Njeriu i tejkalon engjëjt dhe është Kalif, mëkëmbës në këtë botë. Duke qenë në këtë rang kaq të lartë, mosbesimi atë e rrëzon në nivelin më të dobët, e bën më të varfër dhe më të përkohshëm.

Në këtë mënyrë kjo krijesë kthehet në një figurë të pakuptimtë dhe të koklavitur, si një panoramë që së shpejti do të prishet. Ai mund të kthehet shumë shpejt në një send që dekompozohet dhe humbet përjetësisht.

Përmbledhje

"Nefsi emmare" (dëshirat nga të këqijat) i detyron veset që ta shtyjnë njeriun të bëjë krime të vazhdueshme. Aftësia e këtij njeriu për punët e dobishme është e kufizuar dhe e papërfillshme. Ai shtëpinë që mezi e ndërton për një vit, e rrëzon për një ditë. Por ky njeri, në qoftë se e braktis "un"-in dhe kërkon mbështetje tek Zoti xh.sh. për punë të suksesshme, pa menduar kurrë grindjet dhe turbullirat, pendohet dhe bëhet rob i devotshëm.
Ajet: 33)

All-llahu të këqiat i shndërron në të mira.

Atëhere All-llahu edhe këtij njeriu ia shkëmben aftësitë shkatërruese me ato të dobishme. Këtë sekret e sqaron ajeti i mësipërm, kur thotë që njeriu në këtë çast merr vlerat e "formës më të bukur" dhe arrin në kulmin e lartësive.

Tani o njeri i pakujdesshëm! Është e mundur që një mëkat të regjistrohet si njëmijë dhe të mirat fare të mos shkruhen. Por shiko Bujarin e Gjithmëshirshëm që me drejtësi duke e dashur njeriun dhe duke e çmuar, për çdo mëkat shkruan vetëm një, kurse për çdo të mirë shkruan dhjetë, shtatëdhjetë, shtatëqind apo shtatëmijë. Për sa thamë kuptohet që, po të hysh në ferrin e tmerrshëm është një dënim i veprimeve tua, i gjykuar me një Drejtësi të Pastër, por hyrja në Parajsë është vetëm një mëshirë e Zotit xh.sh..

Pika e dytë

Njeriu ka dy detyra:

Njëra, duke u kthyer nga "un"-i është e predispozuar vetëm për këtë jetë. Tjetra, duke adhuruar All-llahun është kthyer nga Jeta e Përjetshme.

Në rastin e parë, kur fytyra drejtohet nga "un"-i, krijesa është në gjendje të mjerueshme. Kapitali i saj është sa një qime koke dhe me aftësinë që ka prej jetës, shumë pak përfiton (ajo së shpejti do të shuhet si një dritë e vagëlluar). Atij jeta do t'i duket e shkurtër dhe trupi do t'i kalbet shumë shpejt. Në këtë rast, ky njeri kudo që gjendet, në hapësirat e Gjithësisë, nga të gjitha llojet e qënieve të panumërta është një individ nazik dhe i dobët.

Në gjendjen e dytë, kur adhurimi i kushtohet All-llahut, kur e pranon varfërinë dhe dobësinë e vet, atëhere horizonti i tij zgjerohet. Vlera dhe rëndësia e tij rritet, sepse dihet që Krijuesi i Madhërueshëm, midis cilësive shpirtërore të njeriut ka futur edhe dobësi dhe varfëri të pafundme.

Pse i di dhe i njeh këto cilësi, njeriu duhet të pranojë Fuqinë e Pafundme të Fuqizorit të Mëshirshëm dhe të çmojë pasurinë e Tij të Begatë, e atëhere ky njeri bëhet si një pasqyrë e madhe e shfaqjes së Zotit xh.sh.. Pra njeriu i ngjan farës. Ashtu siç i jepen farës prej Fuqisë së Tij, aftësitë, mundësitë, mjetet dhe elementet e vlefshëm nga kaderi, caktimi i Zotit xh.sh., po kështu i jepen edhe njeriut të gjitha mundësitë. Atij i është dhënë një program i hollë dhe i studiuar, si asaj farës, që i është dhënë një ndërtim i përshtatshëm që të mund të punojë nëntokën e fortë dhe duke e zgjeruar shtegun e ngushtë të lartësohet në ajrin e pastër duke u bërë një pemë madhështore. Po nëse kjo farë për shkak të karakterit të keq cilësitë e vlefshme që i ka falur Zoti i shpërdoron dhe atje në tokë disa elementë keqbërës e tërheqin pas vetes, ajo shumë shpejt, atje në follenë e saj, do të kalbet.ajet: 34

Zbërthyes i farës (i kokrrës së saj) dhe i bërthamës (së pemës).

Po nëse fara cilësitë e vlefshme i përdor nën urdhërin e ajetit, nga ai shteg i ngushtë do të dalë dhe nga ajo do të rritet një pemë e madhe, me fruta të shijshme. Duke qenë një qenie e vogël me shpirt të padukshëm, do të arrijë tek një e vërtetë kolosale. Njëlloj si këto që thamë, edhe njeriut i

janë dhënë nga Fuqia e Mëshiruesit cilësi tepër të çmuara dhe "Kaderi i caktimit të Tij", tek kjo krijesë ka programuar një veprimtari tepër të vyer. Po nëse ky njeri këto vlera i vendos nën dëshirat e tij vulgare dhe të ulëta në këtë jetë të shkurtër, duke iu bindur veseve personale dhe të përkoshme, atëhere ky njeri, si ajo fara e kalbur do të vdesë duke vuajtur në këtë jetë të shkurtër. Për këtë fatkeqësi përgjegjësinë duhet t'ia ngarkojë shpirtit të vet, kur të ndahet nga kjo botë. Po nëse aftësinë e vet kjo farë me "ujin" e fesë Islame e vadit, me Dritën e këtij Besimi e ndriçon dhe me pasionin e adhurimit e edukon duke u mbështetur nën urdhërat e Kur'anit, atëhere fytyrën e cilësive të veta e kthen nga qëllimet e tij.

Atëhere me të vërtetë, në këtë jetë dhe në jetën e varrit kjo farë do të rritet dhe do të lëshojë degë dhe në Jetën e Perjetshme do të arrijë përsosmërinë e pafundme. Begatitë (nimetet) e saj do të jenë të pallogaritshme dhe fara do të japë prodhimin e dëshiruar me fruta të shndritshme, duke u bërë në tërë Gjithësinë një pemë e bekuar. Progresi i vërtetë është të kthesh fytyrën e dhuntive nga Ai ku ndodhen zemra, sekreti, shpirti, mendja, bile edhe imagjinata. Kur të mendosh për jetën e ardhshme do të kujtoresh të bësh adhurimet si një detyrë e vërtetë dhe e domosdoshme, domethënë që secila shqisë të përdoret për atë qëllim dhe vend për të cilin është krijuar. Përkundrazi, mosbesimtarët zhvillimin mendor e quajnë përparim dhe thonë, pa vënë re se kush është haram dhe kush hallall, se duhet të përfitosh prej të gjitha gjërave të shijshme, pa i quajtur turp ose të turpshme. Njeriu mendjen, zemrën dhe të tjera organe, duke i lënë në dorë të veseve dhe nefsit, e quan këtë përparim. Jo, ky nuk është përparim, por një dështim i madh, një katastrofë njerëzore. Kjo e vërtetë sqarohet me një ngjarje të imagjinuar:

"Hyra në një qytet të madh. Aty kishte

pallate dhe vila luksoze. Nga porta e disa prej vilave shpërndahej një gazmend i madh dhe i ndritshëm, që të tërhiqte vëmendjen dhe të dukej sikur prej secilës merrje një pjesë të gëzimit të saj. Mua më tërhoqi vëmendjen zotëria i vilës që kishte dalë tek porta dhe luante me qenin. Ndërsa zonjat e shtëpisë të shkujdesura deri në paturpësi, bisedonin me disa të huaj. Vajzat e rritura "luanin" me djemtë e huaj. Portieri, si një aktor i mirë komandonte lojën e tyre. Nga këto që pashë, e kuptova se vila brenda mureve kishte mbetur bosh. Detyrat dhe përkushtimet kishin mbetur pa u realizuar. Morali i këtyre njerëzve ishte shkatërruar, prandaj vila kishte rënë në këtë gjendje. Nga kjo vilë u largova shpejt. Duke ecur rrugës përpara më doli një vilë tjetër, më e madhe dhe më e bukur. Ajo kishte tjetër pamje dhe aty kryheshin veprime të tjera. Përpara derës rrinte shtrirë një qen i madh besnik, por edhe i ashpër. Pak më tej qëndronte një portier serioz dhe i qetë. U çudita nga ndryshimi që kishin këto dy vila me njëra-tjetrën dhe thashë me vete se ç'ishte kjo kështu! Pa e zgjatur hyra brenda. Vura re se brenda ajo gufonte nga gëzimi. Grupe-grupe njerëzit merreshin me detyrat dhe punët e tyre. Qetësia dhe mirëkuptimi ndihej kudo. Vajzat dhe djemtë bënin mësimet. Më tutje zonjat merreshin me artet nazike dhe qëndisje të bukura. Në grupimin më të lartë i zoti i vilës bisedonte në telefon për rendin dhe qetësinë e popullit, që jeta të përsosej më mirë. Pra secili merrej me detyrën e tij, që i përshtatej dhe i kishte hije. Ata nuk më thanë "pse ke hyrë" apo "është e ndaluar", prandaj pasi sodita vilën për pak kohë nga brenda, u largova. Kur dola nëpër qytet, vura re se i gjithi ishte mbushur me dy lloj vilash. Pyeta për këtë çudi dhe më thanë: "Të gjitha vilat që ngazëlleshin nga gëzimi e dëfrimet e shfrenuara, brenda janë bosh dhe janë të banuara nga mosbesimtarët. Ata bëjnë jetën e tyre të pakuptimtë dhe të mbushur me prapësira. Në vilat e tjera banojnë besimtarët dhe kryetarët e tyre janë me sedër (namuz). Kur po vazhdoja rrugën, në një qoshe pashë një vilë tjetër. Mbi portë në ballë ishte shkruar: "Said". M'u duk sikur aty pashë fotografinë time dhe fillova të bërtas. Nga ankthi u zgjova.

Tani po ta sqaroj ty këtë ndodhi të imagjinuar. All-llahu e bëftë hajr! Ai qytet që përmenda simbolizon jetën shoqërore të njerëzimit. Secila vilë është një njeri. Brenda kësaj vile-njeri dallohen shqisat dhe cilësitë e buta të njerëzve, si: syri, veshi, zemra, shpirti dhe mendja. Veç këtyre, njeriu në vetvete përmban edhe forca epshore, si: nervat, seksi etj.. Tek çdo njeri secili organ ka detyrën e vet. Priret epshore dhe nervore kanë vendin tek "porta" e tyre si qen-roje. Po i vure ndjenjat e buta në shërbim të veseve dhe pastaj t'i zhvlerësosh, ato të shtyjnë të harrosh detyrimin kryesor. Kjo është një rënie e tmerrshme. Këtë nuk mund ta quajmë kurrsesi përparim, por po e lëmë me kaq. Anët e tjera të çështjes mund t'i kuptosh edhe vetë.

Pika e tretë:

Përmes punës dhe veprës së tij, njeriu shfaqet si një krijesë e dobët dhe e pafuqishme. Pamja e kësaj ane të njeriut është kaq e dukshme, saqë mjafton që ta zgjatësh dorën për ta kapur. Për ta kuptuar më mirë mjafton të krahasojmë kafshët e buta me ato të egra. Kafshët e buta, pasi ia kanë dhënë frerët në dorë njeriut, janë bërë dembele dhe të dobëta si njerëzit, kurse shoqet e tyre të egra kanë një dallim të madh. Ky dallim duket midis kaut të butë dhe atij të egër, midis dhisë së butë dhe asaj të egër. Njeriun një Zot e ka krijuar dhe Ai e pranon dhe e lartëson atë sipas ligjeve dhe rregullave të Tij. Njeriu të gjitha pyetjet dhe lutjet Atij ia drejton, sepse Ai e ka dërguar në bujtinën e Kësaj Bote si një mysafir të ndershëm. Si mik i një Fisniku që është, njeriut përpara vetes i janë hapur Arka e Thesareve. Zoti i ka mësuar mjeshtëri të rralla dhe e do si shërbëtorin e Tij besnik. Zoti xh.sh. për dobinë e njeriut përpara tij ka hapur horizonte, ku të shëtisë dhe të sodisë mbi të gjithë sipërfaqen e rruzullit. Imagjinata e njeriut të shpaloset gjërë e gjatë.

Kështu në qoftë se njeriu mbështetet tek "un"-i dhe si qëllim kryesor ka këtë jetë të përkohshme, ai këtu vetëm se ushqehet dhe kënaqet me disa mirësi kalimtare. Rrethi i tij është i ngushtë. Ai gulçet dhe shkon nga hiçi. Organet e tij që i janë dhënë për t'i shërbyer në këtë jetë, si shqisat dhe pjesë të tjera të veçanta të trupit, do të ankohen ndaj tij dhe në "Mah'sherin e Madh" kundër tij do të dëshmojnë. Ata do të jenë paditësit e tij. Në qoftë se ky njeri e quan veten mik të përkohshëm në këtë botë dhe kapitalin e moshës së vet do ta harxhojë për Padronin e vet, ky është me të vërtetë mik i Zotit xh.sh.. Si të ketë punuar mirë në një rreth të gjerë për një jetë të përjetshme, atëhere bota për të do të ketë më shumë frymëmarrje, zbavitje dhe pushime. Ky njeri mund të shkojë në kulmin e lartësive. Të gjitha shqisat dhe elementet që i janë dhënë në këtë jetë për t'i shërbyer, ndahen prej tij duke dëshmuar në favor të tij në Jetën e Pastajme. Pra, organet e njeriut nuk i janë dhënë atij vetëm për këtë jetë të përkohshme, por sigurisht edhe për Jetën e Përjetshme.

Kur të krahasojmë njeriun me kafshët, do të shohim se nga mjetet dhe elementet përbërës, njeriu është një pasanik i madh, pothuaj njëqind herë më i pasur se kafsha. Ja pra njeriu për secilën shije ka ndijim të veçantë, ashtu sikurse edhe për çdo hidhërim ka gjurmën e veçantë të helmit, hidhërimeve të së kaluarës së tij iu shtohet edhe frika e së ardhmes, bashkë me ndarjen nga farefisi. Mpleksja e shijimeve me hidhërimet, njeriut ia prish humorin dhe kënaqësinë. Kafsha nuk është krijuar kështu. Ajo shijon dhe kënaqet pa ndjerë fare hidhërim. Lumturohet pa u dëshpëruar, as e kaluara dhe as e ardhmja nuk e shqetëson. Ajo nuk trishtohet nga asgjë. Jeton pa brenga në një qetësi të plotë duke falenderuar Krijuesin e saj.

Njeriu duke qenë krijesa më e përsosur dhe e pajisur me shqisa njëqind herë më të pasura se kafsha, nga kjo jetë është njëqind herë më i pakënaqur se ajo, prandaj përkushtimi i tij vetëm për këtë botë të përkohshme atë e rrëzon më poshtë se kafsha, bën ta shijojë këtë botë më pak se një zog i pyllit. Më parë kemi dhënë një shembull dhe meqenëse ka lidhje me këtë problem, po e

përsërisim:

Një pasanik i jep shërbëtorit të tij dhjetë napolona flori dhe i thotë: "Shko e bli një kostum prej stofi të mirë!" Po kështu thërret shërbëtorin e dytë dhe bashkë me njëmijë napolonat e floririt i jep edhe një letër ku kishte shkruar porosinë.

Shërbëtori i parë me dhjetë napolona bleu një kostum shumë të bukur.

Shërbëtori i dytë pa e lexuar fare letrën, nxjerr njëmijë napolonat dhe ia jep një shitësi, duke i kërkuar një kostum burrash. Shitësi qëllon mashtrues dhe i jep një kostum prej një stofi shumë të keq. Kur shkoi tek padroni, shërbëtori fatkeq u dënua rreptë dhe vuajti shumë. Kush ka mend sa një kokërr gruri e kupton se kur shërbëtorit të dytë i dhanë njëmijë napolona flori, dihet se ato nuk iu dhanë vetëm për një palë rroba, por mund të përdreshin edhe për një tregti të levërdisshme dhe serioze.

E njëjta gjë ndodh me elementet e ndjeshmërisë shpirtërore dhe vlerat njerëzore të njeriut, të cilat të krahasuara me ato të kafshës janë njëqind herë më të zhvilluara. Si shembull: Të gjitha shkallët e bukurisë, syri i njeriut i veçon dhe ushqimet e lloj-llojshme i vlerëson shqisa e shijes, duke përcaktuar edhe shkallën e saj.

Mendja e njeriut është pajisur me cilësi të tilla, që është në gjendje të analizojë të gjitha stërhollimet e fenomeneve. Zemra po kështu është e mbushur me të gjitha përmallimet dhe sentimentet humane. Po në këtë mënyrë, po t'i rreshtosh të gjitha elementet përbërës të njeriut, a mund të kuptosh se deri ku shkon radha? Shqisat e njeriut nuk janë si ato të kafshës së thjeshtë, që nuk peshojnë as dy gram. Ato dinë vetëm të hanë, të pinë dhe të bashkohen për të vazhduar fisin e tyre. Mund të dallohet fare pak ndonjë kafshë që ka një farë instinkti të zhvilluar, që spikat me veprimet e saj, por mendimi është tepër i vështirë të zbulohet. Këto veprime nuk janë veçse instinkte. Pra kuptohet nga sa thamë se njeriu nga kjo pikëpamje është shumë i pasur në aftësitë e shqisave, për shkak se ai zotëron mendjen dhe arsyen e nuk është e vështirë për të zbuluar aftësitë e tjera. Veç kësaj, nevojat dhe kërkesat e njeriut janë të panumërta dhe ndjenjat e tij janë tepër të hapura dhe të shumëllojshme. Krijimi i njeriut, po të krahasohet me shumë krijime të tjera, ka qëllime shumë të larta dhe të gjera, si dhe dëshira të larmishme. Ai është i ngarkuar me detyra të veçanta. Aftësia e njeriut është e tillë, që ai të sqarojë dhe të zbatojë të gjitha llojet e adhurimeve. Ai ka përsosmërinë për të shfrytëzuar të gjitha këto aftësi. Aq shumë është i pajisur me aftësi të rralla dhe me një kapital të madh, sa që të gjitha këto veti dëshmojnë se nuk janë vetëm për në këtë botë të përkohshme. Obligimet dhe detyrimet e njeriut janë shumëplanëshe, të larmishme dhe të detyruara për t'u zbatuar. Njeriu duhet ta pranojë dobësinë dhe varfërinë e tij, si dhe të shfaqë adhurimet ndaj Zotit xh.sh.. Me horizontin e gjerë të dijeve të tij, njeriu duhet të bëhet dëshmitar i krijesave të tjera, të shikojë "tespihët" e tyre dhe të falenderojë Zotin xh.sh. për këto mirësi. Ai duhet ta vlerësojë mirë ndihmën e madhe të Krijuesit të Gjithmëshirshëm në Artet e Gjithësisë së sotme, Mrekullinë e Fuqisë së Zotit xh.sh. dhe të kujtohet për dobësitë e Tij. O njeri i pakujdesshëm që adhuron botën dhe e dashuron atë. Saidi i moçëm të vërtetën siç e ka parë me një ndodhi të hershme dhe të imagjinuar ta ka treguar. Ajo që të tregova e shndërroi Saidin e vjetër në të ri, por vështromë dhe dëgjomë mirë! M'u bë sikur më dërguan në një udhëtim të gjatë dhe të vështirë. Padroni im nga gjashtëdhjetë napolona flori që kishte caktuar më parë, kishte vendosur të m'i jepte nga pak. Rrugës për në udhëtim, rashë në një bujtinë qejfesh dhe dëfrimesh, ku për një natë shpenzova dhjetë napolona flori duke u dhënë pas kumarit dhe dëfrimeve, që të fitoja lavdi dhe famë. Mëngjezi më zuri me xhepat bosh dhe duar thatë. Për tregti as që bëhej fjalë, në qytetin për ku isha nisur as që shkova dhe as që bleva gjësendi. Paratë që humba më hidhëruan shumë dhe s'fitova gjë, veçse mëkate dhe shqetësime. Në gjendjen që isha, m'u shfaq një njeri që më tha: "Mallin e humbe të gjithë dhe meriton një dënim të rreptë.

Në vendin e caktuar do të shkosh duarthatë. Po qe se s'e ke humbur mendjen, dera e pendimit është e hapur. Tani që shpenzove dyzetepesë napolona flori, kryesorja është të mbledhësh mendjen. Për çdo rast që të jepet nga pesëmbëdhjetë florinj, mbasi të kesh harxhuar gjysmën, ruaje mbetjen si depozitë. Pra duhet të blesh diçka për atje ku do të vesh." E vështrova. Nefsi im nuk po pajtohej me këto fjalë. Ai njeri po më thoshte që një të tretën ta veçoja, por prapë se prapë nefsi im nuk po e pranonte dhe nuk po nënshtrohej. Edhe kur tha për një të katërtën, ai prapë ngulte këmbë në të tijën. Njeriu i mirë u hidhërua, më ktheu shpinën dhe u largua. Papritur gjendja në të cilën ndodhesha m'u tjetërsua. M'u duk sikur po ecja në një tren me një shpejtësi të madhe, nepër një tunel të gjatë. Asgjëkundi nuk po shihja një shteg shpëtimi. Për çudinë time, ndërsa treni çante rrugën me shpejtësi, në të djathtë dhe në të majtë time vështroja sheshe me lule dhe kopshte me pemë frutore shumë të shijshme. I ngjaja një të çmenduri dhe zgjasja dorën për të rrëmbyer ndonjë frut të pjekur. Mjerisht, ato ishin të rrethuara me çerdhe ferrash dhe sa herë që zgjasja dorën të rrëmbeja diçka në rrugë e sipër, më përgjakeshin duart. Kjo përpjekje po më kushtonte shumë shtrenjtë. Papritur erdhi faturina i trenit dhe më tha: "Më jep pesë groshë dhe do të të jap sa të duash lule dhe fruta! Kështu po të kushton më shumë. Shiko si i ke çarë duart! Po të më japësh pesë grosh, edhe nga dëmtimi do të shpëtosh edhe nuk do t'i marrësh pa leje, që të biesh në mëkat". U pezmatova shumë prej marrëzisë time dhe me vete po thoja se kur do të mbaronte ky tunel i pasosur. Duke parë me vëmendje, vura re se tuneli kishte disa gryka, ku njerëzit orvateshin të kërcenin brenda tyre. Përballë meje ndodhej një grykë e tillë. Në të dy anët ishin ngulur dy gurë varri të mëdhenj. U bëra kureshtar dhe i pashë me vëmendje. Mbi ta me shkronja të mëdha, ishte shkruar emri im "Said". Nga paniku që më zuri, u shqetësova dhe thashë me vete: "I mjeri unë!" M'u bë sikur dëgjova zërin e njeriut tek porta e hanit, sikur më jepte këshilla. Ai sikur më thoshte:

"A të ka ardhur mendja?" Pëshpërita: "Tani e kam mendjen në vend"-dhe rashë i pafuqishëm pa ndjenja. Ai vazhdonte të më këshillonte: "Pendohu dhe bindju Zotit xh.sh.!"

"U pendova!"-thashë. Menjëherë pas këtyre fjalëve u zgjova. Saidi i Vjetër u largua dhe unë e ndjeva veten si një Said i ri.

Me këto ndodhi të imagjinuara All-llahu e bëftë për hajr! Po sqaroj kuptimin e dy pjesëve, kurse kuptimin e pjesës së tretë ta nxirrni ju vetë.

Udhëtimi fillon nga bota e shpirtërave, barku i nënës, vazhdon me fëmijërinë, rininë, burrërinë, pleqërinë deri tek fundi - varri, jeta e varrit, që nga Tubimi i Madh, duke kaluar nga ura e Siratit dhe vazhdon deri në përjetësi.

Gjashtëdhjetë napolonat flori janë mosha mesatare e njeriut. Kur e imagjinoja këtë ndodhi, më dukej vetja rreth dyzetepesë vjeç.

Një nxënës i zellshëm i Kur'anit ishte ai që më këshilloi. Senet nuk kam, por prej atyre pesëmbëdhjetë vjetëve që më kanë ngelur, gjysmën dua ta shpenzoj për jetën e Mbrapme.

Hani, vendqendrimi, për mua ka qenë Stambolli.

Treni është koha, ku secili vit është një vagon.

Shpella është kjo jetë e përkohshme.

Lulet dhe frutat janë shijet dhe ndjenjat e ndaluara dhe lodrat haram si ato ferrat që kur iu afroresh të hidhërojnë dhe të plagosin zemrën, duke menduar ndarjen prej tyre dhe s'merr dot diçka që dëshiron. Ato ta japin dënimin menjëherë.

Faturina i trenit më pati thënë: "Më jep pesë groshë, të të jap sa të duash lule dhe fruta", që duhet kuptuar kështu: Njeriut duhet t'i mjaftojnë ato që fiton me djersë dhe t'i shijojë ato që janë të lejuara për të, nuk ka nevojë të futet në haram.

Të tjerat mund t'i kuptosh vetë.

Pika e katërt

Njeriu në Gjithësi ngjan me një fëmijë nazik dhe të përkëdhelur. Në dobësinë e tij ai gjen një fuqi të madhe, ndërsa në varfërinë e tij fshihet një pasuri e begatë, sepse ky njeri i ka mbledhur rreth vetes, me fuqinë e dobësisë dhe me ndërmjetësimin e paaftësisë, të gjitha qëniet, duke i ka vënë në shërbim të tij.

Po qe se ky njeri e pranon dobësinë e tij me gojë e me vepër dhe lutet për ndihmë tek Krijuesi i Gjithmëshirshëm, kjo do t'i japë atij suksesin. Duke vazhduar falenderimet ndaj Zotit, për të janë të panumërta arritjet për punët e tjera të përditshme (ahiret). Njeriu duhet ta pranojë me ndërgjegje se as 1% të këtyre realizimeve nuk do të kishte përmbushur pa ndihmën dhe dashamirësinë e Zotit xh.sh.. Dobësive të veta njeriu mund t'i kundërpërgjigjet vetëm me anë të lutjeve dhe adhurimit ndaj All-llahut. Kur njeriut i pëlqen vetja dhe e mbivlerëson atë, kujton se është i zoti për të përmbushur dëshirat që ka. Për këtë që thamë, po japim një shembull. Dobësia e tij zogut të pulës i sjell në ndihmë nënën e vet, kur e sulmon dhelpra. Po kështu, këlyshi i luanit për të përmbushur kërkesat e tij për ushqime vë në shërbim nënën e vet, që shqyen kafshët e tjera dhe i siguron ushqimin e nevojshëm. Ajo sakrifikon vetveten për fëmijët e saj, sepse vetë nuk ha, por ia lë atij. Vazhdojmë me një shembull tjetër, për të ilustruar pikëpamjet tona.

Një fëmijë nazeli për të plotësuar kërkesat e tij dhe për të shprehur gjendjen e tij të uritur fillon të qajë e të thërrasë. Pa dashur ai fëmijë më të fortët se vetja i sjell në shërbim të vetvetes. Me aftësitë e veta fëmijërore, ai asnjë prej kërkesave nuk do të kishte plotësuar. Pra dobësia dhe paaftësia e fëmijës është arsyeja për t'iu përgjigjur me mëshirë dhe mbrojtje kërkesave të tij. Vetëm me gishtin e tij të vogël, me një shenjë, ai heronjtë i vë në shërbim të vetes. Pra ky fëmijë, si ka mundësi që më kokëfortësi të mohojë se këtë ndihmë ia ka sjellë tjetërkush dhe të thotë se e ka siguruar me përpjekjet dhe mundin e tij, kur dihet mirë se sa është në gjendje që t'i shërbejë vetvetes? Po qe se do ta bënte këtë marrëzi, ai me të vërtetë do të meritonte shpullën fytyrës. Le të kthehemi tani tek i rrituri. Si mundet që ky njeri i ndërgjegjësuar të mohojë Mëshirën e Krijuesit dhe të dyshojë në diturinë e Mrekullisë të Tij? Me këtë veprim ai bën si ai "Karuni", më bukëshkali që ka thënë: ajet: 35)

Kjo më ishte dhënë në bazë të dijes sime!

Me siguri që edhe ky njeri, ashtu si "Karuni", do ta meritojë dënimin e rreptë. Domethënë kjo mbretëri e dukshme e njerëzimit, ky përparim, kjo përsosmëri nuk është arritur as me përpjekje dhe as me fitore. Patjetër që, të gjitha shërbimet dhe shërbëtorët njeriut i janë vënë në shërbim dhe ndihmë, sepse ai është i dobët, i paaftë dhe i varfër. Njeriu duke qenë injorant, në çdo kohë i vjen frymëzimi i Zotit xh.sh.. Ai e kupton se të gjitha sa i janë dhënë dhe administron në këtë jetë, i janë dërguar nga Bujaria, Mëshira dhe Dituria e Kulluar e Zotit xh.sh.. Njeriu shumë lehtë mund të bjerë pre e një akrepi, e një gjarpëri pa duar dhe dhëmbë, por All-llahu xh.sh. atij i ka vënë në shërbim insektin pa duar për ta veshur me mëndafsh, apo një bletë që mban me vete helm dhe prej saj rrjedh mjalti që na ushqen. E gjithë kjo nuk është gjë tjetër, veçse një fakt që tregon se Ai, Zoti i Madh e ka zgjedhur njeriun si krijesën më të pëlqyer për Vete dhe tërë Gjithësinë e ka vënë në shërbim të tij, vetëm e vetëm se është i dobët dhe i paaftë për vetveten, duke mos mundur të bëjë dot asgjë. Atij i duhet patjetër ndihma e All-llahut xh.sh..

O njeri! Meqenëse të vërtetë tjetër veç kësaj nuk ka, hidhe tej "un"-in dhe kryelartësinë tënde dhe me gjuhën e paaftësisë dhe dobësisë trokit në Portën e Hyjnisë së Tij. Për ty ajo gjithmonë është e hapur!

Duke u lutur me përkushtim tek Ai, shpalle dhe tregoje me bindje se je robi i Tij dhe thuaj:
ajet:36

Ai është mbrojtësi më i mirë!

Mos thuaj: "Unë jam një hiç, ç'ka kam rëndësi që All-llahu me Diturinë e Mrekullueshme dhe të Kulluar të Tij, tërë Gjithësinë e ka vënë në shërbimin tim dhe kërkon nga unë një falenderim të përgjithshëm". Ke shumë të drejtë, duke iu nënshtruar nefsit tënd, bie në gjendjen e një "hiçi". Por po qe se do ta vlerësosh detyrën tënde, siç duhet dhe të njohësh pozitën tënde ti do të jesh një vrojtues i kujdesshëm dhe një lexues i saktë i librit të madh të Gjithësisë.

Pra o njeri! Ti me trupin tënd të brishtë dhe me nefsin (pangopësinë) tënde shtazore, je më i vogël se të vegjëlit, je një krijesë e varfër dhe e dobët. A nuk e sheh se je duke u zhytur në dallgët e rrëmbyera, midis qënieve të tmerrshme? Me Dritën e Dëshirës Hyjnore që mban në vetvete, si pasqyrë e Dritës së Besimit dhe e edukatës së fesë Islame, si të mbushesh dhe të pasurohesh me cilësitë e racës tënde, me robërinë tënde tek Zoti do të jesh bërë një mbret. Individualiteti yt është kompletuar e nga vogëlsia jote ke dalë dhe në vetvete ke përqëndruar të gjitha botërat. Nga pozita e ulët (poshtërimi) ke fituar një pozitë dhe rrethvështrim më të gjerë. Si të kesh arritur në këtë arsyetim, do të thuash: "Zoti im! Mëshira Jote e Plotë këtë botë ma ka ndërtuar si një shtëpi. Hënën dhe Diellin si një llambë për të ndriçuar shtëpinë time. Pranverën ma ke sajuar si një buqetë me lule, verën si një sofër plot me prodhime (nimete). Kafshët i ke krijuar që të vihen në shërbimin tim, kurse bimët të më hijeshojnë kopshtin".

Shkurt, nëse dëgjon nefsin dhe shejtanin, e ke zhytur veten në fundin e ferrit. Nëse rrugës së drejtë i përmbahesh dhe i nënshtrohesh Kur'anit, atëhere arrin kulmin e lartësive në formën më të bukur të Gjithësisë".

Pika e pestë

Njeriu është dërguar në këtë botë si një mik dhe nëpunës i Zotit xh.sh.. Atij i janë dhënë aftësi të konsiderueshme dhe sipas këtyre aftësive është ngarkuar me detyra të rëndësishme. Për të përmbushur këto qëllime shpesh nxitohet dhe trembet shumë. Këtë gjendje të tij e kam sqaruar në tjetër vend, por këtu po i biem shkurtimisht, derisa të kuptohet sekreti se është një ekzemplar i bukur dhe në formën më të hijshme.

Njeriu që kur ka ardhur në këtë botë është i ngarkuar me dy adhurime. I pari është forma e padukshme që arrihet kur njeriu formon një mendim të drejtë për Gjithësinë, për madhësitinë dhe përsosmërinë e krijesave të Zotit xh.sh.. I dyti është forma e dukshme që shprehet përmes lutjeve që njeriu duhet të bëjë ndaj Zotit xh.sh.. E para ka një domethënie. Në këtë Gjithësi që ne vështrojmë çdo ditë, duket Mbretëria e Edukatorit dhe ti o njeri duke iu nënshtruar Mbretit tënd do të vërtetosh se ka një Mjeshtër, Përsosmërinë e të Cilit do ta soditësh i mahnitur. Veç kësaj, ti do të bëhesh shpallësi dhe reklamuesi i Arteve të Bukura, që pasqyrojnë Emrat e Lartë të Hyjnorë, sepse këto paraqiten edhe në pikëpamjet e njeriut. Këto funksione të Emrave të Bukur nga ana shpirtërore janë një arkë e mbushur me ndjenjat e zemrës dhe me peshoren e logjikës, të cilat duhet t'i vlerësosh dhe t'i përkujtosh. Gjithashtu, fytyrën e krijesave ta vlerësosh si një libër të shkruar me lapsin e Fuqisë Hyjnore kudo që janë, në qiell apo në tokë dhe mundohu ta lexosh mirë. Duke i soditur këto stoli të hijshme, që janë Mrekullitë e Hyjnore, nga soditja dhe përfillja që do të tregosh ndaj Mjeshtërisë së këtyre arteve, do të bëhesh një Adhures i apasionuar i tyre. Ky pasion dhe kjo përfillje shumë shpejt do të të tërheqin në rrugën e Tij të Drejtë, të All-llahut të Plotfuqishëm.

Ana e dytë e Adhurimit. Duke e konsideruar veten pranë Mesazhit të Zotit xh.sh. dhe duke

soditur Artin dhe Mjeshtërinë e Tij, vëre se Mjeshtri Madhështor kërkon të reklamojë dhe njoftojë Mrekullinë e Veprës së Tij. Njeriu e merr përsipër me besim dhe kurajo këtë detyrë dhe bëhet njoftuesi i Zotit xh.sh.. Nga ky obligim do të vësh re se Zoti xh.sh. i Gjithmëshirshëm do që t'i sqarojë frutet e Mëshirës së Tij dhe t'i shtyjë robërit e vet ta duan Atë. Pasi ta duan, pa iu shmangur, të shpallin pa ngurruar dëshirën dhe adhurimin e tyre ndaj Krijuesit. Pastaj do të shohësh se si një Bamirës Fisnik do ta kënaqë njeriun shpirtërisht dhe materialisht. Njeriu nga ana e tij u përgjigjet këtyre mirësive me përlulje, me punë, me shpirt dhe me mirënjohje. Me të gjitha shqisat, po të mundte, njeriu do të falenderonte All-llahun xh.sh..

Një Bukuri Ngadhnjimtare në pamjen e qenieve do ta pasqyrojë Madhësinë dhe Përsosmërinë e Bukurisë së Vet dhe do të

shpallë Ngadhënjimin e Vet duke e kthyer për nga vetja botëkuptimin e njerëzve. Njeriu nga ana e tij i përgjigjet duke thënë: "All-llahu Ekber, Subhanall-llah", me një nënshtrim të plotë dhe të mahnitshëm, me dëshirë bie në sexhde. Më pas duket se sheh një Padron të Përgjithshëm, me një Fisnikëri Absolute, me një Besnikëri të madhe që shpall pasurinë dhe hambaret e tij të pafundme. Njeriu me varfërinë e tij, në përlulje të plotë dhe me nderim kërkon prej Krijuesit të vet Mëshirë. Do të shohësh se Krijuesi i Madhërishtëm e shpalos sipërfaqen e tokës si një ekspozitë të stërmadhe, ku ka ekspozuar të gjitha Artet dhe Antikat e Veta. Duke parë këto Mrekulli dhe duke i vlerësuar ato, do të thuash:

"Mashaall-llah". Duke i pranuar këto Bujari do të thuash: "Barekall-llah" dhe i habitur nga të gjitha këto mirësi do të thuash: "Subhanall-llah". Pasi t'i kesh pëlqyer këto, thuaj: "All-llahu Ekber". Shiko se në këtë Gjithësi ka vetëm një Vulë të pafallsifikueshme, që mban Firmën e Tij të pamohueshme që e ka vënë në Fermanin e tij të pakundërshtueshëm. E gjithë Gjithësia ka vulën e Njesisë vetëm të Tij. Argumentet e Njësimit të Vet i ka qëndisur kudo. Në çdo skaj të Gjithësisë valviten flamujt e Tij të Njesisë, që duket sikur thonë: "Ne i përkasim Edukatorit të Gjithësisë".

Njeriu i përgjigjet duke pohuar dhe besuar. Ai duke iu bindur dhe përlulur Atij, thotë: "O Zot! Ti je Një dhe vetëm Një!" Me këto fjalë dëshmon Adhurimin ndaj Zotit xh.sh..

Me këto cilësi dhe me adhurimin e vet njeriu arrin në natyrën e tij të vërtetë dhe vërteton se ai është krijuar si një ekzemplar shumë i bukur. Me besimin e tij të plotë vërteton se ai mban në dorë me besnikëri dhe respekt kalifatin e botës.

O njeri i pavëmendshëm, që je krijuar si një ekzemplar i bukur, mos e shpërdoro detyrën që të është dhënë dhe mos bëj të kundërtën. Nga gremina ku ke rënë ngrije veten në lartësitë e ndriçuar!

Dëgjo! Edhe unë si ti, me dëshirat e rinisë së pakujdesshme, më parë pëlqeja këtë jetë. Në mëngjesin e pleqërisë kur u zgjova, e pashë veten se nga sa kisha pëlqyer në këtë jetë, në të gjitha veprat e mia nuk kishte rendimente të "Ahiretit". Ajo më dukej një e kaluar e shëmtuar dhe e vështirë.: 37

Ti je i Patëmeta, ne nuk kemi dije tjetër përveç asaj që na mësove Ti. Vërtetë Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti. Ma zgjero gjoksin tim! Dhe më lehtëso në këtë punë timen! Më zgjidh nyjen e gjuhës sime që ta kuptojnë fjalën time. O All-llah, e nderojmë dhe i bëjmë selam personit të posaçëm, Muhammedit i cili është i Vetmi dhe Dielli i sekreteve të qiejve dhe që pasqyron Dritat dhe qendrën e madhësisë së krijesave, si dhe majën e bukurive të Gjithësisë. O All-llah! Ngopna me oqeanet e pasurive të Tua të pashterrshme, pranomi lutjet për të më pakësuar mëkatet dhe për të më larguar shqetësimet, ambiciet dhe frikën. Mos ma largo mëshirën Tënde, ndihmomë të përullem ndaj Fuqisë Tënde, mos më bëj të adhuroj nefsin, mos më turpëro me

veset e mia të këqija. Dërgoma mëshirën Tënde në çdo çast që mos të të harroj Ty.
O i Gjalli i Përjetshëm! O i Gjalli i Përjetshëm! O i Gjalli i Përjetshëm! Më mëshiro mua, shokët
e mi dhe të gjithë besimtarët që i nënshtrohen Kur'anit; O më i Mëshirshmi i mëshiruesve dhe
më Bujari i tërë bujarëve, pranomi lutjet.
Dhe lutja e fundit e tyre: “Falenderimi i qoftë All-llahut, Zotit të botëve!”

KONFERENCE

KJO KONFERENCE ËSHTË LIGJËRUAR NË UNIVERSITETIN E ANKARASË

Me mësimin e Risale-i Nurit dhe me frymëzimin e mësuesit Bediuzzaman është përgatitur kjo konferencë kushtuar vlerave së Risale-i Nurit. Kjo është një bisedë e mirë dhe e këndshme, por ne nuk kemi guxim dhe mundësi ta vlerësojnë si duhet Risale-i Nurin. Mua nuk më mjafton kultura të lavdëroj Risale-i Nurin, sepse jam një nxënës thjeshtë që po shkoi në klasën e pare për të studjoi Risale-i Nurit. Me këtë nivel që kam unë, si mund ta lavdëroj atë që ka marrë aq famë në arenën ndërkombëtare?!. Lavdërimin e duhur për të e bëjnë nxënësit e shkëlqyer të Risale-i Nurit që dijnë ta vlerësojnë të.

Derisa u përballova me Risale-i Nurin, unë nuk pashë asnjë shkrim në literaturën tonë që tregon vlerën e Kur'anit. Më pas e kuptova se për çfarë arsyeje!!! Për më se një gjysëm shekulli, shkrimtarët e huaj po e vlerësonin Kur'anin Famëlartë më shumë se të tanët. Si në Shtëpinë e Bardhë në Amerikë dhe në shumë vende të botës, duke e shtjelluar me pëlhurë mëndafshi të gjelbër po e vendosnin Kur'anin Famëlartë në pedestal ashtu si i ka hije. Shpikësit, filozofët, psikologët, sociologët dhe pedagogët e huaj po lexonin librat që kishin buruar nga Kur'ani Famëlartë. Këta dijetarë, duke marrë ije nga Kurani I Shenjtë kishin shkruar libra dhe ishin bërë njerëz të famshëm në arenën ndërkombëtare. Në këtë mënyrë po përpiqeshin të bëhen të dobishëm për popullin e vet dhe për njezëzimin. Zvicra, Norvegjia dhe Finlanda kishin formuar një delegacion me dijetarë të famshëm të cilët e kishin ngazhuar veten në hetime për disa vjet që të gjejnë një libër që t'i shpëtojë të rinjtë nga imoraliteti. Dhe më në fund kishin vendosur duke thënë se nuk ka derë tjetër për t'i bërë të rinjtë përparimtarë dhe shkencëtarë realë, veçse duke i nxitur ata të lexojnë Kur'anin famlartë që të shpëtojnë nga fanatizmi. Jo vetëm këto që thamë, por mund të japim shumë shembuj të tjerë që tregojnë se të huajat po e vlerësojnë Kur'anin. Tani, që edhe të huajt po i dalin zot Kur'anit, a është e mundur vallë që rinia myslimane e popullit Turk të qëndrojë më tepër në gjumë? Kurrë, asnjëherë!

Pra, Zoti xh. sh, Adhuresi, patjetër që nuk e ka lënë pa e dërguar edhe në shekullin tonë një thesar plot me shkenca të vërteta, që t'i japin rinisë një përgjigje të plotë rreth pyetjeve të nevojave të tyre shpirtërore. Ky thesar I diturisë së Risale-i Nurit që është një koment i shkëlqyer i Kur'anit Famëlartë, këto vepra që i ka shkruar Bediuzzamani janë pikat e Kur'anit dhe ato janë shkruar rreth themeleve të besimit. Për këto vepra që dijetarët thonë se në këtë kohë mund të shpëtojnë rininë e popullit nga bataku i devijimit, vetëm këto komente të Kur'anit dhe këto vepra duke e lavdëruar bashkë vërtetojnë edhe titullin e autorit “Bediuzzamat”(Mrekullia-çudia a kohës). Megjithë se është kështu, autorin e këtyre veprave sot nuk po e njohin të gjithë. Ja vëllezër, në brendësinë tonë që prej 15-20 vjetësh komunistët dhe rrymat e armiqve të fesë kanë punuar me rreptësi në mënyrë të tillë që jo më të na i bëjnë të njohur ne këta njerëz gjenialë, por përkundrazi, i kanë kritikuar duke i injoruar me lloj- lloj shpifjesh. Bile, për t'i imponuar popullit mendimin se këta persona janë njerëz të këqinj, duke bërë propagandë negative janë munduar me

shumë zell të shfrytëzojnë me sukses edhe mjetet e ndryshme të medias. Ne më përpara nuk kishim dijeni për gjendjen tonë të keqe dhe për këtë njeri të shquar. Me ardhjen e demokracisë në këto vite mundëm ta kuptojmë. Dijetarët tanë dhe të tjerë deri tani na kanë mashtruar shumë me propagandën për “ të renë”. Megjithëse vonë, ne mundëm të heqim nga kokat tona këto mendime negative dhe jemi të gëzuar se tashmë nuk kanë mbetur tek ne mendime të tilla. Tani po vazhdojmë jetën duke përqaftuar Kur’anin, Atë nga i cili kanë bërë dobi të gjithë njerëzit e shquar. Tani falenderojmë shumë Zotin xh.sh. që filluam të ndriqohemi me Risale-i urin që ka buruar nga të vëtetat e Kura’nit Famëlartë.

Ja, si për Abdulkadir Gjejlani, Imami Gazalinë dhe Mevlana Xhelaleddini Ruminë rinia jonë nuk na ka qenë e informuar, as për personalitetin e tyre dhe as për veprat e tyre. Rinia jonë nuk i njeh ata që kanë qenë yje të Islamit. Po kështu, edhe autorin Bediuzzaman Said Nursiun që është komentator i pashoq i Kur’anit Famëlartë populli akoma nuk ka mundur ta njohë mirë. Kjo ka rrjedhur nga qëllime të këqia të armiqve të fshehtë të brendshëm e të jashtëm që kanë bashkëpunuar për këto qëllime negative. Por që të bëjnë dobi veprat e tij, me atributet e veta, shumë nga nxënësit e shkencave të ndryshme janë duke u përpjekur me mish e me shpirt që të njohin komentatorin Bediuzzaman dhe gjeninë e islamit që ka lindur në shekullin tonë.

Ja o shokë! Me bindje të saktë mund t’ua them se : Vetëm vepra e Risale-i Nurit mund t’i bindë njerëzit e këtij shekulli me mend dhe me shpirt për besimin e fesë së vërtetë të islamit, dhe mund t’ia garantojë atyre lumturinë e të dy jetëve. Ky gjykim nuk është vetëm gjykimi im, por është ndoshta edhe gjykimi i saktë i lexuesve të shkëlqyer të Risale-i Nurit, dhe argumentimi i këtij mendimi është edhe fuqia shkencore të Risale-i Nurit që është shumë qartë dhe origjinaliteti i saj. O shokë të dashur!

Ai që i mbështetet Kur’anit, atij i shndritë dynjaja edhe ahireti, njësoj ashtu edhe kush lexon Risale-i Nurin dhe vepron sipas parimeve të tij, ai do të arrijë lumturinë e vërtetë. Do të forcohet besimi i atij që vepron sipas urdhërave të këtyre veprave, e ardhmja e tij do të ndriqohet, do të bëhet më i ditur. Në këtë rast, për atdheun, për popullin edhe për prindërit do të bëhet njeri i dobishëm. Me këto vepra do të mund të arrijnë në kulmin e moralit dhe në një pozitë të tillë që ndaj Zotit të bëhen njeri i sinqertë dhe ndaj Pejgamerit - ymmet i vërtetë.

Po sikur dikush nga vëllezërit bën ndonjë pyetje për të zotëruar ndonjë dije nga Risale-i Nuri? Për këtë nuk ka nevojë të pyetni njeri. Me atributin tuaj përpikuni dhe shihni që të lexoni vetë këto libra brilante. Më pas mund të kuptoni e të njiheni vetë se çfarë janë. Atëherë mund të hyni vetë në “arkën “ e kësaj dituri. Në këtë rast, ju në të vërtetë do të zotëroni dijen që jeni duke kërkuar. Ja pra, kur njeriu vazhdon duke lexuar e Risale-i Nurin, atij shpirti i mbushet me dritën e Kur’anit; besimi i tij do t’ia lulëzojë dhe do t’ia ndriçojë mendjen dhe zemrën. Sa më tepër që e lexoni Risale-i Nurin, aq më tepër e kaplon shpirtin dhe zemrën tuaj frymëzimi hyjnor. Në jetën tuaj do të hapen portat që të jetoni të qetë dhe të lumtur. Dhe duke përparuar leximin e këtyre veprave do të kuptoni se kjo botë është një arë e ahiretit; këtu keni ardhur për të bërë tregti që të fitoni jetën e përtejme. Në këtë rast duke ndjerë shijen e besimit edhe kjo jetë do t’ju vijë më e shijshme se xhenneti. Tani, me këto masa të besimit të përjetësisë, këtë jetë kalimtare nuk e do për veten e tij; ndoshta atë e do për arsye se kjo jetë është një vend tregtie për një jetë që nuk siset kurrë. Me këto do të kuptosh se adhurimi është një shije e madhe e amëshuar. Dhe kur drejtoheni në namaz për të dalë para All-llahut, Edukatorit Mëshirëplotë do ta shihni se çfarë shije hyjnore do ta kaplojë trupin tuaj. Gjithnjë shpirtin tuaj do ta pushtojë ankthi për ditët e kaluara në të cilat s’keni mundur të falni namazin. Dhe së fundi, kur i lexoni veprat e Risale-i Nurit duke u shdërruar do të ndjeni kënaqësinë dhe lumturinë më të madhe dhe me zell do të bëni ibadet (adhurim) ndaj All-llahut tuaj të Madhëruar.

Vëllezër! Autori, Risale-i Nurin nuk e ka shkruar me dëshirën dhe vullnetin e tij. Por autorit i është frymëzuar nga All-llahu, si dhurata më e madhe nga errësira e devijimit, për t'i shpëtuar myslimanët dhe njerëzit e botës që jetojnë në këtë shekull.

Tani, këto vepra kanë ndikim më të madh mbi njeriun, atëherë kur i lexoni duke u kujdesur dhe kur i drejtoheni fjalorit për të kuptuar fjalët që s'keni mundur të kuptoni. Në këtë rast, edhe ju si nxënësit tjerë do të përballoheni me kënaqësinë dhe me qetësinë më të madhe shpirtërore dhe do të jeni dinamikë, duke u përpjekur që të kaloni shumë kohë duke i lexuar ato. Me besimin që do të përfitoni nga këto vepra, nuk do ta lejoni të kalojë aspak nga koha juaj pa dhënë rezultatin e saj. Dhe për të vlerësuar kohën me një formë më të bukur, fragmentet e tij do t'i mbani nëpër çanta apo nëpër xhepat tuaj. Në këtë rast duke u entuziazmuar dhe duke marrë flakë do të ndjeni nevojën e leximit. Ja vëllezër! Do të mund do ta kuptoni vlerën e leximit të Risale-i Nurit, të këtij shërbimi të amshuar që është një shërbim ndaj Kur'anit dhe besimit, vetëm atëherë kur do të merreni me këtë shërbim, ngaqë do të ndjeni një shije që nuk tregohet. Sepse ju, duke u marrë me këtë shërbim edhe sikur t'iu të ftojë në xhenet, do të thoni: Momentalisht nuk mund të braktisni këtë shije që jeni duke marrë për shërbimin e Kur'anit me Risale-i Nurin. Këto fjalë mund t'i rreshtoni duke i lexuar ato dhe do të zotëroni një besim të fortë dhe atëherë e mësoni se çfarë vlere ka të shpëtosh besimin e dikujt. Në këtë rast do të bindeni se idenë dhe shijet e këtij shërbimi nuk e përballon as kënaqësia e xhenetit. Vëllezërit që kontribuojnë në shërbimin e besimit e të fesë sakrifikojnë aq shumë sa që nuk mund të gjesh në këtë shërbim të tyre qëllimin më të thjeshtë të interesit të vet personal. Sepse qëllimi më i madh i miliona vëllezërve të vlefshëm e të sinqertë që duke u zgjuar kanë kuptuar se shërbimi i Risale-i Nurit nuk është tjetër vetëm se shërbimi i Kur'anit Famëlartë. Kush është i zgjuar nuk mund të mohojë këtë përpjekje të veçantë të nxënësve të Nurit që bëjnë pa asnjë lloj interesi, vetëm për hir të Zotit xh.sh. Ato me dashurinë e zemrës dhe të mendjes atribuojnë duke sakrifikuar edhe gjumin e tyre. Shikoni nxënësit e Nurit si janë lidhur me të! Sikur ndonjërit prej tyre t'i thuash: ty do të të japin pasurinë e Fordit të Amerikës, shumëzoi këtë libër që është veç Risale-i Nurit, ai nuk do ta tërheqë majën e lapsit nga fleta ku është duke shkruar dhe përgjigja e tij do të ishte: “Unë nuk pranoj madje edhe sikur të më japin të gjithë botën me gjithë pasurinë e saj. Sepse All-llahu përballë leximit dhe shërbimit të Risale-i Nurit ne do të na japë një thesar të përjetshëm që nuk soset kurrë. Vallë, a ka mundësi të më kënaqë pasuria juaj që është e përkohshme? Por unë, nuk kam aspak dyshim që do të kënaqem me pasurinë e përjetshme që do të më dhurojë All-llahu im i Madhëruar”

Vëllezër të nderuar! Duke rënkuar nga thellësia e shpirtit të tyre, të rinjtë që shërbejnë Risale-i Nurin thonë “Unë nuk do ta shpenzoj më rininë time nëpër vende boshe që vlejnë vetëm për këtë jetë. Unë jetën do ta sakrifikoj vetëm në shërbimin e Kur'anit dhe të besimit, dhe në rrugën e All-llahut tim të dashur dhe të Profetit tim që e dua aq shumë. Vetëm në këtë mënyrë mund të fitoj një rini që nuk zhduket kurrë!” Duke e parë këto të ri të lidhur aq shumë për Risale-i Nurin, të mos mendojmë se ai është tërhequr nga kjo jetë. Me këto deklaratime që do të bëjë do të dalë në shesh më mirë puna e tij. Ne të gjithë është më mirë të merremi me punët tona: po qe se jemi

nxënës me mësimet tona, po qe se jemi nëpunës të kujdesemi për detyrën tonë, po qe se jemi tregtarë më mirë se të tjerët të bëjmë tregtinë tonë. Në anën tjetër megjithëse ne na okupojnë aq shumë punët e dynjasë, aq shumë na shtrëngojnë mësimet e provimet e kësaj jete, përsëri nuk e braktisim leximin dhe shërbimin e Risale-i Nurit. Patjetër për atë e gjejmë dhe mund ta gjejmë kohën sepse, si çdo ditë ka nevojë për bukë, për ujë dhe për ajër, njësoj edhe më tepër çdo ditë ka nevojë edhe për ushqimet shpirtërore të Kur'anit dhe të besimit.

Ja pra (megjithëse duke lexuar ne atë nuk e kemi qëllim) po bëhet shkak që të bëjmë më mirë sukses edhe në punët tona të dynjasë. Sa më shumë që po përpiqemi për të patur sukses në fe, aq më tepër kjo po ndikon tek ne duke na nxitur të punojmë më tepër në këtë dynja. Gjithashtu po na tregon vlerën e kohës. Me një formë më ndikuese na tregon se fletët ditore të kalendarit nuk kthehen më pas dhe na nxit që të vlerësojmë kohën sa më mirë. Përveç orëve të punës, kohën nuk po harxhojmë nëpër vende boshe duke menduar se ajo nuk është pa vlerë, bile edhe kohërat e pushimit po na shtojnë të kontribuojmë duke vlerësuar në shërbimin e Risale-i Nurit . Po na shtyn të kërkojmë shijen e lëvizjes, sepse Mëshira Hyjnore qetësinë e ka vendosur në lëvizje dhe jo në qëndrim. Në këtë rast duke lëvizur me një moshë të përkohshme po na shtyn që të fitojmë një jetë që nuk soset kurrë.

Vëllezërit e mi të shtrenjtë! Nuk është e mundur që ta tregojmë plotësisht vlerën e Risale-i Nurit. Vlera e tij po del në shesh nëpër disa vëllezër, sepse ata me sinqeritet vazhdimisht po e lexojnë këto libra brilante, Kjo vlerë rrënjësohet aq shumë tek njeriu sa që po të mblidhen të gjithë mosbesmtarët në kokën e këtij njeriu që ka përparuar në besimin e vërtetë, përsëri nuk mundin ta shtojnë që ta braktisë shërbimin e Risale-i Nurit .

Shërbimi i Risale-i Nurit është një nga mirësitë më të mëdha që më ka sjellë All-llahu xh.sh.. Bile, edhe po t'i shërbej shërbëtorit të Risaleve prap do të ndjej një nder. Kjo lidhja ime dikujt mund t'i duket shumë e fortë, por ajo asnjëherë nuk është aq e fortë sa duhet .Përsëmbull: Kur lexojmë një vepër të një autori ndaj tij pak a shumë ndiejmë një nderim. Sikurse kur lexojmë librin e Molierit, Hygoit e Gëtes habitemi ndaj tyre . Vallë, a më tregoni ju si duhet të jetë lidhja dhe habija jonë ndaj një autori islam që është komentatori i Kur'anit?. Po sikur librat e atyre personave të famshëm të shkruhen në letër? Risale-i Nuri që është një koment i Kur'anit a nuk duhet të shkruhet nëpër faqe të arta? Po qe se për orë të tëra përpiqemi të mësojmë diçka nga librat e një filozofi që nuk është mohues, atëherë librat e Beduizzamanit a nuk duhet t'i lexojmë duke sakrifikuar edhe gjumin, gjë që ajo na garanton lumturinë e të dy jetëve?!. Ja, kur paguajmë pesë lira një libër që ka qëllim këtë jetë, atëherë a nuk duhet të japim njëqind lira për Risale-i Nurin që ajo duke na ngritur në pozitën më të lartë na garanton lumturinë e kësaj jete së bashku me atë tjetrën?! O vëllezër! Bile për lirinë e një populli luftarak si ne, po të kishte nevojë për botim dhe për përhapjen e këtyre, duhet të sakrifikojmë tërë pasurinë tonë. Pra, ejani vëllezërit e mi! Në leximin e Risaleve të bëhemi gju më gju; në shërbimin e tij të kapemi dorë për dorë; në thirrjen për islam të bëhemi krah për krah. Duke u ndriçuar me mesazhet e dritës, të punojmë së bashku që të marrim mësim nga mësimet e besimit. Duhet të takohemi dhe të bisedojmë sa më shpesh njeri me tjetrin. Të vrapojmë në rrugën e All-llahut xh. sh. Shpirtërisht të bëhemi gati, që të mos mundemi nga ateistët. Po qe se ka nevojë në rrugën e fesë së vërtetë ta sakrifikojmë edhe shpirtin tonë të ëmbël.

Vëllezërit e mi të shtrenjtë!

Në veprat e Risale-i Nurit ka shumë virtyte të mira cilësore. Ne në asnjë libër tjetër nuk kemi mundur të gjejmë ato cilësi të dobishme dhe të veçanta që mban Ai. Këtë jo vetëm unë, por po e vërtetojnë edhe persona që u ka kaluar jeta duke lexuar lloj-lloj librash dhe më në fund kur kanë lexuar edhe Risale-i Nurin, duke arritur në përfundimin se: Njerëzit që jetojnë në këtë kohë megjithë dijen e tyre të madhe, kanë nevojë të lexojnë këto vepra brilante të Risale-i Nurit. Këta persona të ndershëm që po mbajnë moralin lart, duke u friksuar nga sëmundjet e egos dhe të xhelozisë po përqafohen pau tërhiqur me veprat e Risale-i Nurit. Ndonjëri, duke patur moshën 60-70 vjeçare, prapë dëshiron të lartësohet dhe të bëhet nxënës që të fitojnë mirësinë dhe begatinë përrallore të Risaleve. Vetë autori Bediuzzaman thotë se: “Risale-i Nuri nuk jep vetëm dije si librat tjerë, por Ai jep edhe mësim shpirtëror”. Ndikimi i këtij mësimi shpirtëror është aq i madh, saqë duke marrë mësim shpirtëror, zemrën e lexuesve e ka mbushur me dritën hyjnore. Duke i shtyrë ata të vrapojnë në rrugën e All-llahut dhe të Profetit të Tij ,shpirtërisht atyre po u pastrohet edhe jeta shpirtërore, duke zotëruar të vërteta të besimit po lartësohen me një ndikim Hyjnor. Ata që duan ta shtojnë diturinë fetare po lexojnë Risale-i Nur. Ata që kërkojnë të vërtetën po lexojnë Risale-i Nur. Ata që në krijimin e tyre mbanin dinamizmin po lexojnë Risale-i Nur..Trima e heronj po lexojnë Risale-i Nur.Atdhetarët patriotët po lexojnë Risale-i Nur.Zejtarët dhe shkencëtarët po lexojnë Risale-i Nur.Admiruesit e shkencave bashkëkohore po lexojnë Risale-i Nur. Mistikët po lexojnë Risale-i Nur. Gjuhëtarët po lexojnë Risale-i Nur. Domethënë: çdo shtresë e njerëzimit në shpirtin e saj po ndjen nevojën të lexojë Risale-i Nurin dhe të përfitojë nga ai.

O shokë! Kush lexon Risale-i Nur, atij i shtohet aftësia e bindjes, i forcohet kujtesa. Duke punuar mirë me dijen që ka marrë nga fusha të ndryshme të diturisë ai mund të japë përgjigje bindëse, sepse nxënësit e Risale-i Nurit vazhdimisht janë duke shkëlqyer me mësim ku zgjidhen problemet me logjikë, bindje e mençuri. Ndërsa burimi i qytetërimit të vërtetë dhe themeli i ligjeve të njerëzve është Kur’ani Famëlartë. Kur’ani është një orator që të gjithë njerëzit mbajnë fjalimin e tij të përgjithshëm. Pra kur do ta lexoni Risale-i Nurin, do ta pranoni se tek Risale-i Nuri janë përgjigjet bindëse të logjikshme të shumë pyetjeve që janë grumbulluar në mendjen e njeriut. Për këtë shumë njerëz duke shprehur habinë e tyre me tërë ndjeshmërinë e tij ndaj All-llahut po shpreh falenderimet sepse Risale-i Nuri është ai që i ka dhënë atij mësimet e të vërtetave Hyjnore. Në këtë rast ai po fillon të jetojë një jetë të qetë. Dhe mos harroni se, në qoftë se jeni i zgjuar do ta lexoni Risale-i Nurin pa e lëshuar nga dora, bile edhe duke e përsëritur, me një kënaqësi të madhe do ta vazhdoni leximin e tij. O ju vëllezërit e zgjuar që me kujdes jeni duke pasuar subjektin e Risale-i Nurit! Sikurse ai që lexon Kur’anin Famëlartë edhe po të mos e dijë kuptimin, përsëri në shpirtin e tij Ai lë një ndikim shpirtëror.Sepse është fjala e All-llahut xh.sh.. Kjo nuk është tjetër vetëm se kuptimi i lartësisë së amshuear të fjalës së All-llahut xh.sh. që: Turqit kur kanë mbajtur flamurin e ngadhnjimit të islamit kanë qenë edhe ngadhnjimtari i shteteve dhe i kontinenteve.Njësoj, një koment të lartë të Kur’anit që është Risale-i Nuri, kur lexoni në zanafillë ndoshta nuk do ta kuptoni, por shpirtërisht ndikimi, dhembshuria e tij do të ndikojë në shpirtin dhe në zemrën tuaj ; me kuptimin e tij të plotë ai do të kaplojë botën tuaj. Pra, ska dyshim që nuk do të mbeteni pa dobi. Dhe duhet të pranojmë edhe këtë se njeriu nuk përbëhet vetëm nga mendja. Njeriu ka zemër, shpirt, ndërgjegje dhe shumë shqisa të dukshme dhe të padukshme. Me një lexim mendja juaj mund të mos kuptojë plotësisht, por zemra dhe shpirti nga Ai do të marrin pjesën e tyre. Ky ndikim i Risale-i Nurit është i tillë sa që në zanafillën e shpalljes pranë tij kanë qenë 8 apo 10 nxënës, ndërsa tani numri i tyre ka arritur

miliona(Në simpoziumin e 2003 të Stambollit një profesor turk tha:”Kemi vërejtur se në Turqi dhjetë milion persona po e lexojnë Risale-i Nurin “).Në Anadoll mes ideve të ndryshme të besimit fetar, të Risale-i Nurit është rryma më e fortë. Bile ai ka garantuar jetë dhe lëvizje, duke i gjallëruar ato. Brezave të rinj të entuziazmuar ua ka sjellë të gjallë heroizmin e gjyshërve trima. Pra Risale-i Nuri nxënësit e tij i ka bërë të gatshëm të sakrifikojnë çdo gjë. Bile, për të mbrojtur islamin i ka shtyrë të vrapojnë dhe të japin shpirtin për të. Më në fund ndaj Risale-i Nurit si bota islame edhe e njerëzimi në tërësi duke e mirëkuptuar jashtëzakonisht, e kanë vlerësuar dhe po e vlerësojnë si duhet.

Prandaj çdo ditë vazhdoni leximin e këtyre veprave që të nxisin vazhdimisht t’i lexosh dhe do të mund të përparoni kur përqafeni kokë më kokë më to. Atëherë do t’ju shtohen aftësitë tuaja dhe do ta kuptoni më mirë se ia vlen të vazhdosh jetën me dashurinë e leximit të Risaleve fare pa u lëkundur. Vëllezërit e nderuar!

Stili i Risale-i Nurit mban një force tërheqëse të pa shoqe dhe stili i tij nuk ngjan me asnjë vepër tjetër. Bediuzzaman Said Nursiu duke qënë një komentator i Kur’anit në shekullin tonë është edhe gojëtari dhe gjuhëtari më i madh .Ai nuk është si ato letrarë që duan të hijeshojnë shprehjet me letërsinë pa kuptim, përkundrazi ai i kushton rëndësi kuptimit. Për të hijeshuar fjalën nuk sakrifikon nga kuptimi. Ai është një autor që për hatrin e robërve nuk ka prerë nga shtati i njeriut. Ai është një personalitet i veçantë që veprat e tij ka mundur t’i bëjë tepër ndikuese dhe me oratori të pashoqe. Është kjo arsyeja që veprat e Risale-i Nurit, të vërtetat e Kur’anit dhe të besimit kanë dale më të pastra dhe më të përsosura.

Risale-i Nuri është një thesar plot me përmbledhje të të vërtetave të fjalëve të qarta! Ai me një fjali ka mundur të përmbledhë kuptimin e një faqeje; në një faqe kuptimin e dhjetë faqeve; në një fragment kuptimin e një vëllimi të tërë. Ai është një person që zotëron veçorinë e përmbledhësit të fjalëve. Për këtë mësimet e tija janë shumë ndikuese dhe njëkohësisht të dobishme. Ekspertët e kësaj fushe konkludojnë: Mësimet e besimit nuk duhet të sqarohen shumë sepse kuptimi i tyre bëhet i vështirë dhe mësimet e tilla nuk japin rezultate të mira. Sipas kësaj, çështjet e besimit që të ndikojnë pozitivisht duhet të tregohen me pak fjalë. Autori i Risaleve nuk i ka hyrë tregimeve të degëve të tyre, ai ka shkruar rreth tregimeve themelore. Vëllezërit e mi që përpiqeni të zotëroni diturinë e besimit!

Bediuzzaman Said Nursiu në fundin e fragmentit të sinqeritetit që po na jep një sihariq të madh. Personalisht jam i bindur që deri tani asnjë nuk ka mundur t’ia parashtojë këtë lehtësi njerëzimit. Ai shprehet: ”Në këtë kohë Risale-i Nurin duke e kuptuar, kush e lexon një vit, ai është një dijetar i vërtetë të kësaj kohës ” Ja sot shkenca, me një shpejtësi të jashtëzakonshme, po përparon. Njësoj si edhe në fushën shpirtërore duhet ë përparojë, sepse po jetojmë në një kohë që në fushën fizike ‘udhëtimi i një orës ka zbritur në një sekondë“Kurse ajo shpirtërorja është më e gjërë dhe më e shpejtë. Shumë kohë më parë shkenca zotërohej për gjysëm shekulli ndërsa tani për një kohë shumë të shkurtër. Pikërisht në një kohë të shkurtër po merret rezultati. All-llahu xh.sh. me Mëshirën dhe me Bujarinë e Tij besimtarëve të kësaj kohe u ka dhuruar siguri të madhe në shkencën e besimit që ato mund të fitojnë shumë lehtë. Pra ju vetë mund të më tregoni se si mund të mos vrapojmë pas këtyre veprave që po na garantojnë rezultatin që treguam deri tani. Një njeri që nuk e ka humbur mendjen, veçanërisht muslimani duhet ta lexoj Risale-i Nurin me

sinqeritet dhe bindje të plotë, sepse ai i garanton njeriut thesarin e madh, pra besimin që është shpërblimi i lumturisë së përhjetshme. Vëllezër të zellshëm! Po bindem se ju, me tërë fuqinë tuaj, po përpiqeni të lexoni sa më parë serinë e vëllimeve të Risaleve dhe prej tyre po mundoheni të merrni çdo ditë ushqimin shpirtëror të besimit dhe të fesë Islame. Unë besoj se do t'i pranoni këto që thashë. Sepse rinia po ikën...Mosha po kalon...Kohrat nuk kthehen prapë

Ja pra, meqë jemi në moshë madhore ne nuk duhet presim as nga mësuesit tanë ndonjë qortim, as nga prindërit nuk po presim dhe nuk duhet të presim që të na nxisin ne. Ne po presim ndihmën vetëm nga All-llahu i madhëruar, që duke qëndruar në idenë tonë ta pranojmë se është nevoja parësore që të arrijmë vetveten. Ne duke kërkuar ndihmë nga Zoti dhe kur përpiqemi pa ndërprerë dhe me sinqeritet, patjetër do të arrijmë në kulmin e besimit dhe mundemit t'i praktikojmë kushtet e tij. Dhe do t'i ndriçojmë zemrat dhe kokat tona me dritën e Kur'anit dhe me shkencën e besimit. Inshall-llah atëherë, duke kujdesur bashkëpunojnë koka me zemrën tonë dhe do të bëhemi nga një rob i pastër i All-llahut dhe nga një anëtar sakrifikues i ummetit të Profetit a.s.m.

Vëllezër të shtrenjtë!

Do t'ua rradhish edhe disa virtyte nga oqeani i Risaleve. Fuqia e diturisë së jashtëzakonshme të Risale-i Nurit, duke shpëtuar besimin nga imitimi; duke argumentuar me vërtetësi çështjet e fesë po të shndërron, po të nxitë që të bëhësh një besimtar i fortë duke praktikuar dituritë e fesë, po të largon nga shijet e pista të veseve që të shtyjnë të pendohesh të nesërmen. Ajo të tregon shijet e amëshuara dhe të shtyjnë të vraposh pas qëllimeve të larta. Duke e larguar njeriun nga mjerimi i forcon atij besimin dhe duke e larguar nga plogështia e shtyn të dojë jetën. Shpirtin e tij e kapllon dinamizmi dhe nuk të lë në gjendjen e mesme, por, për të të lartësuar po përparon duke të nxjerrë në rradhën e parë. Po të largon nga moralet e këqia dhe mendjemadhësia; në zemrën tënde po të vendos virtytet e mira, pra modestinë, butësinë dhe sedrën. Po të shtyn të pajtohesh me armiqtë dhe po të nxitë e po të jep mësim t'i bësh ballë të këqijave jo me të keqe por me të mirë. Të rinjtë që janë me moral të mirë, duke i mbrojtur po i shpëton nga vende të fëlliqura dhe të pamoralshme. Tani, kush ka lexuar Risale-i Nurin me sinqeritet e me bindje, edhe sikur të jetojë mes njerëzve që kanë humbur moralin, ai patjetër do të mund ta shpëtojë veten pa e prishur fare moralin e vet, duke e ruajtur atë të pastër. Dhe do të fillojë luftën ndaj veseve të tij të liga. Këtë mund ta bëjë vetëm me forcën e besimit që ka marrë nga Risale-i Nuri! Në këtë mënyrë mund ta shpëtojë vehten nga komunitete dhe nga individë të këqinj. Bile me kulturën e besimit që ka marrë nga Risale-i Nuri, ai po del fitimtar! Si ndonjë sociolog i përsosur po bën përmirësime dhe po përparon në idetë e tij. Duke patur sukses ndaj padijes së idesë së tij, po vrapon nga njëra fitore në tjetrën.

Ja, o shokët tanë! Sot vetëm Risale-i Nuri është një mjek i vërtetë që i shëron me themel plagët e shoqërisë. Për këtë arsye po shtjellohen intelektualët që kanë mundur të kapin këto të vërteta dhe studentët e zgjuar me Risale-i Nurin. Mendimi ynë vazhdimisht do të ishte për përparimin. Risale-i Nuri ne na tregon se jeta e këtushme që është e përkohshme është një vend tregtie. Ne nuk na mjaftojnë vendet të ulëta dhe të pakta. Qëllimi ynë kryesor do të ishte përparimi, lartësimi dhe për të arritur në këto do të mësojmë Risale-i Nurin, duke shtyrë edhe të tjerë që ta lexojnë dhe të mësojnë parimet e Risale-i Nurit.

1947

Në emër të nxënësve të Nurit të Konjës

Zybejir Gyndyzalp

Ajet:

Kur'anit famëlartë është një diell i qiellit të univerzit që nuk perëndon Kurrë, se vetëm Me To mund të lexohet libri cilësor i veprimtarisë së krijësave.. Në botën e njerëzimit secili individ vetëm me To mund të shohë dhe të gjejë qëllimin e tij të krijimit që t'i plotësojë dëshirat e tij të brendshme dhe të vazhdojë drejtimin e tij të pagabuar. Dhe njeriu kur përballohet me jehonën e Kur'anit famëlartë, sipas forcës së nevojave të tij dhe sipas sinjeritetit, atij mund t'i bëhen pasqyrë cilësia e çështjeve dhe të jetës së tij. Me Atë dritë mund të duket, të kuptohet dhe të njihet. Tani në shekullin tonë kjo e vërtetë dhe ai Nuri (drita) me një formë shumë të bukur ka dalë në shesh në personalitetin shpirtëror të Risale-i Nurit, buruar nga Kur'ani që është një diell i paperëndim. Risale-i Nuri ua ndriçoi rrugën e atyre që janë si shpendi lepurak që duan të dalin në dritë, atyre që nga pakujdesia ditën e patën bërë natë, atyre që mendja i pati rënë në sy dhe jetonin të shfrenuar, atyre që syri nuk i bënte dritë dhe nëpër errësirë e patën humbur rrugën. Pra përveç atyre që ishin tërësisht të verbër, Risale-i Nuri, si një llambë projeksioni të gjithëve ia ndriçoi rrugën. Në kokat e mosbesimtarëve ateistë ai goditi me topuzin e Nurit (dritës) duke u thënë:

-A po e hedh mendjen nga koka jote dhe bëhesh kafshë?. Apo po e mbledh mendjen e bëhu njeri... Meqë dituria është një dritë me disa shembuj do t'ua tregojë ekspozimin e thellë të Risale-i Nurit që gjenden në të. Së pari këtë duhet t'ua vërejmë se Risale-i Nuri jo tjera librat por vetëm Kur'anin ka pranuar mësues dhe atij është duke i shërbyer, për këtë arsye neve nuk na mbetet që të lavdërojmë Atë. Ne për Risale-i Nurin u themi kështu intelektualëve: Risale-i Nuri ka zgjidhur çështjet më të vështira që deri tani asnjë dijetar nuk ka mundur t'i zgjidhë. Ato i ka argumentuar me një formë shumë lehtë të tillë që, sipas aftësive, që nga njeriu më i thjeshtë dhe deri tek profesori më i shquar, ua ka sqaruar atyre, duke bindur secilin dhe ua ka futur në mendje, duke mos u lënë aspak dyshim. Cilësitë që mban ky nuk mund t'i hasni në librin e asnjë dijetari.

Së dyti: Të gjithë veprat e Risale-i Nurit, në secilin vend të tyre shihet se janë nga një pjesë komentesh të ajeteve të Kur'anit me shkëlqimet e Tij shpirtërore.

Së treti: Nevojave më të thella të njerëzve duke sjellë argumente të sakta ua ka dhënë përgjigjen e duhur dhe bindëse. Përshembull: Për besimin themelor, pra për Njësimin e Zotit dhe të Ringjalljes ka vërtetuar duke përkthyer fjalët e gjendjes dhe të gojës së atomit. Filozofët e famshëm Ibni Sina, Farabi dhe Ibni Ruzhdi për këto, kanë paraqitur si argument Universin Madhështor. Risale-i Nuri këto të vërteta i ka argumentuar me vetë gjuhën e një atomi apo fare. Sikur të mundnim t'ia tregonim atyre fuqinë e Risale-i Nurit, ata menjëherë do të ishin ulur në gjuhë për të marrë mësim nga Risale-i Nuri.

Së katërti: Risale-i Nuri i garanton njeriut për një kohë të shkurtër dituritë përmbledhëse që nëpër libra të tjerë mund të merren në periudha të gjata vitesh.

Së pesti: Risale-i Nuri përfaqëson formën më të bukur të shkencës fetare, që kur e studion atë të tregon se në qoftë se dëshiron të bëhesh nxënës i Risale-i Nurit qëllimi yt kryesor do të ishte ta

fitosh kënaqësinë e All-llahut xh. sh.. Të mos e shpenzosh apsolutisht atë për interesa të kësaj bote! Vetëm në këtë mënyrë mund të bësh sukses nëpër qëllime të larta! Pra në rrugën e shërbimit të njerëzimit t'i ndihmosh njerëzit që të shpëtojnë besimin.

Së gjashti: Risale-i Nuri është duke përkthyer kuptimin e gjendjes dhe të gjuhës së të gjithë qenieve, sepse ai mban një mendim të fortë të besimit islam. Gjithnjë me Risale-i Nurin njeriut i lulëzon besimi duke ngritur atë, njeriun, në shkallët më të larta të së vërtetës së dijes, shikimit dhe të konstatimit. Sepse forca e argumentit mban tri shkallë. (Përshembull: Zjarri që digjet pas kodre argumentohet me tri rrugë:1-të tregon dikush.2-shkon e sheh vetë me sy.3-shkon dhe hulumton me termometër gradët e nxehtësisë.)

Së shtati: Në pikëpamjen themelore Risale-i Nuri të gjithë shkencat i ka përmbledhur si një copë që është përbërë nga litarët e shkencave. Ai ka shprehur fjalët që deri tani nuk ka mundur t'i flasë asnjë dijetar dhe është përmbledhur tërësisht nga aforizma, gjë që tregon se ka ekspertizë në secilën shkencë. Për të patur njohuri më të thella mund të studioni vetë Risale-i Nurin. Ne këtu do të paraqesim vetëm disa shembuj.

1 Kush e ka krijuar syrin e mushkonjës, edhe diellin Ai e ka krijuar.

2-Kush e ka rregulluar lukthin e një pleshti, edhe galaktikat Ai i ka rregulluar.

3- Për të shpikur një atom të vetëm Shpikësit i duhet një fuqi e tillë e pafundme, me të cilën mund ta krijojë edhe Gjithësinë. Sepse ndaj secilës shkronjë të këtij Universi, veçanërisht ndaj secilës shkronjë të gjallesave, ndaj secilës fjali të tyre shpikësi ka nga një fytyrë dhe ka nga një sy që i shikon ato.

4- Natyra i përngjan një shtypshkronje që nuk është botues, por është një libër i botuar. Ky libër është një qëndisje por nuk është qëndistar. Ai është një punë e qendisur por nuk është punëtor. Ai është mjeshtër, por nuk është mjeshtër. Ai është një rregull, Rregullues nuk është. Ai është ligj, nuk është ligjvënës. Është vendi ku zbatohet ligji ,nuk është gjykatës.

5- Si ligjet e zakonshme që janë të qëndrueshme e vendimtare, edhe shpirti ka ardhur nga urdhëri “Bëhu!” dhe nga funksioni i vullnetit të Tij. Fuqia e Zotit xh.sh. për të nxjerrë njeriun në shesh, diamantin e shpirtit të tij e ka veshur me elemente rrjedhëse të butë dhe me ndjeshmëri. Të tilla aforizma ka me mijëra.

Dr. Mustafa Hilmi Ramazanoğlu

Indeksi i ajeteve Indeksi i ajeteve

Nr

1 Neml 30

2 Bakare 60

3 Enbija 69

4 Isra 44

5 Ali imran 185

6 Bakare 25

7 Isra 102

8 Bakare 32

9 RRum 17-27

10 Neml 3
11 RRum 50
12 Tekvir, Haxhxxh, Zilzal, Infitar, Inshikak, Nebe, Gash
13 Ihlas 1 Bakare 255
14 Feth 1,3
15 Bakare 286
16 Yusuf 53
17 Xhathije 23
18 Tinë 4,5,6
19 Duhanë 29
20 Isra 23
21 Vakia 17
22 Hixhër 47
23 Neml 30
24 Fatiha 4
25 Fatiha 5
26 RRum 23
27 Shuara 11
28 Rrum 27
29 Bakara 257
30 Nur 35
31 Furkan 77
32 Mu'min 60
33 Furkanë 70
34 En'am 95
35 Zymer 49
36 Ali imran 173
37 Bakara 32 Taha 25-